


ÇFARË
ËSHTË
ANËTARI
I SHËNDETSHËM
I KISHËS?



Thabiti M. Anyabwile



“Çfarë është anëtari i shëndetshëm i kishës? mbush një boshllëk të stërmadh në literaturën për të jetuarit praktik të krishterë. Ky libër është jashtëzakonisht i dobishëm si udhëzues përdorimi, i drejtpërdrejtë dhe lehtësisht i lexueshëm, për kishën. Ai përbën edhe një përmbledhje të thellë dhe kryekëput biblike të eklesiologjisë praktike, e shkruar me një ndjesi të fortë pasioni dhe nguti. Si i tillë, ai përbën një burim të dobishëm për çdo anëtar kisha: si për fillestarin, ashtu dhe për pastorin e regjur. Në një epokë kur të krishterët, në përgjithësi, duken të pështjelluar se ç’lloj komuniteti duhet të jetë kisha, këtu kemi një doracak të dobishëm, që përvijon përparësitë e vërteta biblike të kishës, sidomos në aspektin e anëtarëve të kishës si individë.”

—JOHN MACARTHUR, president, Grace to You

“Thabiti Anyabwile ka mbushur një boshllëk të madh në literaturën bashkëkohore të krishterë. Librat për mënyrën si të jesh pastor ose drejtues besnik kisha janë të shumtë, por rrallëherë gjen një libër që flet kaq drejtpërdrejt për mënyrën si të jesh anëtar besnik kisha. Me një mori idesh të mprehta biblike dhe udhëzimesh praktike, Anyabwile u bën thirrje të krishterëve që të jenë më tepër sesa frekuentues kisha, pra, të jenë ai lloj anëtari besnik dhe aktiv që kërkon Perëndia. Duke patur parasysh gjendjen e kaq shumë prej kishave tona sot, ky libër mbërrin në çastin e duhur.

—R. ALBERT MOHLER JR., president,
The Southern Baptist Theological Seminary

“Disa libra janë kaq të thjeshtë sa s’ia vlen as t’i kalosh përciptas; disa të tjerë janë kaq të koklavitur saqë, nëse tema që trajtojnë s’është fort e rëndësishme, nuk ia vlen koha që kërkojnë. Por, nganjëherë, gjen një libër që është, në të njëjtën kohë, edhe i thjeshtë, edhe i thellë; dhe ky, i tillë është. Në një brez ku shumë njerëz po flasin për rëndësinë e faktit që të krishterët duhet të jetojnë “në komunitet”, pak janë ata që kanë shpaktuar, në mënyra biblikisht besnike dhe personalisht depërtuese, se ç’kuptim ka, në fakt, kjo. Thabiti Anyabwile po e mbush këtë boshllëk. Lexoje, mendo për të, lutu kur e lexon... dhe shpërndaja bujarisht bashkësisë”.

—D. A. Carson, profesor hulumtues i Dhiatës së Re,
Trinity Evangelical Divinity School

“Ky libër siguron një fokus të shkëlqyer dhe tejet të nevojshëm për anëtarin e kishës si individ. Të gjithë mund të përfitojmë nga ky libër i mprehtë”.

—R. C. SPROUL, kryetar dhe president,
Ligonier Ministri; pastor kryesor i predikimit dhe
mësimdhënies, Saint Andrews Chapel, Sanford, Florida


“Pastori besnik është edhe anëtar i mirë kisha. Thabiti është dëshmi e kësaj të vërtete dhe, në këtë mënyrë, ka shkruar me mprehtësi pastorale dhe nga përvoja vetjake se çdo të thotë të jesh anëtar kisha i shëndetshëm. Çdo kishë që dëshiron të forcojë anëtarët e vet do të bënte mirë t’ua jepte anëtarëve këtë libër në duar. Të jesh anëtar besnik kisha në një epokë të llastimit të tepruar dhe cytjesh egoiste, nuk është e lehtë. Mirëpo Thabiti, jo vetëm që na kujton se kjo është e mundur, por edhe na sfidon me realitetin biblik se kjo është e domosdoshme. Vazhdoj të falënderoj Perëndinë për mendjen dhe zemrën e Thabiti Anyabwile”.

—Anthony J. Carter, pastor, autor, kryeredaktor,
*Experiencing the Truth: Bringing the Reformation
to the African-American Church*

Libri *Çfarë është anëtari i shëndetshëm i kishës?* i Thabiti Anyabwile shtron pyetjet e duhura për atë çfarë ofron anëtarësia e kishës, duke i bërë thirrje çdo grupi vendor besimtarësh që të kultivojë dhe të mbështesë praktikatat e një asambleje të formuar nga ungjilli. Ky është një manual tejet praktik, por, nga ana tjetër, është tërësisht i zhveshur nga pragmatizmi fetar që karakterizon shpesh veprat e këtij zhanri, me fokus kërkuesit e së vërtetës. Çdo grup drejtuesish apo besimtarësh të zakonshëm, që do të zgjidhnin ta lexonin këtë libër së bashku dhe do të përqaфонin nxitjet e tij, do të vërenin se jeta e tyre si familje e Perëndisë do të rritej në urtësi, fuqi, dashuri dhe dëshmi në botë. Sa balsam dobiprurës do të gjejmë të gjithë në fjalët e këtij libri!”

—Eric C. Redmond, pastor kryesor,
Hillcrest Baptist Church, Temple Hills, Maryland

ÇFARË
ËSHTË
ANËTARI
I SHËNDETSHËM
I KISHËS?



Thabiti M. Anyabwile

Titulli në origjinal:
What Is a Healthy Church Member?

Copyright © 2008 by Thabiti M. Anyabwile and 9Marks
Published by Crossway Books
a publishing ministry of Good News Publishers
1300 Crescent Street
Wheaton, Illinois 60187

Për gjuhën shqipe © Kisha e Hirit, Tiranë, 2014

Përktheu: Florenc MENE
Redaktoi: Teuta Toska
Amazon ISBN: 978-1727846126

*Për Jezu Krishtin, Kreun e kishës,
Për trupin e Tij dhe për çdo anëtar që luan rolin e vet,
Për kishat lokale që më kanë skalitur:*

*First Baptist Church e Grand Cayman,
Capitol Hill Baptist Church,
Church on the Rock*

dhe

*Për kishën që jeton në shtëpinë time:
Kristie, Afiya, Eden dhe Titus*

PËRMBAJTJA

Parathënie e serisë	9
Parathënie, nga <i>Mark Dever</i>	11
Hyrje	13
Shenja 1	
Anëtari i shëndetshëm është dëgjues ekspozues	19
Shenja 2	
Anëtari i shëndetshëm është teolog biblik	27
Shenja 3	
Anëtari i shëndetshëm është i nginjur me ungjillin	39
Shenja 4	
Anëtari i shëndetshëm është i kthyer me të vërtetë në besim	49
Shenja 5	
Anëtari i shëndetshëm është ungjilltar biblik	61
Shenja 6	
Anëtari i shëndetshëm është anëtar i përkushtuar	69
Shenja 7	
Anëtari i shëndetshëm kërkon disiplinën	79
Shenja 8	
Anëtari i shëndetshëm është dishepull në rritje	91
Shenja 9	
Anëtari i shëndetshëm është ndjekës i përrulur	103
Shenja 10	
Anëtari i kishës është luftëtar lutjeje	113

Një fjalë e fundit	125
Shtojcë: Një besëlidhje tipike e një kishe të shëndetshme	129
Treguesi i Shkrimeve	131

PARATHËNIE E SERISË

Seria e librave “9Shenjat” (9Marks) ka si premisë dy ide bazë. Së pari, kisha lokale është jashtëzakonisht më e rëndësishme për jetën e krishterë nga ç’mund ta kuptojnë shumë të krishterë sot. Një libër që titullohet *Çfarë është anëtari i shëndetshëm i kishës?* mund të titullohej edhe *Çfarë është i krishteri i shëndetshëm?* Ne të “9Shenjat” besojmë se i krishteri i shëndetshëm, në fakt, është anëtar kisha i shëndetshëm.

Së dyti, kishat lokale rriten në aspektin e jetës dhe të gjallërisë kur e organizojnë jetën rreth Fjalës së Perëndisë. Perëndia flet. Kisha duhet t’i vërë veshin dhe ta ndjekë. Kaq e thjeshtë është. Kur kisha e dëgjon dhe e ndjek, fillon t’i ngjajë Atij që po ndjek. Pasqyron dashurinë dhe shenjtërinë e Tij. Shpalos lavdinë e Tij. Sa më shumë t’ia vërë veshin, aq më tepër do t’i ngjajë kisha Zotit.

Për këtë arsye, lexuesi mund të vërejë se të “9Shenjat”, të marra nga libri i Mark Deverit, *Nëntë shenjat e kishës së shëndetshme* (Crossway Books, 2001) fillojnë me Biblën:

- predikimi ekspozues;
- teologjia biblike;
- kuptimi biblik i ungjillit;
- kuptimi biblik i kthimit në besim;
- kuptimi biblik i ungjillëzimit;

- kuptimi biblik i anëtarësisë së kishës;
- kuptimi biblik i disiplinës së kishës;
- kuptimi biblik i dishepullimit dhe rritjes;
- dhe kuptimi biblik i drejtimit të kishës.

Mund të thuhet edhe gjëra të tjera për atë që duhet të bëjnë kishat për të qenë të shëndetshme, si për shembull, lutja. Por këto nëntë praktika janë ato që besojmë se ana-shkalohen më tepër sot (në dallim nga lutja). Kështu, mesazhi bazë që kemi për kishat është: mos i mbani sytë te praktikat më të mira të biznesit apo te praktikat më të fundit; sytë mbajini te Perëndia. Filloni duke ia vënë sërish veshin Fjalës së Perëndisë.

Nga ky projekt i përgjithshëm vjen dhe seria e librave “**9Marks**”. Këto vëllime synojnë t’i shqyrtojnë nëntë shenjat më në hollësi dhe nga kënde të ndryshme. Disa përqendrohen te pastorët. Disa të tjerë te anëtarët e kishës. Shpresojmë që të gjithë librat të kombinojnë shqyrtimin e kujdesshëm biblik me përsiatjen teologjike, shqyrtimin kulturor, zbatimin kolektiv dhe, madje, me njëfarë nxitjeje individuale. Librat më të mirë të krishterë janë gjithmonë edhe teologjikë, edhe praktikë.

Lutja jonë është që Perëndia ta përdorë këtë libër, bashkë me të tjerët, për ta ndihmuar nusen e vet, kishën, që të përgatitet me shkëlqim dhe rrezatim për ditën e Ardhjes së Tij.

PARATHËNIE

“Të dashur!” Të dielave në mëngjes, kështu e përshëndeste gjithmonë Thabiti bashkësinë ku shërbenim të dy si pastorë. Dhe e kishte me gjithë mend. I donte, dhe ata e donin. Disa nga anëtarët më të moshuar s’ia shqiptonin dot emrin (*Tabiti*), por e dinin se Thabiti e kishte me gjithë mend kur i quante “të dashur”.

“Mirëmëngjesi, të dashur”. Ende sikur e kam këtë zë në vesh.

Kjo është dhe fjala që përdori në mënyrë të përsëritur Gjoni në letrat që u dërgoi disa prej kishave më të hershme. Në providencën e Perëndisë, letrat e Gjonit, së bashku me pjesën tjetër të Dhiatës së Re, na flasin së tepërmi për faktin se ç’do të thotë të jemi të krishterë së bashku. Ato na tregojnë se ç’do të thotë të jesh anëtar kishë, që është dhe tema e këtij libërthi.

Thabiti e di, nga përvoja, se praktika e jetës së krishterë nuk është diçka që duhet ta bëjmë të vetëm. Të jesh i krishterë është çështje personale, por jo private. Kur rilindesh, lind në një familje. Dhe ajo familje nuk është vetëm familja e madhe dhe e zgjeruar e të krishterëve në mbarë botën, por edhe familja-bërthamë e veçantë e bashkësisë lokale.

Si bashkanëtar kishë për disa vjet, kam patur gëzimin të njoh Thabitin dhe gruan e tij, Kristie-n. Më kujtohet e diela e parë kur u takova me Thabitin. Më la mbresa se sa

interesant (punonte në një institut kërkimor), sa i spikatur (i përshtatet shumë rolit të vet) dhe sa i matur (i maste mirë fjalët) ishte! Por s'kishte thjesht një tru të mahnitshëm. Ky vëlla ka zemër! Filloi menjëherë që të përfshihej në jetën e njerëzve të tjerë në kishë. Brenda pak javësh, Thabiti filloi të ndihmonte në drejtimin pastoral të bashkësisë. Megjithëse do të duheshin disa vjet para se të pranohej si plak, ai po e kryente tashmë rolin e *plakut*.

Gjithë kjo tregon se Thabiti e kupton idenë se delet duhet të rrinë në vathë, dhe unë e kam parë të jetë edhe anëtar i shkëlqyer i vathës, edhe nënbari i spikatur.

Por mjaft po të marr nga koha jote. Ideja është që ky të jetë një libër i shkurtër. Tani, të ftoj të kridhesh në të dhe të përfitosh prej tij. Por, para kësaj, kalo një çast në lutje. Lutu që Perëndia ta përdorë Thabitin në jetën tënde, ashtu siç e ka përdorur në jetën e kaq shumë të tjerëve. Lutu që Perëndia ta përdorë këtë libër për të të ndihmuar ta njohësh dhe ta duash kishën tënde lokale si kurrë më parë. Dhe lutu që, kur ta njohësh dhe ta duash kishën, të njohësh dhe të shfaqësh gjithnjë e më tepër dashurinë e Perëndisë.

Perëndia të bekoftë dhe lexim të këndshëm, i dashur.

Mark Dever
Uashington DC
Shtator 2007

HYRJE

Xheni më habiti kur filloi të ngashërehej gjatë intervistës së anëtarësisë. Njëzet minutat e para të intervistës ishin pothuajse rutinë. Na rrëfeu fëmijërinë e vet, se si ishte rritur në një familje të krishterë, vitet e shkollës së mesme të mbushura me frikë dhe një periudhë jete si fëmijë plëngprishës gjatë kolegjit. Pastaj, kujtoi me njëfarë gëzimi përjetimin që pati kur u kthye në besim në një kishë lokale në vendlindje.

Prandaj nuk prisja që të ngashërehej nga pyetja:

- Si u tregua ajo kishë me ty nga ana shpirtërore? A u rrite atje?

Pasi pushoi për një sekondë, na shpjegoi:

- Prisja që, pasi u bëra besimtare, dikush të më ndihmonte të rritesha si e krishterë.

Me një nuancë të qartë pështjellimi dhe zemërimi, vijoi:

- Mirëpo, dukej sikur ata më vunë diku në një qoshe, sikur prisnin që t'i kuptoja vetë gjërat. Ishte një kohë e tmerrshme dhe e vetmuar.

Sa Xheni ke takuar në jetën tënde? Ndoshta ti je vetë një Xheni. Ndoshta, ke kaluar shumë kohë në një kishë apo disa kisha lokale. Dhe, ndoshta, jeta jote e krishterë s'është aq e ndryshme nga ajo e Xhenit. Erdhe në besim me dritë në sy dhe etje të madhe, i/e mbushur me energji dhe zell për të bërë gjëra madhështore për Zotin. Por, shpejt, fillove

të vrisje mendjen: “Çfarë saktësisht duhet të bëj si anëtar i kësaj kishe lokale?”

Nëse është kështu, ky libër është shkruar për ty. Nëse jo, ky libër është shkruar edhe për ty.

Pavarësisht nëse jetën e krishterë e fillove dje apo para tridhjetë vjetësh, synimi i Zotit është që të luash një rol aktiv dhe jetik në trupin e vet, pra, në kishën lokale. Ai synon që kishën lokale ta përjetosh si një familje tejet më të mrekullueshme dhe më kuptimplotë sesa çdo vend tjetër në botë. Ai synon që kishat e tij të jenë vende të shëndetshme dhe që edhe anëtarët e këtyre kishave të jenë të shëndetshëm.

Ky libërth u shkrua me shpresën që të mund të zbulosh ose të rizbulosh se çdo të thotë të jesh anëtar i shëndetshëm i kishës lokale dhe çdo të thotë të kontribuosh për shëndetin e përgjithshëm të kishës.

Më 2007, Crossway Books botoi librin e Mark Deverit “Çfarë është kisha e shëndetshme?”. Ai libër përvijonte pamjen e një kishe të shëndetshme nga ana biblike dhe historike dhe, së bashku me librin e tij të mëparshëm, “*Nëntë shenjat e kishës së shëndetshme*”, ka formësuar mendimin e shumë pastorëve dhe drejtuesve të kishave përgjatë viteve pas botimit të tij të parë.

Ky libër merr shtysë nga libri “Çfarë është kisha e shëndetshme?”, por përpiket t’i përgjigjet një pyetjeje disi të ndryshme: “Ç’pamje ka *anëtari* i shëndetshëm i kishës në dritën e Shkrimit?”. Ndërsa “*Nëntë shenjat e kishës së shëndetshme*” iu drejtohej kryesisht pastorëve për detyrën e reformimit të kishës, ky libër përpiket të merret me njerëzit që drejtohen nga pastorët dhe t’i inkurajojë këta njerëz që të

luajnë rolin e tyre për ta ndihmuar kishën lokale që të pasqyrojë gjithnjë e më tepër lavdinë e Perëndisë.

Si mund të kontribuosh ti, si individ dhe anëtar i kishës lokale, për shëndetin pozitiv të kishës sate?

Një zonjë, e quajtur znj. Bërns, më zuri ngushtë pas shërbesës së kishës një mëngjes të diele. Ishte disi e zemëruar dhe e acaruar për disa nga gjërat që po ndryshonin në kishë, si dhe për disa nga gjërat që kishin mbetur njësoj. Po përpiqesha të përshëndesja të tjerët kur po largoheshin ndërkohë që po ia bëja me mirësjellje me kokë zonjës Bërns ndërsa më qahej për pakënaqësinë e saj.

Kur pushoi në litaninë e vet, mendimi i parë që pata ishte ta pyesja: “Po çfarë kërkon saktësisht që të bëj për këto gjëra?”. Por, në një çast të rrallë përndritjeje, pata zgjuarsinë të mos e bëja atë pyetje. Përkundrazi, e pyeta:

- Atëherë, çfarë do të bësh *ti* për gjendjen e kishës? Si do të bëhesh *ti* anëtare më e mirë dhe si do të kontribuosh për shëndetin e familjes së Perëndisë në këtë vend?

Këto pyetje vlejné për çdo të krishterë, jo vetëm për ata që ankohen si znj. Bërns. Shëndeti i kishës lokale varet nga gatishmëria e anëtarëve të saj për të hetuar zemrën, për të ndrequr mënyrën si mendojnë dhe për të përveshur mëngët për punën e shërbesës.

Kapitujt në vijim paraqesin një propozim se si të jesh anëtar më i shëndetshëm i kishës sate. Këta kapituj e marrin si të mirëqenë faktin se je tashmë anëtar i një bashkësie lokale dhe se, ndoshta, të nevojitet vetëm një shtytje e vogël ose një mundësi për të menduar me kujdes për disa çështje kyçe.¹

¹ Nëse je i krishterë, por *nuk* je anëtar i një kishë, më lejo të të ftoj të lexosh një libër të shkëlqyer që është shkruar për të të ndihmuar të mendosh me

Kapitulli 1 nxit “dëgjimin ekspozues” të fjalës së Perëndisë. Anëtarët e shëndetshëm të kishës janë ata që e dëgjojnë në një mënyrë të veçantë Fjalën e Perëndisë kur predikohet dhe studiohet: ata ia lënë në dorë Perëndisë që të caktojë rendin e ditës, duke u përpjekur gjithmonë që të dëgjojnë për kuptimin e vërtetë të tekstit biblik, që, pastaj, të mund ta zbatojnë në jetë.

Në kapitullin 2, anëtarët e kishës inkurajohen që t’i përkushtohen nxënies së temave madhore të Biblës. Me fjalë të tjera, iu kërkojmë që të bëhen “teologë biblike” në përpjekjen për të mbrojtur veten dhe kishën nga mësimi i rremë dhe i gabuar.

Kapitulli 3 i fton anëtarët e kishës të nginjen me ungjillin e Jezu Krishtit. Ky është ungjilli që na shpëton (Rom. 1:16) dhe ungjilli që do të na mbajë dhe motivojë në jetën e përditshme si të krishterë.

Nuk ka mundësi ta dëgjosh në mënyrë ekspozuese Shkrimin, të përvetësosh tregimin e ngjarjeve dhe temat e tij madhore dhe të bësh një jetë të mbushur me ungjillin dhe nga ana tjetër të mos dëshirosh dhe të mos përpiqesh të bëhesh ungjilltar biblik. Kapitujt 4 dhe 5 ofrojnë disa këshilla se si ta mendosh kthimin në besim dhe ungjillëzimin në mënyrë të shëndetshme nga ana biblike.

Kapitulli 6 përmban një thirrje për të marrë përkushtimin serioz dhe aktiv për anëtarësim në kishën lokale. Pastaj, kapitulli 7 na siguron një arsye pse është i rëndësishëm anëtarësimi i përkushtuar në kishë: kisha lokale është

kujdes përse duhet të jesh anëtar i një kisha. Ky libër quhet *Stop Dating the Church (Mjaft u sollë me kishën si me një të dashur)*, nga Joshua Harris (Sisters, OR: Multnomah, 2004).

vendi ku të krishterët përjetojnë disiplinën formuese dhe ndreqëse të Zotit.

Kapitulli 8 shqyrton rritjen shpirtërore nga një pikëvështrim biblik, ndërsa kapitulli 9 përfshin disa këshilla se si ta mbështesësh në mënyrë të efektshme grupin drejtues të kishës sate.

Kapitulli 10 përmban një thirrje për ta konsideruar lutjen si aspekt thelbësor për t'u bërë dhe për të qenë anëtar i shëndetshëm i kishës. Ofrohet një diskutim i shkurtër për bazën biblike të lutjes, së bashku me disa gjëra që u këshillojmë anëtarëve të shëndetshëm që t'i përfshijnë në jetën e tyre të lutjes.

Çdo kapitull përfshin dhe disa lexime të rekomanduara për studim të mëtejshëm. Jo se këto janë gjërat e vetme për të qenë anëtar i shëndetshëm kishe; të rëndësishme janë edhe gjëra të tjera. Por shpresoj se këto do të na nxisin të gjithëve drejt dashurisë dhe veprave të mira për lavdinë e Krishtit dhe për bukurinë e nuses së Tij.

O Zot sovran, të përgjërohemi ta bekosh popullin Tënd me një përlësi, unitet, gëzim, paqe dhe përkujdesje të pazakontë për njëri-tjetrin. Lutemi që ta bësh tërë popullin tënd gjithnjë e më të shëndetshëm dhe të frytshëm nga ana shpirtërore, jo vetëm si individë, por edhe si një trup i vetëm, një njeri i ri, duke u përpjekur së bashku që të rriten në Krishtin, madje në plotësinë e shtatit të Tij. Beko leximin, dëgjimin dhe studimin e fjalës Sate për lavdi të emrit Tënd. Dhe, o Zot, prano që ta përdorësh edhe këtë libërth, në njëfarë mënyre, për të përparuar mbretërinë Tënde dhe për të zbukuar nusen Tënde. Atë, t'i kërkojmë këto gjëra duke ditur

se asgjë s'është tepër e vështirë për Ty, me sigurinë e plotë të besimit, në emër të Jezusit. Amen.

ANËTARI I SHËNDETSHËM ËSHTË DËGJUES EKSPOZUES

Çfarë është “dëgjimi ekspozues”? Përpara se t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje, duhet të përcaktojmë “predikimin ekspozues”. Shenja e parë dhe më e rëndësishme e kishës së shëndetshme është predikimi ekspozues. “Predikimi ekspozues nuk është thjesht prezantimi i një komentari gojor për një pasazh të caktuar të Shkrimit. Jo, predikimi ekspozues është ai lloj predikimi që, si ide kryesore të mesazhit, merr idenë e një pasazhi të caktuar të Shkrimit”¹. Që kishat të jenë të shëndetshme, pastorët dhe mësuesit duhet t'i përkushtohen zbulimit të kuptimit të Shkrimit dhe të lejojnë që ky kuptim t'i japë shtysë funksionimit të bashkësive të tyre.

Ka dhe një rrjedhojë të rëndësishme plotësuese për çdo anëtar të kishës lokale. Ashtu si filozofia e predikimit të pastorit duhet të përcaktohet nga kuptimi i Shkrimit, kështu edhe filozofia e dëgjimit të të krishterit duhet të udhëhiqet nga kuptimi i Shkrimit. Kur i vëmë veshin predikimit të Fjalës, pikësëpari, nuk duhet të dëgjojmë për “këshilla praktike zbatimi”, ndonëse Shkrimi na mëson shumë gjëra

¹ Mark Dever, *Nine Marks of a Healthy Church* (Wheaton, IL: Crossway Books, 2004), 40.

për çështjet e përditshme. Po kështu, nuk duhet të dëgjojmë që të marrim mesazhe që na përforcojnë vetëvlerësimin, ose që na nxisin për kauza politike dhe shoqërore. Jo, si anëtarë kishash të krishtera, pikësëpari, ne duhet të mundohemi të dëgjojmë zërin dhe mesazhin e Perëndisë, siç na zbulohet në Fjalën e Tij. Duhet të mundohemi të dëgjojmë se ç'ka shkruar Ai, me dashurinë e Vet të gjithëdijshme, për lavdinë e Vet dhe për bekimin tonë.

Atëherë, çfarë nënkuptoj saktësisht me termin “dëgjim ekspozues”? Dëgjim ekspozues do të thotë të dëgjosh kuptimin e një pasazhi të Shkrimit dhe ta pranosh atë kuptim si idenë kryesore që duhet të rrokim në jetën tonë individuale dhe kolektive si të krishterë.

Cilat janë dobitë e dëgjimit ekspozues?

Pikësëpari, dëgjimi ekspozues është, së pari, i dobishëm për ne pasi na *kultivon urinë për Fjalën e Perëndisë*. Kur e sintonizojmë dëgjimin me atë lloj predikimi që si ide kryesore bën idenë parësore të një pasazhi biblik, mësohemi gjithnjë e më tepër që t'i vëmë veshin Perëndisë. Bëhemi të rrjedhshëm në gjuhën e Sionit dhe të familjarizuar me temat e saj. Fjala dhe zëri i tij bëhen të ëmbla për ne (Psa. 119:103-4); dhe, kështu, aftësohemi më tepër që t'i shtyjmë në periferi zërat e shumtë që rivalizojnë me zërin e Perëndisë për kontrollin e jetës sonë. Dëgjimi ekspozues na jep një vesh të qartë për të dëgjuar Perëndinë.

Dobia e dytë rrjedh nga e para. Dëgjimi ekspozues *na ndihmon të fokusohemi në vullnetin e Perëndisë dhe ta ndjekim*. Synimet tona bëhen dytësore. Synimi i predikuesit bëhet dytësor. Qendrën e skenës e merr synimi i Perëndisë për popullin e vet; ai na rirrendit përparësitë dhe na prin në

drejtimin që e nderon më tepër. Vetë Zoti shpalli: “Delet e mia e dëgjojnë zërin dhe unë i njoh, e ato më ndjekin” (Gjoni 10:27). T’i vësh veshin zërit të Jezusit, siç dëgjohet në Fjalën e tij, është jetike për ta ndjekur Atë.

Së treti, dëgjimi ekspozues *mbron ungjillin dhe jetën tonë nga përçudnimi*. Shkrimi na thotë: “Sepse do të vijë koha kur njerëzit nuk do ta durojnë doktrinën e shëndoshë, por, sipas ëndjeve të veta, do të mbledhin grumbull mësues për të gudulisur veshët dhe do t’i largojnë veshët nga e vërteta e do t’i sjellin drejt përrallave.” (2 Tim. 4:3-4). Mosarritja që të dëgjosh në mënyrë ekspozuese ka efekte shkatërrimtare. Në kishë hyjnë mësues të rremë dhe e pengojnë ungjillin. Në fund e vërteta zëvendësohet me përralla dhe gënjeshtër. Aty ku anëtarët kultivojnë zakonin e dëgjimit ekspozues, ruhen nga “gudulisa e veshëve” dhe e mbrojnë ungjillin nga përçudnimi.

Prandaj, dobia e katërt është se dëgjimi ekspozues *inkurajon pastorët besnikë*. Ata burra që shërbejnë me besnikëri në shërbesën e Fjalës janë të denjë për nderim të dyfishtë (1 Tim. 5:17). Pak gjëra janë më dekurajuese ose më turpëruese për burra të tillë sesa kur bashkësia tregon mungesë vëmendjeje ndaj Fjalës së Perëndisë. Burrat besnikë marrin krahë nga pranimiti pjellor i Fjalës së predikuar. Ata marrin edhe më tepër guxim kur besimtarët e tyre i vënë veshin zërit të Zotit dhe japin prova se po formësohen prej tij. Si anëtarë të kishës, duke kultivuar zakonin e dëgjimit ekspozues, ne mund të kujdesemi për pastorët e mësuesit tanë dhe mund të ndihmojmë në parandalimin e dekurajimit dhe stërlodhjes së panevojshme.

Së pesti, dëgjimi ekspozues *i bën dobi bashkësisë së mbledhur*. Në mënyrë të përsëritur, shkruesit e Dhiatës

së Re nxisin kishat lokale që të jenë të bashkuara, me një mendje të vetme. Pali i shkruan një kishë lokale: “Ju bëj thirrje, vëllezër, në emër të zotit tonë Jezu Krisht, që të jeni të gjithë në të njëjtën mendje dhe të mos ketë asnjë ndasi mes jush, por që të jeni të bashkuar në të njëjtën mendje dhe gjykim” (1 Kor. 1:10; shih dhe Rom. 12:16; 2 Kor. 13:11; 1 Pjet. 3:8). Kur mblidhemi së bashku në kishën lokale dhe i përkushtohemi dëgjimit të zërit të Perëndisë përmes fjalës së tij të predikuar, skalitemi në një trup të vetëm. Bashkohemi në kuptim dhe qëllim. Dhe ky bashkim dëshmon për të vërtetën e ungjillit të Jezu Krishtit (Gjoni 17:21). Por, nëse dëgjojmë duke patur parasysh interesat dhe synimet tona, nëse zhvillojmë “interpretime vetjake” dhe pikëpamje vetjake të çuditshme, rrezikojmë ta shkatërrojmë atë bashkim, të nxisim mosmarrëveshje për çështje të dyshimta dhe të dobësojmë dëshminë tonë kolektive për ungjillin.

Si mund të kultivojnë zakonin e dëgjimit ekspozues anëtarët e kishës?

Mirë, po nëse dëgjimi ekspozues është kaq jetik për shëndetin e anëtarëve të kishës si individë dhe atë të kishës në tërësi, si mund ta formojë besimtari këtë lloj zakoni? Ka të paktën gjashtë ide praktike që mund të nxisin dëgjimin më me kujdes të fjalës së Perëndisë.

1) MEDITO PËR PASAZHIN E PREDIKIMIT GJATË KOHËS SË QETË

Disa ditë para se të predikohet mesazhi, pyet pastorin se nga ç’pasazh i Shkrimit ka në plan të predikojë të dielën. Inkurajoje duke i thënë se do të lutesh për përgatitjen e tij

dhe do të përgatitesh për të dëgjuar predikimin. Përpilo një skicë të atij pasazhi në devocionet e përditshme dhe përdore për të të drejtuar jetën e lutjes. Të mësosh të përvijosh Shkrimin është një mënyrë e mrekullueshme për të gërmuar dhe nxjerrë në dritë kuptimin e një pasazhi. Pastaj, skicimin tënd mund ta përdorësh si ndihmë dëgjimi; krahasoje me përvijimin e predikuesit për të mësuar gjëra të reja që s'i kishe kapur gjatë studimit personal.

2) INVESTO PËR NJË SERI TË MIRË KOMENTARËSH

Shtoji kohës sate të qetë disa nga mendjet më të mëdha në historinë e krishterë. Studio Biblën me Xhohn Kalvinin ose Martin Lloyd-Jones-in, duke blerë komentarët e tyre për librat e Biblës, teksa i lexon dhe studion nga fillimi në fund. Nëse pastori po predikon nga Ungjilli i Gjonit, zgjidh komentin e D. A. Carson-it ose James Montgomery Boice për Gjonin. Lëri këta studiues dhe pastorë të të ndihmojnë ta dëgjosh Fjalën e Perëndisë me vesh të qartë dhe të zbulosh kuptimin e saj të pasur. Seria e komentarëve *Bibla flet sot* është një pikëfillësë e shkëlqyer për ata që duan të krijojnë një bibliotekë me komentarë të mirë. Po kështu, mund të blesh një bibliografi të Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re për të të ndihmuar të analizosh gamën e komentarëve të disponueshëm. *Old Testament Commentary Survey (Bibliografi e Komentarëve të Dhiatës së Vjetër)* e Tremper Longman-it dhe *New Testament Commentary Survey (Bibliografi e Komentarëve të Dhiatës së Re)* e D. A. Carson-it janë burime të shkëlqyera.

3) FOL DHE LUTU PËR PREDIKIMIN PAS KISHE ME MIQTË E TU

Në vend që të ikësh me vrap pasi mbaron shërbesa, ose të flasësh për lajmet e fundit, zhvillo zakonin e të folurit për shërbesën me njerëzit pas kishë. Fillo biseda shpirtërore duke pyetur: “Si të sfidoi ose të foli Shkrimi sot?”, ose: “Cili aspekt i karakterit të Perëndisë të habiti ose të inkurajoi më tepër?”. Inkurajo të tjerët duke u treguar gjërat që mësove nga Perëndia dhe Fjala e tij gjatë predikimit. Vër në dukje, në mënyrë të veçantë, se si të ndryshoi mendimi për shkak të kuptimit të vetë Shkrimit. Dhe lutu me të tjerët që Perëndia ta ruajë bashkësinë që të mos bëhet “e rënduar nga veshët” dhe që ta bekojë bashkësinë me një dëshirë gjithnjë e më të fortë për “ushqimin e fortë” të Fjalës së tij (Isa. 6:9-10; Heb. 5:11-14).

4) DËGJO PREDIKIMIN DHE VEPRO SIPAS TIJ GJATË GJITHË JAVËS

Zakonin e dëgjimit ekspozues mund ta kultivojmë duke e dëgjuar predikimin gjatë gjithë javës dhe, pastaj, duke vepruar sipas tij. Mos lejo që predikimi i së dielës të mbetet ngjarje që ndodh vetëm një herë, e cila të venitet nga kujtesa sapo përfundon (Jakobi 1:22-25). Zgjidh një ose dy zbatime të veçanta nga Shkrimi dhe, me shumë lutje, vëri në jetë gjatë javës së ardhshme. Nëse kisha jote ka një shërbesë audio ose një faqe interneti ku vendosen përmbledhje të predikimeve të fundit, përfito nga këto mundësi për të ushqyer shpirtin me një klikim. Me mbështetjen e pastorit, formo grupe të vogla për shqyrtimin dhe zbatimin e predikimeve. Ose përdori predikimet dhe shënimet që ke

mbajtur si burim për marrëdhënie dishepullimi personale. Njoh një sërë familjesh që, si kohë devocionale familjare të dielën në darkë, kanë një kohë të rregullt për shqyrtimin e predikimit. Ka njëqind mënyra se si ta mbash predikimin të gjallë në jetën shpirtërore personale, duke shqyrtuar Fjalën e Perëndisë gjatë gjithë javës. Tregohu krijues. Ky lloj planifikimi ia vlen vërtet.

5) ZHVILLO ZAKONIN E TRAJTIMIT TË ÇDO PYETJEJE NGA VETË TEKSTI

Jonathan Edwards-i vendosi se nuk do ta linte ditën të përfundonte pa iu përgjigjur atyre pyetjeve që e shqetësonin ose që i vinin në mendje gjatë kohës që studionte Shkrimet.¹ Sa të shëndetshme do të ishin kishat nëse anëtarët do t'i përkushtoheshin studimit të Shkrimit me këtë lloj përpjekjeje dhe vendimi të qëllimshëm! Një mënyrë se si t'ia fillosh është duke diskutuar me pastorin, pleqtë ose mësuesit e tjerë në kishë për pyetjet që të ka ngjallur teksti biblik. Po kështu, mos ji pasiv në studimin vetjak; kërko përgjigje duke e shqyrtuar vetë Shkrimin dhe duke folur me partnerë të cilëve u jep llogari ose me grupe të vogla. Por mos harro se pastori ka gjasa të ketë kaluar më tepër kohë sesa shumica e tyre për të menduar për atë pasazh dhe ai e ka për detyrë të të ushqejë me Fjalën e Perëndisë. Vijoje predikimin me pyetje dhe komente që do të ishin inkurajim për pastorin dhe bekim për shpirtin tënd.

¹ Rreth moshës 19-vjeçare, Edwards-i shkroi vendimin e mëposhtëm: Vendosi që, kur të më vijë në mend ndonjë teoremë teologjike që duhet zgjidhur, të bëj aty për aty maksimumin që ta zgjidh nëse situatat nuk më pengojnë". *The Works of Jonathan Edwards*, vëll. 1 (Peabody, MA: Hendrickson), lxii.

6) KULTIVO PËRULËSINË

Ndërsa gërmon në Fjalën e Perëndisë, duke u përpjekur të dëgjosh zërin e tij, pa dyshim do të fillosh të rritesh dhe të zbulosh shumë thesare të mahnitshme. Por, gjatë rritjes, mos u bëj një “profesionist për dëgjime predikimesh”, i cili gjithmonë dëgjon, por kurrë s’nxë. Ruhu nga njohuria e rreme që “krekos” (1 Kor. 8:1; Kol. 2:18) dhe që prirjet të shkaktojë zënka dhe polemika. Bëj që të vdesë çdo prirje për krenari, dënim të tjerëve dhe kritikë pedante. Në vend të kësaj, përpiqu të takohesh me Jezusin sa herë që vjen te Shkrimi; mblidh nga Fjala “karburant” për adhurim gjatë gjithë jetës. Në vend që të lartësojmë veten, le të kujtojmë fjalët e apostullit Pjetër: “Prandaj, përujeni veten nën dorën e fuqishme të Perëndisë, që ai t’ju lartësojë në kohën e duhur” (1 Pjet. 5:6).

Përmbyllje

Është pikërisht dëgjimi i mesazhit dhe i Fjalës së Perëndisë ai që të çon në besimin shpëtues (Rom. 10:17). Anëtarët e kishës janë të shëndetshëm kur i përkushtohen dëgjimit të këtij mesazhi si disiplinë e rregullt. Këtë lloj shëndeti për anëtarët e kishës e nxit dëgjimi ekspozues si individë, si dhe për gjithë kishën.

Për përsiatje të mëtejshme

1. Si do ta vlerësoje aftësinë tënde për të dëgjuar kuptimin e Fjalës gjatë devocioneve vetjake? Po gjatë predikimeve?
2. Si planifikon ta përforcosh aftësinë dëgjuese?

SHENJA 2

ANËTARI I SHËNDETSHËM ËSHTË TEOLOG BIBLIK

“**Padija për Perëndinë** (mungesa e njohurisë për udhët e tij dhe për praktikën e bashkësisë me Të) qëndron në rrënjë të dobësisë së kishës sot”. Kështu e filloi J. I. Packer-i parathënien e vëllimit të tij klasik *Njih Perëndinë* më 1973. Packer-i arsyetoi se një prirje që po çonte në një padije kaq të madhe për Perëndisë dhe në një dobësi kaq të madhe në kishë ishte “se mendjet e krishtera i janë përshtatur frymës moderne: pra, frymës që pjell ide madhështore për njeriun dhe u lë hapësirë vetëm mendimeve të vogla për Perëndinë”¹.

Mjerisht, ky vëzhgim i Packer-it tingëllon i vërtetë edhe pas më tepër se tre dhjetëvjeçarësh. Padija për udhët e Perëndisë dhe për bashkësinë me të po “bën kërëdinë” në një numër tepër të madh rastesh. Anëtarët e kishave të krishtera vazhdojnë të kenë mendime të vogla për Perëndinë dhe mendime të mëdha për njeriun. Kjo gjendje e situatës zbulon se një numër tepër i madh të krishterësh kanë anashkaluar thirrjen e tyre të parë dhe më të madhe: *të njohin Perëndinë*

¹ J. I. Packer, *Knowing God*, botimi i përvjetorit të 20-të (Downers Grove, IL: InterVarsity 1993), 12.

e tyre. Çdo i krishterë duhet të jetë teolog në kuptimin më të mirë dhe më të ngushtë të fjalës. Që kishat të lulëzojnë plot shëndet, anëtarët e kishës duhet të kenë përkushtimin për t'u bërë teologë biblikë sa më shumë që mundën. Kjo është shenja e dytë e anëtarit të shëndetshëm të kishës.

Çfarë është teologjia biblike për anëtarin e kishës?

Të praktikosh teologjinë biblike, do të thotë të njohësh vetë Perëndinë. Termin “teologji biblike” po e përdor me dy gjëra në mendje. Së pari, duhet të kemi parasysh se Bibla është vetëzbuluesja e Perëndisë; është materiali burimor për zhvillimin e mendimeve madhështore për Perëndinë. I krishteri që është i interesuar të njohë Perëndinë e vet është i krishteri që dëshiron të dijë se çfarë thotë Perëndia për Vete në Bibël. Ky lloj i krishteri nuk i fillon fjalitë me: “Mua më pëlqen ta mendoj Perëndinë si...”. Jo, ai ka mësuar të mos përziejë pak Epokë të Re me një çikë hinduizëm dhe me një çikë krishterim, me qëllim që të formojë një perëndi për veten, të bërë me porosi. Jo, anëtari i krishterë i kishës, që e ka serioze dëshirën që të njohë Perëndinë, është një anëtar i përkushtuar ndaj asaj që thotë Bibla për Perëndinë, sepse Bibla është vendi ku Perëndia na flet për vete.

Të praktikosh teologjinë biblike do të thotë të njohësh historinë madhore e hyjnore të shpengimit. Së dyti, teologu biblik është njeri i përkushtuar për të kuptuar historinë e zbulesës, temat dhe doktrinat madhore të Biblës dhe mënyrën se si ato përputhen me njëra-tjetrën. Me fjalë të tjera, anëtarët e shëndetshëm i përkushtohen synimit që të kuptojnë unitetin dhe përparimin e Biblës si një e tërë, jo thjesht pasazheve të izoluara apo të preferuara. Ata i afrohen Biblës me dijeninë se po lexojnë një histori madhështore të

Perëndisë që shpengon një popull për Vete dhe për lavdinë e Vet. Dhe, në atë histori shohin se Perëndia është Perëndi krijues, Perëndi i shenjtë, Perëndi besnik, Perëndi i dashur dhe Perëndi sovran, sepse Ai i bën premtime popullit të Vet dhe i mban ato, duke filluar që nga Adami dhe Eva e duke kaluar deri te përmbushja përfundimtare e të gjitha gjërave.¹

Si vepron teologjia biblike për nxitjen e shëndetit të anëtarit të kishës?

Në librin e tij të famshëm *Systematic Theology (Teologji Sistematike)*, Wayne Grudem-i rendit dobite e shumta të studimit teologjik sistematik. Shumë prej këtyre dobive rrjedhin edhe nga studimi i teologjisë biblike. Ia vlen të përmbledhim këtu dobite që propozon Grudem-i.²

Së pari, *praktika e teologjisë biblike na ndihmon të rritemi në nderimin ndaj Perëndisë*. Kur ndeshemi me Perëndinë e Shkrimit, i cili shpall dhe mban premtimet e besëlidhjes së Tij me popullin e Vet, shohim diçka nga madhështia e Perëndisë. Bashkëveprimi hyjnor i gjithçkaje për mirë del më qartazi në pah që nga premtimi i Tij për gruan, se Fara e saj do t'i shtypte kokën gjarprit (Zan. 3:15), te hapja e barqeve shterpë në mënyrë që të ruhej Fara (Zan. 17:15-19; 21:1-2; 29:31; 30:22; Isa. 7:14) e deri te lindja, më në fund, e asaj Fare (Mat. 1:20-23). Kur shohim se Perëndia është, gjithmonë ka qenë dhe gjithmonë do të mbetet, po

¹ Mark Dever, *Nine Marks of a Healthy Church* (Wheaton, IL: Crossway Books, 2004). Shih kap. 2.

² Wayne Grudem, *Systematic Theology* (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1994), 26-30.

Ai Perëndi krijues, i shenjtë, besnik, i dashur dhe sovran për ne, siç ka qenë edhe për të tjerët, kjo na nxit besimin te Perëndia dhe mahnitjen nga Ai. Nëse duam të njohim dhe të nderojmë vërtet Perëndinë, duhet të përkushtohemi që të bëhemi teologë biblikë, që njohin historitë dhe temat e Biblës.

Së dyti, *praktika e teologjisë biblike na ndihmon të mposhtim idetë tona të gabuara*. Të gjithë ne ndeshemi me mësimet e ndryshme në Bibël, që na sfidojnë, përshtjellojnë ose provokojnë. Shpesh, refuzojmë t'i pranojmë ato mësimet për shkak të plogështisë dhe mëkatit që kemi në zemër. Mund t'i shmangemi një vargu aty, apo një tjetri këtu, që na shkakton mospëlqim, ose që na përball me mëkatin. Por kur jemi të përkushtuar që të kuptojmë pamjen madhore të zbulesës biblike dhe peshën e plotë të mësimet biblike për një temë të caktuar, bindemi më lehtë për idetë tona të gabuara. Teologjia biblike na ndihmon të shohim se si Perëndia i ka dhënë, në mënyrë të vazhdueshme, të njëjtin mesazh popullit të Vet në vende të ndryshme dhe mënyra të ndryshme (Heb. 1:1), një mesazh të cilit, një ditë, të gjithë do t'i përulemi dhe do ta pranojmë (Isa. 45:22-24; Rom. 14:10-12; Fil. 2:9-11). Kur studiojmë me lutje teologjinë biblike, nxitemi që t'i nënshtrohemi gjithë gëzim Perëndisë dhe të flakim tej idetë e gabuara për Të.

Së treti, *praktika e teologjisë biblike ndihmon në mbrojtjen e kishës ndaj polemikave doktrimore*. Historia e kishës është e mbushur me polemika që dolën nga brenda (dhe ndërmjet) bashkësive. Kishat janë më tepër në gjendje t'u rezistojnë këtyre polemikave dhe t'i zgjidhnin në mënyrë më produktive nëse ruajnë botëkuptimin e duhur për teologjinë biblike, sistematike dhe historike. Kjo është e

vërtetë, pasi çfarëdo që thotë Bibla për diçka është e lidhur me gjithçka tjetër që thotë Bibla. Teologjia biblike na ndihmon të ruajmë vijimësinë dhe përputhjen e mësimi të Biblës. Përfshirja në teologji biblike është njësoj si bashkimi i pjesëve të një *pazëlli*. Kur njëra pjesë e *pazëllit* na duket e panjohur, vendin e saj të duhur në *pazëll* mund ta kërkojmë duke e lidhur me pamjen e plotë në pjesën ballore të kutisë së *pazëllit*. Sa më shumë pjesë të kemi vendosur aty ku duhet që në fillim, aq më të lehtë e kemi të vlerësojmë dhe të vendosim pjesët e reja, dhe aq më pak mundësi kemi që të gabojmë. Të zotërosh mjaftueshëm teologjinë biblike do të thotë të kesh pikurën e plotësuar të *pazëllit*, gjë që na lejon të pranojmë diçka ose të hedhim poshtë pjesët e gabuara teologjike. Shkrimet “Dhe të gjitha këto gjëra u ndodhën atyre si shembull, dhe janë shkruar për paralajmërimin tonë, për ne që jemi në mbarim të epokës” (1 Kor. 10:11), dhe njohuria e Shkrimit e mbron kishën nga përrallat e të vjetërve dhe polemikat e pashtershme.

Së katërti, *praktika e teologjisë biblike është e nevojshme për të përmbushur Porosinë e Madhe*. Jezusi na porositi t’u mësojmë gjithë besimtarëve që të zbatojnë gjithçka që urdhëron Ai (Mat. 28:19-20). Pa një teologji të formuar mirë, përfshirë dhe botëkuptimin e saktë se si duhen kuptuar urdhrat e Perëndisë në zhvillimin dhe kontekstin e tyre historik, është vërtet e vështirë t’i bindemi urdhrat të Zotit që t’i mësojmë të tjerët të binden. Çfarë do t’u mësojmë? Cilës gjëje do t’i bindemi? Si do ta dimë se çfarë duhet të zbatojmë në jetën tonë? Këto pyetje marrin më mirë përgjigje kur të krishterët janë të familjarizuar me teologjinë biblike dhe e njohin Perëndinë e tyre.

Por, ndoshta, dobia më bindëse pse të bëjmë teologji

biblike është se ajo *na thellon të kuptojmë ungjillin dhe të shkathtësohemi me të*. Jezusi dhe apostujt nuk kishin nevojë për Dhiatën e Re që të shpallnin ungjillin. Ata mbështeteshin në Dhiatën e Vjetër dhe kuptonin se shkrimet e Dhiatës së Vjetër dëftonin për Jezusin (Luka 24:27, 24: 44-45). Teologu biblik ndjek hapat e Jezusit dhe apostujve duke përvetësuar unitetin e Shkrimit; nga fillimi në fund, ai sheh Krishtin dhe ungjillin.

Si të bëhesh anëtar i shëndetshëm duke u bërë teolog biblik

Si mund të bëhet besimtari një anëtar kishe i shëndetshëm, që njeh mirë temat e teologjisë biblike? Ka një sërë strategjish që mund të rezultojnë të dobishme.

LEXO NJË LIBËR TË MIRË PËR TEOLOGJINË BIBLIKE

Një mënyrë e qartë për t'u bërë teolog biblik është të lexosh një libër të mirë për teologjinë biblike. Në rrjedhë të kohës një sërë veprash kanë provuar se janë të dobishme. Për një vepër të mirë reference lexuesit duhet të provojnë *The New Dictionary of Biblical Theology (Fjalori i ri i teologjisë biblike)*.¹ Për hyrje të dobishme, shqyrtoni:

- Vaughn Roberts, *God's Big Picture: Tracing the Storyline of the Bible (Tabloja e plotë e Perëndisë: gjurmimi i vijës historike të Biblës)*;

¹ *The New Dictionary of Biblical Theology: Exploring the Unity & Diversity of Scripture*, red. T. Desmond Alexander, Brian S. Rosner, D. A. Carson, Graeme Goldsworthy (Downers Grove, IL: InterVarsity, 2000).

- Mark Strom, *The Symphony of Scripture: Making Sense of the Bible's Many Themes* (*Simfonia e Shkrim-it: të kuptojmë temat e shumta të Biblës*);
- Peter Jensen, *At the Heart of Universe: What Christians Believe* (*Në zemër të universit: çfarë besojnë të krishterët*);
- Graeme Goldsworthy, *According to Plan: The Unfolding Revelation of God in the Bible* (*Sipas planit: zbulesa shpalosëse e Perëndisë në Bibël*); dhe
- Graeme Goldsworthy, *The Goldsworthy Trilogy: Gospel and Kingdom, Gospel and Wisdom, and The Gospel in Revelation* (*Trilogjia e Goldsworthy-t: un-gjilli dhe mbretëria, ungjilli dhe urtësia, dhe ungjilli te Zbulesa*).¹

Seria *The New Studies in Biblical Theology* (*Studime të reja në teologjinë biblike*),² e redaktuar nga D. A. Carson, përbën një seri të shkëlqyer studimesh për teologjinë biblike. Këto vepra sigurojnë vështrime të përgjithshme, të shëndosha dhe të qarta, për unitetin dhe larminë e Shkrim-it. Dhe, për lexuesit më të përparuar, *Biblical Theology: Old and New Testaments* (*Teologjia biblike: Dhiata e Vjetër dhe*

¹ Vaughn Roberts, *God's Big Picture: Tracing the Storyline of the Bible* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 2003); Mark Strom, *The Symphony of Scripture: Making Sense of the Bible's Many Themes* (Phillipsburg, NJ: P&R, 2001); Peter Jensen, *At the Heart of Universe: What Christians Believe* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 2003); Graeme Goldsworthy, *According to Plan: The Unfolding Revelation of God in the Bible* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 2002); Graeme Goldsworthy, *The Goldsworthy Trilogy: Gospel and Kingdom, Gospel and Wisdom, and The Gospel in Revelation* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 2001).

² Downers Grove, IL: InterVarsity, 2001.

e Re)¹ e teologut holandez të Princetonit, Geerhardus Vos, mbetet ende libër klasik. Përdori këto vepra në kohën e përkushtimit ose në kohën e lirë të leximit. Sugjeroji drejtuesit të grupit tënd të vogël që një ose më tepër nga këto vepra t'i lexoni si grup.

STUDIO SHKRIMET NË MËNYRË TEMATIKE

Cakto një pjesë në kohën tënde të studimit vetjak për *t'i studiuar Shkrimet në mënyrë tematike*. Ndoshta dieta kryesore e ushqimit biblik duhet të jetë studimi i librave të Biblës varg për varg në kontekstin e tyre shpengues dhe historik. Kësaj diete kryesore shtoji një studim të temave madhore që përshkojnë gjithë Biblën. Kalo njëfarë kohe me shqyrtimin e zbulësës së karakterit të Perëndisë; unitetin dhe larminë e besëlidhjes së Perëndisë me popullin e Vet; natyrën profetike, priftërore dhe mbretërore të Jezusit; dhe me mbretërinë e Perëndisë në Dhiatën e Vjetër dhe atë të Re. Gjurmoji këto tema nëpër gjithë Shkrimin dhe vër re vazhdimësitë dhe ndërprerjet nëpër periudhat e ndryshme të historisë shpenguese. Kur ta bësh këtë, natyra e shkëlqyer e Perëndisë dhe lavdia e shpengimit do të të shpalosen me më tepër ngjyrim dhe shkëlqim.

MERR QASJEN E DHIATËS SË RE NË LIDHJE ME DHIATËN E VJETËR

Siç pohuam më herët, Bibla është një histori e Perëndisë që shpengon një popull të veçantë për Vetën e Tij. Kur studion Dhiatën e Re, stërvite veten që të lidhësh ato që mëson aty me Dhiatën e Vjetër. Bëj pyetje të tilla:

¹ Edinburg: Banner of Truth, 1975.

- Si është ky pasazh përmbushje e diçkaje të premtuar në Dhiatën e Vjetër?
- Si është kjo ide e Dhiatës së Re e ndryshme nga një mësim i Dhiatës së Vjetër, ose e ngjashme me të?
- Në ç'mënyrë qartëson, shpalos ose përforcon ky pasazh i Dhiatës së Re diçka nga Dhiata e Vjetër?

Përgjigjja e këtyre pyetjeve do të të ndihmojë për nënvizimin e unitetit dhe të larmisë së Biblës dhe mesazhit të saj. Një libër i shkëlqyer që mund ta studiosh me këto pyetje në mendje është ai i Hebrenjve. Studio Letrën e Hebrenjve dhe mahnitë nga epërsia e Jezus Krishtit, e shfaqur në Dhiatën e Vjetër.

DHIATËN E VJETËR STUDIOJE DUKE PASUR PARASYSH JEZUSIN DHE DHIATËN E RE

Kur të lexosh dhe studiosh Dhiatën e Vjetër, pyete veten se si përputhet ajo me zbulesën e Dhiatës së Re. Për shembull, pyet:

- Ku futet ky pasazh brenda vijës kohore të historisë shpënguese?
- Si na drejton ky pasazh nga Jezusi?
- Si lidhet kjo e vërtetë për Izraelin me idenë e Dhiatës së Re për kishën?
- Si është themelor ky pasazh për të kuptuar krishterimin e Dhiatës së Re? Si është e vijueshme ose e ndërprerë në lidhje me Dhiatën e Re kjo ide ose ky mësim i Dhiatës së Vjetër?
- Cilat pasazhe të Dhiatës së Re më ndihmojmë t'u përgjigjem këtyre pyetjeve?

Studiuesi i teologjisë biblike e njeh mirë vazhdueshmërinë e ngjarjeve të Shkrimit.

STUDIO LIBRAT E PROFECISË NË DHIATËN E VJETËR

Ndoshta, librat më të anashkaluar të Dhiatës së Vjetër janë librat e profecisë, veçanërisht ata që janë emërtuar në mënyrë fatkeqe si “Profetët e vegjël”. Profetët mbeten disa nga materialet më të pasura në Bibël për jetën, shërbesën dhe epërsinë e Jezu Krishtit. Për shembull, kur studion Isaian ose Zakarian, mos harro se profecitë e tyre mund të përmbushen në horizonte të shumëfishta. Në një aspekt të caktuar, çdo profeci e dhënë mund të jetë përmbushur në kohën e vetë profetit. Por, po kjo profeci mund të jetë përmbushur edhe në mënyrë “kristologjike” në Jezu Krishtin. Pastaj, ajo mund të përmbushet edhe në mënyrë “eskatologjike”, pra, të ndodhë në fund të kohës në përmbushjen e të gjitha gjërave. Studimi dhe kuptimi i profecisë në këtë mënyrë ndihmon në theksimin e tablosë së plotë të Biblës dhe në thellimin e njohurisë sonë për Perëndinë.

NJIH DHE PRANO TË MBËSHTESËSH SHPALLJEN E BESIMIT TË KISHËS SATE

Kur i bashkohemi një kishë, duhet të dimë se çfarë beson ajo kishë dhe a biem dakord me mësimin e saj. Prandaj, studio i përqendruar thënien doktrinare të besimit të kishës. A është e shëndoshë nga ana doktrimore? A ka kjo thënie doktrinare një histori të veçantë në atë kishë vendore? A përkon kjo thënie doktrinare me traditën e krishterë më të gjerë, apo i largohet asaj? A e kupton thënien doktrinare? Disa kisha kanë praktikën e shëndetshme se u kërkojnë anëtarëve të rinj të nënshkruajnë shpalljen e besimit të kishës si tregues

i faktit se bien dakord me të vërtetat e shprehura aty dhe janë të gatshëm t'i mbrojnë. A mundesh, me ndërgjegje të pastër, që të nënshkruash thënien doktrinare të kishës sate? Nëse po, përkushtoj përkrahjes së integritetit doktrinor të kishës.

KËRKO UNITET DOKTRINOR DHE SHMANG POLEMIKAT E KOTA

Hera-herës, në kishën lokale do të shfaqen pikëpamje të ndryshme doktrimore. Pyetja kyçe për anëtarët është: “Si do të merrni pjesë në zgjidhjen e këtyre lloj pikëpamjesh?”. Këtu është i dobishëm ai parimi i vjetër: “në të gjitha gjërat thelbësore, unitet; në të gjitha gjërat jothelbësore, liri; dhe, në të gjitha gjërat, dashuri”. Anëtari i shëndetshëm, që është zotuar të bëhet teolog biblik, do të punojë për të njohur dallimin mes bindjeve që janë thelbësore për krishterimin biblik dhe bindjeve që s’janë thelbësore për integritetin dhe vazhdimësinë e besimit. Anëtarët e shëndetshëm i përku-shtohen mbrojtjes së gjërave thelbësore të ungjillit (Fil. 1:27; Juda 3), por u shmangen polemikave dhe zënkave për gjëra që s’janë thelbësore për ungjillin. Udhëzimet e apostullit Pal për Timoteun janë me vend:

Ua kujto atyre këto gjëra, duke u përbetuar përpara Zotit të mos hahen kot me fjalë pa asnjë dobi, në dëm të atyre që dëgjojnë. Mundohu të dalësh përpara Perëndisë si i sprovuar, si punëtor që nuk ka pse të turpërohet, që thotë drejt fjalën e së vërtetës. Shmangu nga fjalët e kota dhe profane, sepse do të çojnë në pabesi, dhe fjala e tyre do të brejë si një gangrenë. (2 Tim. 2:14-17a)

Nga njëra anë, duhet të jemi punëtorë të sprovuar, që e trajtojnë siç duhet fjalën e së vërtetës; nga ana tjetër, duhet të mos jemi fajtorë për nxitje mosmarrëveshesh për gjëra të pavlera. Zënkat për gjëra të vockla dhe të parëndësishme “vetëm sa i shkatërrojnë ata që i dëgjojnë” dhe, si rritje gangrene, të çojnë gjithnjë e më tepër në paperëndishmëri. Le të punojmë për unitetin në besim dhe për paqen në kishat tona, duke mos harruar se “është nder për njeriun kur u largohet grindjeve, por çdo budalla përzihet në to” (Fja. 20:3).

Përmbyllje

Sipas J. I. Packer-it, njohja e Perëndisë fillon me njohjen e fakteve për Të, rreth karakterit të Tij. Po kështu, ajo përfshin dorëzimin e vetes ndaj Perëndisë, sipas premtimit të Tij, që Ai të jetë Perëndia yt përmes pendimit dhe besimit në Jezu Krishtin, Birin e tij. Kjo lloj njohurie e Perëndisë vjen vetëm pasi “mbushesh” thellë nga mesazhi i Biblës, me gjithë temat e saj të pasura. Dhe kjo lloj njohurie e Perëndisë u përket veçanërisht atyre anëtarëve të krishterë të kishës, që përkushtohen për t’u bërë teologë biblikë.

Për përsiatje të mëtejshme

1. Sa i familjarizuar je me teologjinë biblike? A mendon se i ke rrokur sa duhet temat dhe zhvillimet kryesore të Biblës? A mund t’i shpjegosh një të krishteri të ri ose një jobesimtari, se si përputhet në tërësi Bibla si një libër i vetëm?

2. Ç’plane specifike mund të bësh për të përforcuar njohurinë që ke për teologjinë biblike?

ANËTARI I SHËNDETSHËM ËSHTË I NGINJUR ME UNGJILLIN

Nevoja më e madhe në botë sot është ungjilli. Kjo është nevoja më e madhe në botë, ngaqë burrat, gratë dhe fëmijët po humbasin pa njohjen jetike të Perëndisë përmes lajmit të mirë të Shpëtimtarit tonë dhe Birit të tij, Jezusit.

Nevoja më e madhe në kishë sot është ungjilli. Ungjilli s'është vetëm lajm për një botë të humbur, por është mesazhi që formëson, mban dhe gjallëron kishën. Veçmas ungjillit, kisha s'ka asgjë për të thënë; pra, s'ka asgjë për të thënë që s'mund të thuhet përmes ndonjë instrumenti tjetër njerëzor. Ungjilli e dallon kishën nga bota, ia përcakton mesazhin dhe misionin në botë dhe i përforcon njerëzit e saj kundër shigjetave të flakta të të Ligut dhe joshjeve të rreme të mëkatit. Ungjilli është absolutisht jetik për një besimtar të krishterë ose kishë të krishterë energjike, të gëzuar, të duruar, shpresëplotë dhe të shëndetshme. Kaq thelbësor është ungjilli për jetën e krishterë, saqë nevojitet të *nginjemi* me të në mënyrë që të jemi anëtarë kishë të shëndetshëm.

Si të mbushemi plotësisht me ungjillin

Atëherë, si mund të “zhytemi” te ungjilli? Cili shteg mund të na çojë në shëndet më të mirë shpirtëror?

NJIH UNGJILLIN

Në rend të parë të ditës kemi të njohim ungjillin. Kjo ngjan kaq e qartë, saqë mund të të duket qesharake kur e pohon. Por, në të vërtetë, shumë nga ata që pohojnë se janë të krishterë dhe se besojnë, zotërojnë një njohuri të cekët të ungjillit si rezultat i dëgjimit, për vite të tëra, të “prezantimeve të shkurtra të ungjillit”, që u ngjiten predikimeve si bisht në fund. Ndërkohë, të tjerë, që e njohin mesazhin e Krishtit, ndihen në siklet dhe të paaftë për të shpallur qartazi lajmin e mirë me familjen dhe miqtë. Prandaj, është e nevojshme ndërmarrja e hapave për t’u siguruar që e njohim ungjillin me njëfarë qartësie dhe thellësie.

Është e dobishme të përjashtojmë disa ide që, shpesh, paraqiten sikur janë ungjilli. Ungjilli *nuk* është thjesht koncepti se (a) jemi në rregull, (b) se Perëndia është dashuri, (c) se Jezusi dëshiron të bëhemi miq me të, ose (d) se duhet të jetojmë siç duhet.¹ Po kështu, ungjilli s’është thjesht ideja se të gjitha problemet do të na rregullohen nëse ndjekim Jezusin, ose se Perëndia dëshiron të jemi të shëndetshëm, të pasur dhe të mençur. Të gjitha këto ide mund të jenë të vërteta në njëfarë kuptimi, por, vetëm në një kuptim të pjesëshëm, dhe kurrë si pohim unik dhe i mjaftueshëm se çfarë është ungjilli.

Fjalë për fjalë, ungjilli i Jezu Krishtit është “lajm i mirë”. Si *lajm*, ai përmban pohime faktesh dhe të vërtetash që rrjedhin nga ato fakte. Si lajm *i mirë*, ungjilli ofron shpresën e bazuar në premtimet e Perëndisë dhe e themeluar në faktet dhe të vërtetat historike, që vërtetojnë ato premtime.

¹ Mark Dever, *Nine Marks of a Healthy Church* (Wheaton, IL: Crossway Books), shih kap. 3.

Ungjilli, ose lajmi i mirë, i Jezu Krishtit është se Perëndia Atë, i cili është i shenjtë dhe i drejtë në të gjitha rrugët e Veta, është i zemëruar me mëkatarët dhe ka për ta ndëshkuar mëkatin. Njeriu, i cili i rebelohet sundimit të Perëndisë, është i ndarë nga dashuria e Perëndisë dhe është në rrezik dënimi të përjetshëm dhe të mundimshëm në duart e Perëndisë. Por Perëndia, i cili është edhe i pasur me mëshirë, për shkak të dashurisë së Tij të madhe, dërgoi Birin e Vet të përjetshëm, të lindur nga virgjëresha Mari, që të vdiste si shpengim dhe zëvendësim për mëkatet e popullit rebel. Ndaj, tani, përmes bindjes së përsosur të Birit të Perëndisë dhe vdekjes së Tij me dëshirë në kryq si shpagim për mëkatet tona, të gjithë ata që pendohen dhe besojnë në Jezu Krishtin, duke e ndjekur si Shpëtimtar dhe Zot, do të shpëtohen nga zemërimi i ardhshëm i Perëndisë, do të shpallen të drejtë në sytë e Tij, do të kenë jetë të përjetshme dhe do të marrin Frymën e Perëndisë si një grimcë e lavdive që do të vijnë kur të jemi në qiell me Vetë Perëndinë.

Pikërisht këtë mesazh (të shprehur shkurtimisht këtu) duhet të përthithim, madje duhet të gëzohemi në të, për të qenë anëtarë të shëndetshëm kishe.

KI DËSHIRË TË DËGJOSH UNGJILLIN DHE PREDIKOJA VETES UNGJILLIN

Duhet të kultivojmë dhe të ruajmë një dëshirë të pangopur për këtë mesazh. Dëgjimi dhe eksplorimi i rregullt i thellësive të ungjillit na rrit njohurinë që kemi për mesazhin, dashurinë për Shpëtimtarin dhe aftësinë për ndarjen e atij mesazhi.

Kështu, duhet të dëgjojmë në mënyrë aktive për ungjillin dhe për rrjedhojat e ungjillit në predikime. Mos i fik

veshët kur pastori fillon t'u bëjë thirrje me mesazhin e ungjillit jo të krishterëve. Dëgjoje sikur e dëgjon për herë të parë. Ripoho besimin tek e vërteta e ungjillit, premtimet dhe forca e tij në jetën tënde. Zbatoje për ndonjë mëkat që mund të të ketë shkuar ndërmend përmes predikimit ose vetëshqyrtimit. Shih gozhdimin e mëkateve të tua në kryq kur dëgjon lajmin e mirë. Mendo nëse në predikim po përfshihet ndonjë premtim ose aspekt i ri i ungjillit. Si do të mbahesh fort tek ato të vërteta?

Dëgjo kaç aktivisht dhe me kaç përmallim për këtë lajm, sa të ndiesh varfërinë dhe kequshqyerjen tënde kur ai mungon në ndonjë predikim. Dhe, kur ta gjesh veten të pakënaqur ose të përmalluar, predikojta vetes ungjillin. Është një mesazh që vjen te ti dhe për ty. Përvetësoje. Në vend që thjesht të dëgjosh të tjerët, ose të dëgjosh atë zë që të torturon me dyshime, shqetësime dhe frikë, dëgjo zërin e Perëndisë në ungjill, duke ia shpallur vetes kur del nevoja. C. J. Mahaney, në librin e tij të shkëlqyer dhe të dobishëm *Living the Cross Centered Life: Keeping the Gospel the Main Thing (Praktika e jetës me qendër kryqin: të mbajmë ungjillin si gjënë parësore)*, na sugjeron që ta mësojmë përmendësh ungjillin, të lutemi me ungjillin, ta këndojmë ungjillin, të shqyrtojmë se si na ka ndryshuar ungjilli dhe ta studiojmë ungjillin.

ÇOJE UNGJILLIN NË PËRFUNDIMIN E VET

Kur të reflektosh për ngjarjet dhe premtimet e ungjillit, “çaj” përpara drejt përfundimit të ungjillit. John Piperi na kujton se Perëndia është ungjilli, se ungjilli është një mesazh për Perëndinë, që jep Vetën për ne në dashuri:

Derisa **ngjarjet** ungjillore të së Premtes së Mirë dhe Pashkës, si dhe **premtimet** ungjillore të shfajësimit dhe jetës së përjetshme, të të drejtojnë të kundrosh dhe të përqafosh **Vetë Perëndinë** si gëzimin më të lartë, s'e ke përqaftuar ende ungjillin e Perëndisë. Ke përqaftuar disa nga dhuratat e Tij. Je gëzuar për disa nga shpërblimet e Tij. Je mrekulluar nga disa prej mrekullive të Tij. Por nuk je zgjuar ende të kuptosh se pse kanë ardhur dhuntitë, shpërblimet dhe mrekullitë. Ato kanë ardhur për një arsye madhore: që ti të mund të soditësh përjetësisht lavdinë e Perëndisë në Krishtin dhe, duke e soditur, të bëhesh ai lloj njeriu që gëzohet në Perëndinë mbi gjithçka tjetër dhe, duke u gëzuar, të shfaqësh përjetësisht bukurinë dhe vlerën e Tij të epërme me një shkëlqim dhe lumni gjithnjë e më të madhe.¹

ORIENTOJE JETËN RRETH UNGJILLIT

Si anëtarë kishe, synimi ynë është ta kuptojmë ungjillin kaq thellë dhe kaq ngushtësisht, sa kjo t'i japë gjallëri çdo aspekti të jetës sonë. Duam që ungjilli të ketë rol qendror në komunikimin me të tjerët, rol qendror në mënyrën si inkurajojmë dhe ndreqim njëri-tjetrin, rol qendror në karrierën individuale dhe vendimet në marrëdhënie, rol qendror në vendimet që kisha merr në mënyrë kolektive dhe rol qendror në të gjitha zakonet në jetë. Duam që ungjilli, si dhe Perëndia i ungjillit, të marrë përparësi në çdo aspekt të jetës. Anëtarët e kishës që janë të nginjur me ungjillin

¹ John Piper, *God Is the Gospel: Meditations on God's Love as the Gift of Himself* (Wheaton, IL: Crossway Books, 2005), 38. Kursivet janë të origjinalit.

duhet të shqyrtojnë një sërë strategjish për ta organizuar jetën rreth lajmit të mirë të Jezus Krishtit:

- frekuentoni qëllimisht të njëjtat mjedise (lavanderi, restorante etj.), me synim që të ndërtoni marrëdhënie dhe njohje me personelin e mjediseve në fjalë dhe, me shpresë, që të keni biseda për ungjillin;
- përdorni pushimet për udhëtime afatshkurtra misionare;
- dilni vullnetarë në organizata komunitare për të ushtruar ndikim për ungjillin;
- organizoni diskutime në shtëpitë tuaja në lidhje mbi besimin dhe filozofinë;
- ftoni fqinjët për darkë ose për mbrëmje ditësh festash dhe flisni me ta për Krishtin;
- organizoni studime biblike në vendet e punës;
- bëhuni pjesë e klubeve të lagjes (klube kopshtarie, klube çiklistësh etj.), për të ndërtuar marrëdhënie dhe për të krijuar më tepër mundësi për ungjillin;
- ftoni miqtë në kishë dhe në ngjarje fetare të veçanta, ku ungjilli do të ketë me siguri pozicion qendror.

Duhet të kuptojmë se s'ka asnjë rrezik kur shpall ungjillin, por ka vetëm shpërblim për besnikërinë. Duam të jemi “në gjendje gatishmërie” me fjalët e jetës.

SHBALLU UNGJILLIN TË TJERËVE

Nganjëherë, duket sikur disa të krishterë besojnë se ungjilli duhet predikuar gjerësisht derisa të mbërrinte te ta dhe, pastaj, duhet ruajtur i sigurt në kasafortën e historisë së tyre vetjake, larg çdokujt tjetër. Të krishterët mund të supozojnë

se thjesht ndarja e dëshmisë së tyre ose praktika e një jete të mirë të krishterë është dëshmi po aq e efektshme sa edhe kryerja e ungjillëzimit. S'ka dyshim se një jetë e tillë është njëfarë dëshmie. Por a është dëshmi për kryqin e Jezus Krishtit? A i drejton njerëzit në mënyrë të efektshme te kryqi dhe te Shpëtimtari "dëshmimi" përmes dëshmimeve dhe veprave tona të mira?

Në një numër tepër të madh rastesh këto lloj përpjekjesh lënë vetëm një përshtypje të vagullt fetarie, por jo një shfaqje të lavdishme të lavdive të Perëndisë në shpengimin e mëkatarëve përmes flijimit të Birit të vet. Nëse duam të kontribuojmë në shëndetin e bashkësive tona lokale, duhet të jemi të përkushtuar jo vetëm për të korrur ungjillin për vete, por edhe për t'ua çuar të tjerëve. Duhet të kryejmë punën e ungjilltarit. Me urgjencë dhe dashuri duhet t'u themi jobesimtarëve mes nesh të pendohen për mëkatet dhe të besojnë në Jezu Krishtin. Duhet t'u themi se kthimi te Perëndia nuk çon në një jetë të lehtë, por ky vendim ia vlen mbi çdo gjë. Falja dhe kënaqja për të cilat përmallohet shpirti ynë gjenden vetëm në personin e Jezu Krishtit.

Ne kemi mundësinë që të përmirësojmë punën e pasorit tonë duke mbjellë dhe ujitur farat e ungjillit ndërsa ai mbjell dhe ujit përmes shërbesës së tij në foltore. Mund të përshëndesim vizitorët në kishë, të flasim me ta dhe të ftojme familjen dhe miqtë tanë jo të krishterë. Rastin e vizitës së tyre duhet ta përdorim për të diskutuar për gjëra shpirtërore, sidomos njohurinë dhe pranimin (ose refuzimin) e lajmit të mirë nga ana tyre. Jeta e nginjur me ungjillin është një jetë që e shpërndan bujarisht lajmin e mirë te të tjerët. Pjesërisht, kisha e shëndetshme ndërtohet mbi anëtarë të shëndetshëm e të motivuar nga ungjilli.

MBRO UNGJILLIN

Së fundi, anëtari i shëndetshëm e merr seriozisht përgjegjësinë e mbrojtjes së ungjillit nga deformimi dhe braktisja. Dhiata e Re duket se këtë përgjegjësi ia vendos në shpatulla bashkësisë, jo vetëm pastorëve. Kur kishat në Galaci po turbulloheshin nga mësuesit e rremë, që po përpiqeshin t'u shtonin kërkesave të ungjillit edhe rrethprerjen, apostulli Pal nuk u shkroi pastorëve dhe pleqve, por vetë kishave. Ai iu drejtua anëtarëve dhe u bëri thirrje të mbronin ungjillin që u kishte predikuar. Udhëzimi i tij është i fortë:

Por edhe sikur ne, ose një engjëll nga qielli, t'ju predikonte një ungjill të ndryshëm nga ai që ju kemi predikuar, qoftë i mallkuar. Siç ju thamë më parë, po jua them edhe tani: nëse dikush po ju predikon një ungjill të kundërt me atë që keni marrë, le të jetë i mallkuar në jetë të jetëve. (Gal. 1:8-9)

Galatasit, madje dhe gjithë anëtarët e krishterë të kishave, duhet të tregojnë kujdes në lidhje me ato që pranojnë në predikimin e ungjillit. Apostulli Gjon i paralajmëron lexuesit e vet se “nëse ju vjen dikush dhe nuk ju sjell këtë mësim, mos e pranoni në shtëpi, as mos u takoni me të, sepse kushdo që e përshëndet bëhet pjesë e punës së tij të ligë” (2 Gjoni 10-11). Pjetri u kujton lexuesve të vet se ata që ndjekin “udhët e turpshme” të mësuesve të rremë bëjnë “që udha e së vërtetës të blasfemohet” (2 Pjet. 2:2). Prandaj, është e kuptueshme pse Juda i nxit lexuesit e vet: “luftoni për besimin që iu përçua shenjtorëve një herë e përgjithmonë” (Juda 3). Kisha e shëndetshme dhe anëtari i shëndetshëm

mbrojnë dhe luftojnë për ungjillin apostolik që përçohet dhe ruhet në faqet e shkrimit. Kur nuk e pranojmë atë përgjegjësi dhe nuk jemi vigjilentë për të kuptuar dhe zbatuar ungjillin, ne lejojmë që ai të shprishet, abuzohet dhe braktiset nga mësuesit e paskrupullt dhe forcat e të ligut.

Përmbyllje

Në ungjillin e Jezu Krishtit Perëndia ofron Vetën për mëkatarët dhe u ofron Vetën mëkatarëve. Pikërisht ungjilli është ai që na bën të vetëdijshëm për dashurinë e Perëndisë, për zvetënimin dhe nevojën tonë për shpëtim, si dhe për mundësinë e gëzimit të përjetshëm përmes adhurimit të Perëndisë. Është po ky ungjill, si dhe kuptimi i shëndetshëm i tij, ai që krijon shëndet dhe forcë në anëtarët e kishës së krishterë. Le të nginjemi me të!

Për përsiatje të mëtejshme

Çfarë strategjish do të zbatosh për të menduar, zbatuar dhe ndarë vazhdimisht ungjillin?

Për lexim të mëtejshëm

Bridges, Jerry. *The Gospel for Real Life*. Colorado Springs, CO: NavPress, 2003.

—. *The Discipline of Grace*. Colorado Springs, CO: NavPress, 1994.

Mahaney, C. J. *Living the Cross Centered Life: Keeping the Gospel the Main Thing*. Sisters, OR: Multnomah, 2006.

Piper, John. *God Is the Gospel: Meditations on God's Love as the Gift of Himself*. Wheaton, IL: Crossway, 2005.

Spurgeon, Charles. *The Power of the Cross of Christ*. Seattle, WA: YWAM Publishing, 1996.

Stott, John. *The Cross of Christ*. Downers Grove, IL: Intervarsity, 2006 (botimi për përvjetorin e njëzetë).

ANËTARI I SHËNDETSHËM ËSHTË I KTHYER ME TË VËRTETË NË BESIM

Miku im Curtis zotëron një gëzim të krishterë që të bën për vete. E do Zotin dhe është i zellshëm në ungjillëzim. Zelli i Curtis-it karakterizohet nga gatishmëria “për të bërë çfarëdo gjë që nevojitet” për ta bërë dikë “të rrëfejë besimin në Krishtin”.

Një ditë, Curtis, me gëzimin e vet të zakonshëm, më foli për një shok të përbashkët, Kenny-n, i cili “kishte lindur sërish”. Më la përshtypje kjo përzgjedhje fjalësh nga ana e Curtis-it. Kalova përtej ngazëllimit të tij dhe e pyeta:

- Nga e di ti që ai “ka lindur sërish”?

Curtis-i u zbraps disi, me kokën e anuar nga kureshtja që shfaqin ndonjëherë konet ndaj sjelljes së çuditshme njerëzore:

- Ç’do të thuash me këtë?

- Po ja, si mund të jesh kaq i sigurt se ka ndodhur rilindja shpirtërore?

Çlirimi mbuloi fytyrën dhe shpatullat e Curtis-it.

- O, e lehtë fare. Ai doli përpara pas shërbesës dhe u lut që të pranonte Krishtin...: mënyra se si shpëtohen shumë njerëz.

Një vit pas bisedës me Curtis-in, ai më telefonoi, tejet i

shqetësuar. Një problem që e shqetësonte vazhdimisht po i shkaktonte sërish siklet; vetëm se, kësaj here, kishte të bënte me shokun tonë, Kenny-n. Curtis-i më tregoi se si Kenny e kishte filluar mirë garën e krishterë, duke marrë pjesë në shërbesa publike, duke u lutur me zell, duke dalë me skuadra ungjillëzimi dhe, nganjëherë, duke treguar shumë emocion gjatë shërbesave publike.

- Viti i parë ishte i shkëlqyer, - më lajmëroi Curtis.

- Por, pastaj, - dhe zëri filloi t'i ulej, - Kenny thjesht u venit. U duk sikur thjesht avulloi... Dhe, tani, ka probleme martesore dhe po mendon ta lërë besimin.

Për një çast, linjën telefonike e pushtoi heshtja. Pastaj, Curtis-i më pyeti:

- Si mendon, a ishte shpëtuar ndonjëherë vërtet Kenny? Si mund ta dish nëse dikush ka lindur sërish?

Të kuptojmë si duhet kthimin në besim

Teksa po mendojmë me kujdes për një listë karakteristkash që duhet të ketë anëtari i shëndetshëm i kishës, mund të argumentojmë me të drejtë se duhet t'ia nisim pikërisht nga kjo pikë: nga fakti se anëtari i shëndetshëm duhet të jetë njeri i kthyer me të vërtetë në besim. Anëtari i shëndetshëm, pra, anëtari i vërtetë i kishës duhet të njohë veprën e hirit të Perëndisë në shpirtin e vet. Ne duhet të jemi vetë të kthyer në besim. Kjo mund të tingëllojë si e qartë, por ndoshta, 40 për qind e njerëzve që intervistoj për anëtarësim në kishën tonë lokale më tregojnë për një kohë kur ishin anëtarë kishe, por nuk e kuptonin ungjillin dhe, sipas vlerësimit të tyre, nuk ishin kthyer vërtet në besim. Kjo përvojë është e përhapur gjerësisht. Edhe të krishterë të famshëm si Xhon Uezli mund të tregojnë një histori të tillë.

Të kuptojmë kthimin biblik në besim

Pa dyshim, një nga arsytet e numrit të stërmadh të të krishterëve formalë (pra, të atyre që e mbajnë besimin vetëm sa për emër) në historinë e kishës së krishterë është se kishat s'kanë arritur të përqafojnë dhe t'u mësojnë të tjerëve kuptimin biblik të kthimit në besim. Nëse duam që ta kuptojmë siç duhet kthimin në besim, duhet t'ia fillojmë me diagnozën që jep Bibla për njeriun e rënë. Për të dhënë trajtimin dhe kurimin e duhur, duhet të dallojmë sëmundjen.

Të gjithë njerëzit vuajnë nga sëmundja e mëkatit. Njerëzit, jo vetëm mëkatojnë, por edhe janë mëkatarë nga natyra (Efe. 2:1-3). Në rrënjën, thelbin dhe zemrën e vet njeriu është i ndarë nga Perëndia dhe armiqësor me të. Ai parapëlqen më tepër të kënaqë epshet dhe dëshirat e veta mëkatore sesa të nderojë dhe të adhurojë Perëndinë..., madje, aq shumë, sa është skllav i mëkatit.

Sepse ata që rrojnë sipas mishit e çojnë mendjen në gjërat e mishit, por ata që rrojnë sipas Frymës në gjërat e Frymës. Në fakt mendja e kontrolluar nga mishi prodhon vdekje, por mendja e kontrolluar nga Fryma prodhon jetë dhe paqe. Në fakt mendja e kontrolluar nga mishi është armiqësi kundër Perëndisë, sepse nuk i nënshtrohet ligjit të Perëndisë dhe as nuk mundet. Prandaj ata që janë në mish nuk mund t'i pëlqejnë Perëndisë. (Rom. 8:5-8)

Për shkak se njeriu është mëkatar nga natyra, është fajtor para Perëndisë dhe meriton ndëshkimin që premtion Perëndia. Nëse nuk ndodh një ndryshim rrënjësor dhe i thellë në gjendjen e tij shpirtërore, njeriu është i destinuar

për gjykim. Me mendjen e fiksuar te ligësia, ai s'mund ta kënaqë Perëndinë, madje as e dëshiron këtë. Ai ka dëshpërimisht nevojë që të ndryshohet. I nevojitet një zemër e re.

Ky ndryshim rrënjësor është ajo që teologjia e krishterë e quan “kthim në besim”. Kthimi në besim është kthimi rrënjësor nga jeta e skllavëruar që ndjek mëkatin në jetën e lirë që ndjek dhe adhuron Perëndinë. Kthimi është ndryshim jete, jo thjesht vendim. Ky ndryshim s'është çështje ndershmerie morale, ecje me forcat e tua apo thjesht modifikim sjelljeje. Ai nuk shoqërohet me shfaqje të jashtme ose praktika fetare, si “dalja përpara kishës”. Nuk mund të arrihet me përpjekje njerëzore, por vetëm me fuqinë e Perëndisë.

Kthimi është një ndryshim kaq dramatik, sa kërkon ndërhyrjen e Perëndisë Frymë. Në kthimin në besim, Fryma e Perëndisë u jep hirin e dyfishtë të pendimit dhe besimit atyre mëkatarëve që i kthejnë kurrizin mëkatis dhe kthehen te Perëndia nëpërmjet besimit në Jezu Krishtin.¹ Rrëfimi i Besimit të New Hampshire, në pikën e tetë, e përcakton mirë kthimin biblik në besim:

Ne besojmë se pendimi dhe besimi janë detyra të shenjta, si dhe hire të pandashme, të kryera në shpirtin tonë nga Fryma rilindëse e Perëndisë; nëpërmjet kësaj, duke u bindur thellësisht për fajin, rrezikun dhe mungesën e shpresës sonë, si dhe për udhën e shpëtimit nëpërmjet Krishtit, ne kthehemi te Perëndia me pendim, rrëfim dhe përgjërëm pa shtirje për mëshirë; në të njëjtën

¹ Shih, për shembull, Gjoni 1:12–13; 3:3–8; 6:44; 15:16; Veprat 11:18; Efe.1:13–14; 2:1–9; 1 Pjet. 1:23; dhe 1 Gjoni 4:10.

kohë, pranojmë me gjithë zemër Zotin Jezu Krisht si Profetin, Priftin dhe Mbretin tonë, si dhe mbështetemi vetëm tek ai si i vetmi dhe i gjithëmjaftueshmi Shpëtimtar.

Pra, kthimi në besim kërkon një bindje të vërtetë për mëkatin, që çon në kthimin mbrapsht (pendimi) dhe në mbështetjen vetëm në Zotin Jezu Krisht për shpëtim (besimi).

Njohja e shpirtit tonë

Po atëherë, si do të ndikojë kuptimi biblik i kthimit në besim në atë që bëjmë praktikisht në kishë? Ia vlen të mendojmë si për rrjedhojat e brendshme, ashtu dhe për ato të jashtme.

Kështu, fillo duke këqyru veten së brendshmi. Duhet të pyesim veten nëse kemi marrë një zemër të ndryshuar nga hiri i Perëndisë përmes besimit në Jezu Krishtin, apo jo. Ky lloj vetëshqyrtimi është një gjë e shëndetshme nga ana shpirtërore. Madje, apostujt i nxitën shpesh lexuesit e tyre që ta bënin këtë (2 Kor. 13:5; Fil. 2:12; 2 Pjet. 1:5-11). Gjëja e parë që duhet të bëjmë është që duhet të njohim shpirtin tonë. A po besojmë vetëm në veprën e përfunduar të Krishtit për shpëtim? A ka prova të hirit të Perëndisë në jetën tonë? A po rritemi në hirin dhe njohurinë e Jezu Krishtit, në frytin e Frymës (Gal. 5:22-24), si dhe në virtytet e përmendura në lumturitë e Krishtit (Mat. 5:3-12)?

Letra 1 e Gjonit është një libër i dobishëm për studim kur shqyrtojmë veprën e Perëndisë në shpirtin tonë. Gjoni ofron një sërë sprovash që i ndihmojnë të krishterët të kuptojnë nëse kanë ardhur në mënyrë shpëtuese në besimin të Krishti apo jo. Në përpjekjen për të njohur pozitën e

shpirtit tonë para Perëndisë, mund ta shqyrtojmë veten në bazë të provave të mëposhtme.

PO ECIM NË DRITË APO NË ERRËSIRË?

“Nëse themi se kemi bashkësi me të, por ecim në errësi, gënjejme dhe nuk po praktikojmë të vërtetën. Por, nëse ecim në dritë, siç është dhe ai në dritë, kemi bashkësi me njëri-tjetrin, dhe gjaku i Jezusit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat” (1 Gjoni 1:6-7). Besimtarët e vërtetë të Krishtit trishtohen për mëkatën e tyre. I urrejnë mëkatet që bëjnë dhe dëshirojnë dritën e jetës në Krishtin, pra, dëshirojnë dhe punojnë për të ecur me ndershmëri dhe drejtësi. Njerëzit që jetojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të papënduar në mëkat, që mohojnë se janë mëkatarë (v. 8-10), nuk janë të kthyer vërtet në besim. “Askush që qëndron në të nuk vazhdon të mëkatojë; askush që vazhdon të mëkatojë s’e ka parë apo njohur atë” (1 Gjoni 3:5).

A E DUAM PERËNDINË ATË?

Disa njerëz duket sikur e duan Jezusin “e butë dhe të përlulur”, por s’tregojnë asnjë ndjenjë dashurie për Perëndinë Atë, i cili u duket se është Perëndia pa dashuri i Dhiatës së Vjetër. Koncepti i Jezusit si Perëndi dashurie dhe tolerance u lëjon disa njerëzve që të besojnë se Perëndia s’do ta gjykojë mëkatën, ose s’do ta dënojë mëkatarin. Ata mund ta shohin Perëndinë Atë si një tiran i Dhiatës së Vjetër dhe mund ta refuzojnë mësimin e Biblës për Perëndinë, pasi u duket i dalë mode, i pakënaqshëm ose i neveritshëm. Por apostulli Gjoni e bën dashurinë për Atin provë të besimit të vërtetë. ‘Mos e doni botën, as gjërat e botës. Nëse ndokush do botën,

dashuria e Atit nuk është në të” (1 Gjoni 2:15). “Kush është gënjeshtari, përveç atij që mohon se Jezusi është Krishti? Ky është antikrishti: ai që mohon Atin dhe Birin. Askush që mohon Birin, s’ka Atin. Kushdo që rrëfen Birin, ka edhe Atin” (1 Gjoni 2:22-23). Ka vetëm një Perëndi: Atë, Bir dhe Frymë e Shenjtë. Është e pamundur të duash edhe botën, edhe Atin. Po kështu, s’ka se si të përqafosh Krishtin pa përqaftuar dhe Atin, ose të vish tek Ati pa besuar në Krishtin. Dashuria për Perëndinë Atë është provë e kthimit të vërtetë në besim.

A I DUAM TË KRISHTERËT E TJERË?

Shumë njerëz duket se jetojnë pa dashuri apo preokupim të vërtetë për të krishterët e tjerë. Ecjen e krishterë e mendojnë si “sport individual”. Mirëpo, “kushdo që beson se Jezusi është Krishti, ka lindur nga Perëndia dhe kushdo që do Atin do këdo që është lindur prej tij” (1 Gjoni 5:1). “Kushdo që nuk ka dashuri, qëndron në vdekje. Kushdo që urren të vëllanë është vrasës, dhe ju e dini se asnjë vrasës nuk ka jetë të qëndrueshme në vetvete” (1 Gjoni 3:14b-15). “Fëmijë të vegjël, le të mos duam me fjalë apo llafë, por me vepra dhe në të vërtetë. Nga kjo do ta dimë se i përkasim së vërtetës dhe do të sigurojmë zemrën tonë para tij” (1 Gjoni 3:18-19). Gjoni na mëson se urdhërimi është të besojmë në emër të Jezu Krishtit dhe të duam njëri-tjetrin. Nëse dashurinë për të krishterët e tjerë e kemi të ftohtë, duhet të shqyrtojmë nëse kemi besuar apo jo në mënyrë shpëtuese në Krishtin Jezus, Birin e Perëndisë.

A E KEMI DËSHMINË E FRYMËS SE JEMI FËMIJË TË PERËNDISË?

“Dhe nga kjo e dimë se ai banon në ne: nga Fryma e Shenjtë të cilin na e ka dhënë” (1 Gjoni 3:24b). Ati nuk na ka lënë pa një dëshmi të dashurisë së Tij. Mund të marrim siguri për birësimin tonë në familjen e Perëndisë nga vetë Perëndia, nga Fryma e Shenjtë, i cili na jep siguri. “Dhe, duke qenë se jeni bij, Perëndia dërgoi Frymën e Birit të tij në zemrat tuaja që thërret: “Abba, Atë!”” (Gal. 4:6; shih dhe Rom. 8:15). “Vetë Fryma i dëshmon shpirtit tonë se jemi fëmijë të Perëndisë” (Rom. 8:16). Ne e dimë se jetojmë në Perëndinë dhe Perëndia në ne, ngaqë kemi marrë Frymën e Shenjtë që në momentin që i besuam ungjillit (1 Gjoni 4:13-14).

A PO KËMBËNGULIM NË BESIM?

“Sepse kushdo që ka lindur nga Perëndia e mposht botën. Dhe kjo është fitorja që ka mposhtur botën: besimi ynë. Kush është ai që mposht botën përveç atij që beson se Jezusi është Biri i Perëndisë?” (1 Gjoni 5:4-5). Ata që besojnë dhe vazhdojnë të besojnë janë ata që kanë mposhtur botën me anë të besimit në Krishtin. Besimi i vërtetë është besim këmbëngulës. Kjo s’do të thotë se gjërat e vështira në jetë nuk na shkaktojnë ndonjëherë dyshime apo shqetësime. Por kjo do të thotë se i krishteri i vërtetë çan përpara në besim, duke i besuar Perëndisë dhe planeve e vullnetit të Tij të mirë. Tek e fundit, ai Frymë që merr besimtari i vërtetë, është i njëjti Frymë që e vulos dhe e ruan besimtarin deri atë ditë (Efe. 1:13-14; 1 Pjet. 1:3-5).

Parashtrimi i këtyre lloj pyetjesh bëhet më së miri në bashkësinë e kishës lokale, ndër të krishterët e përkushtuar

dhe që po rriten, të cilët mund të na ndihmojnë ta hetojmë veten si duhet. Disa njerëz jepen pas një “besimi të kollajshëm”, i cili nuk lejon shërimin e kujdesshëm të shpirtit të tyre, ndërsa disa të tjerë tundohen tepër lehtë nga dyshimi dhe dëshpërimi. Në kulturën e kishës mund ta duam njëri-tjetrin edhe duke vënë në dukje provat e hirrit të Perëndisë në jetën e njëri-tjetrit, por edhe duke bërë pyetje të vështira për rrëfimin dhe ecjen tonë. Duke i bërë të dyja këto, jemi në gjendje ta ndihmojmë njëri-tjetrin për të shmangur ekstremet e dëshpërimit dhe të plogështisë dhe e inkurajojmë njëri-tjetrin që ta shohim veten në dritën e veprës shpëtuese të Perëndisë në shpirtin tonë.

Rrjedhojat për ungjillëzimin

Përveç shqyrtimit të brendshëm (dhe ndihmës që duhet t’u japim të tjerëve për të bërë të njëjtën gjë), duhet të shohim, si të thuash, edhe së jashtmi mënyrën si e kuptojmë kthimin në besim dhe se si ndikon kjo gjë në qasjen e kishës sonë ndaj ungjillëzimit. Kur vjen çështja te ungjillëzimi, anëtari i shëndetshëm duhet të kuptojë siç duhet se kush është ai që e kthen vërtet mëkatarin në besim: ky është Perëndia Frymë. Prandaj, anëtari i shëndetshëm i kishës duhet ta kuptojë se ungjillëzimi nuk është çështje teknikash të zgjuara, por çështje mbështetjeje në Frymën e Perëndisë, që ta bekojë Fjalën e Perëndisë për të shkaktuar rilindje shpirtërore dhe ndryshimin rrënjësor të kthimit në besim. Në kapitullin vijues do të shqyrtojmë më tej ungjillëzimin biblik.

Përmbyllje

Me kalimin e viteve, i kam humbur kontaktet me Kenny-n. Nuk e di nëse po bën jetë të krishterë, apo nëse është kthyer

nga e vërteta te bota. Por e di se është absolutisht thelbësore që Kenny të shqyrtojë veten për të mësuar nëse është apo jo në besim. Dhe e di se ky shqyrtim do të jetë i frytshëm vetëm nëse ai përpiket të zbulojë provat e kthimit në besim që na parashtron Perëndia në Fjalën e vet.

Për përsiatje të mëtejshme

Me një grup anëtarësh dhe miqsh të pjekur të krishterë përdor pyetjet e mëposhtme për të shqyrtuar dhe vërtetuar hirin e Perëndisë mes jush dhe, nëse është e nevojshme, identifikoni zonat ku nevojitet hir.

1. A po ecim në dritë apo në errësirë (1 Gjoni 1:6-7)?
2. A e duam Perëndinë Atë, apo duket se duam botën (1 Gjoni 2:15)?
3. A i duam të krishterët e tjerë (1 Gjoni 3:14-15, 18-19; 5:1)?
4. A e kemi dëshminë e Frymës së Shenjtë se jemi fëmijë të Perëndisë (Rom. 8:15-16; Gal. 4:6; 1 Gjoni 3:24b)?
5. A po këmbëngulim në besim (1 Gjoni 5:4-5)?

Për lexim të mëtejshëm

Murray, John. *Redemption Accomplished and Applied*. Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1984.

Luther, Martin. *The Bondage of the Will*. Grand Rapids, MI: Baker Books, 1990.

Dever, Mark E. *Nine Marks of a Healthy Church*. Wheaton, IL: Crossway Books, 2004 (shih kap. 4).

Smallman, Stephen. *What Is True Conversion?*. Phillipsburg, NJ: P&R, 2005.

Whitney, Donald. *Ten Questions to Diagnose Your Spiritual Health*. Colorado Springs, CO: NavPress, 2002.

ANËTARI I SHËNDETSHËM ËSHTË UNGJILLTAR BIBLIK

Në kapitullin e fundit diskutuam për doktrinën e rëndësishme të kthimit në besim. Atë kapitull e filluam me historinë e Kenny-t, një mik që “kishte bërë rrefim besimi”, por që më vonë i ktheu shpinën Krishtit.

Mjerisht, ajo që unë dhe miku im, Curtis, kemi të qartë tani është se ai “prezantim ungjilli”, që Kenny dëgjoi para ca vitesh, ishte mesazhi më i cekët i mundshëm. Nuk ishte shpallje besnike nga ana e biblike e (1) shenjtërisë dhe drejtësisë së Perëndisë sovran, i cili krijoi gjithçka; (2) gjendjes mëkatore të njeriut dhe gjykimin që i takon atij për shkak se u rebelua kundër Perëndisë; (3) nevojës së njeriut për ndryshim rrënjësor, për një zemër të re dhe drejtësi të përsosur; (4) faktit se vetëm Jezu Krishti na ka siguruar drejtësinë që na nevojitet dhe ka bërë për mëkatet tona atë shlyerje që e kënaq Perëndinë Atë dhe (5) nevojës që Kenny të prodhojë fryte të denja pendese dhe të mbështetet vetëm në Krishtin Jezus.

Jam i sigurt se disa prej këtyre gjërave iu prezantuan Kenny-t. Por, po kështu, jam i sigurt se besnikëria biblike kërkonte *më tepër nga ato që i tha Curtis-i* dhe kërkonte *më tepër prej Kenny-t nga ç'i kërkoi Curtis-i*. Është e frikshme

kur mendon se sa shumë njerëz nuk e kanë shijuar mirësinë e Perëndisë dhe shpëtimin e Tij jo ngaqë të krishterët nuk kanë patur mundësi të flasin me ta, por ngaqë kemi qenë kaq të cekët në ato që u kemi thënë. Anëtari i shëndetshëm i kishës punon për t'u siguruar që ai vetë të jetë i kthyer në besim, por, gjithashtu, punon për t'u siguruar që përpjekjet e tij ungjilëzuese përmbajnë konceptin biblik të kthimit në besim.

Koncepti biblik i ungjilëzimit

Pa konceptin biblik të kthimit në besim dhe të ungjilëzimit, anëtari i kishës ka për të qenë tejet i padobishëm për përmbushjen e misionit të kishës për të bërë dishepuj. Mirëpo, për shkak të magjepsjes së kishës pas metodave dhe teknikave pragmatike (“nëse funksionon, bëje”), është e lehtë që anëtarët të shtyhen në drejtime të pashëndetshme nëse s’e kuptojnë kthimin në besim dhe ungjilëzimin. “Në fund fare, pragmatizmi i paskrupullt është jo vetëm jobesnik, por edhe jopragmatik”.¹

Lajmi inkurajues është se, kur e kuptojmë drejt kthimin në besim, kuptojmë se ungjilëzimi nuk varet nga gojëtaria, përdorimi i dritave sipas atmosferës së duhur, historitë dhe këngët melodramatike, apo reklamat e shitjeve me trysni të lartë. Jemi të lirë që thjesht t'i besojmë thellësisht Perëndisë dhe fuqisë së ungjillit për të prodhuar frytin që dëshiron Ai (Rom. 1:17). E kuptojmë se, ndonëse jemi ambasadorë të Krishtit dhe u përgjrohemi njerëzve që të pajtohen me

¹ Phillip D. Jensen dhe Tony Payne, “Church/Campus Connections: Model 1,” në *Telling the Truth: Evangelizing Postmoderns*, red. D. A. Carson (Grand Rapids, MI: Zondervan), 195.

Perëndinë, është Vetë Perëndia Ai që e bën këtë thirrje përmes nesh, bashkëpunëtorëve të Tij (1 Kor. 3:9; 2 Kor. 5:20; 6:1), dhe Ai që garanton se Fjala e Tij s'do të kthehet bosh është Fryma e Tij (Isa. 55:11). Ne duhet të mbjellim dhe të ujisim me besnikëri, duke besuar me siguri se Perëndia do të na japë rritjen (1 Kor. 3:7).

Kështu, ungjillëzimi biblik na kërkon kryesisht një gjë: që të tregohemi besnikë në shpalljen e lajmit të mirë të Jezu Krishtit para njerëzve me të cilët Perëndia na vë në kontakt (1 Kor. 4:1-2). Në mënyrë të veçantë, ungjillëzimi besnik duhet (1) të jetë specifik për nga përmbajtja, duke paraqitur të vërtetën për “atë që është Perëndia, atë që është njeriu, atë çfarë është mëkati, atë që është Jezusi, atë që Jezusi ka bërë për mëkatin dhe atë që duhet të bëjmë ne me atë që ka bërë Jezusi”, (2) “të përfshijë konceptin se Krishti është udha unike e shpëtimit”, duke përjashtuar idenë se ka rrugë të shumta që të çojnë te Perëndia (Gjoni 14:6; Veprat 4:12); dhe (3) t'i bëjë thirrje dëgjuesit për pendim dhe besim në Krishtin.¹

Ungjillëzimi biblik kërkon transmetimin e lajmit të mirë se Krishti vdiq për mëkatarët dhe, pastaj, na kërkon t'u bëjmë thirrje dëgjuesve që të pendohen dhe të besojnë. Këtë mesazh predikoi Gjon Pagëzori (Mat. 3:1-2). Edhe Jezusi po këtë ungjill shpalli (Mat. 4:17). Dhe apostulli Pjetër, në ditën e Rrëshajave, po këtë lajm të mirë shpalli (Veprat 2:38). Anëtarit i shëndetshëm i kishës i jep vend qendror këtij mesazhi ndërsa përpiqet që të jetë ungjilltar/e besnik/e nga ana biblike.

¹ Michael P. Andrus, “Turning to God: Conversion beyond Mere Religious Preference,” në *Telling the Truth*; shih f. 155–61.

Kryerja e punës së ungjilltarit

Një sërë studiuesish kanë shkruar për të na ndihmuar në punën e shpalljes besnike të lajmit të mirë të Jezu Krishtit. Disa kanë dhënë sugjerime shumë të dobishme dhe praktike. Mark Deveri përvijon gjashtë gjëra që duhet të kenë parasysh anëtarët e kishës në ungjillëzim.¹

- 1) Thuaju njerëzve ndershmërisht se, nëse pendohen dhe besojmë, do të shpëtohen..., veçse kjo do t'u kushtojë.
- 2) Thuaju njerëzve me ngulm se, nëse pendohen dhe besojnë, do të shpëtohen..., veçse duhet të vendosin tani.
- 3) Thuaju njerëzve me gëzim se, nëse pendohen dhe besojnë lajmin e mirë, do të shpëtohen. Sado e vështirë të jetë kjo, ia vlen në çdo mënyrë!
- 4) Përdor Biblën.
- 5) Kupto se jeta e individit të krishterë dhe kishës në tërësi janë pjesë qendrore e ungjillëzimit. Të dyja këto aspekte duhet t'i japin besueshmëri ungjillit që shpallim.
- 6) Mos harro të lutesh.

Michael P. Andrus-i na ofron disa këshilla të dobishme shtesë. Me qëllim që të mbajmë parasysh një pikëpamje të shëndetshme të kthimit në besim në përpjekjet tona ungjillëzuese, ai na sugjeron:

- 1) Këshillo të interesuarit duke u fokusuar te veprat, jo te fjalët; te ndryshimi i jetës, jo thjesht ndryshimi i bindjeve. S'duhet t'u komunikojmë kurrsesi se,

¹ Mark Dever, *Nine Marks of a Healthy Church* (Wheaton, IL: Crossway Books, 2004), 124–30.

thjesht duke i thënë “po” një propozimi, ata mund të marrin sigurinë e jetës së përjetshme.

- 2) Fokusohu në konceptin biblik dhe serioz për mëkat-in dhe fajin.
- 3) Mësoju Biblën dhe doktrinën e krishterë, në mënyrë që besimtarët e mundshëm të kuptojnë se plani i shpëtimit është urtësia e Perëndisë, jo urtësi njerëzore.
- 4) Braktis terminologjinë e cekët të *marrjes së vendimit* (“thjesht beso”, “lutu që të marrësh”, “ftoje Jezusin në zemër”) dhe përdor terminologjinë më të rreptë të kthimit në besim (“dorëzoju sundimit të Jezu Krishtit”, ose “kthehu nga mëkati, prano faljen që bleu Jezusi përmes vdekjes së Vet dhe jeto një jetë bindjeje ndaj Tij”).¹

Kisha lokale në ungjillëzim

Përpos këtyre rekomandimeve të shkëlqyera, anëtari i kishës duhet të kuptojë pozitën qendrore dhe dobinë e kishës lokale në ungjillëzim. Kur përfshihemi në kisha që predikojnë ungjillin, atëherë, me hirin e Perëndisë, ungjilli do të predikohet kur kisha të mbledhet në Ditën e Zotit. Ftesa që u bëjmë miqve tanë jo të krishterë në shërbesat e kishës është mënyrë e shkëlqyer për të çuar më tej bisedat personale që ke pasur me ta në lidhje me ungjillin.

Po kështu, kjo u jep mundësinë që ta shohin ungjillin “të mishëruar” në jetën e një bashkësie reale besimtarësh. Në kishë jobesimtarët duhet të shohin atë lloj uniteti dhe dashurie që dëshmon për të vërtetën dhe fuqinë e ungjillit

¹ Michael Andrus, “Turning to God,” 161–162.

dhe të dashurisë së Perëndisë (Gjoni 13:34-35; 17:20-21). Miqtë tanë do ta shohin ungjillin me sytë e tyre kur të shohin kryerjen e pagëzimit dhe Darkës së Zotit. Si në mënyrën se si jetojmë së bashku si kishë, ashtu dhe në sakramentet e kishës, ne shfaqim ungjillin në mënyra që e plotësojnë fjalën e predikuar të ungjillit.

Për më tepër, përfshirja e familjes sonë dhe miqve tanë jo të krishterë në jetën e kishës është një parashijim i dobishëm i jetës në të cilën u bëhet thirrje të jetojnë nëse Zoti i sjell në pendim dhe besim shpëtues. Kur kisha lokale bëhet pjesë qendrore e përpjekjeve tona ungjillëzuese, kjo na ndihmon ta shkulim individualizmin shpirtëror nga rrënjët që në fillim të jetës së krishterë.

Së fundi, në kishën lokale kemi në dispozicion ndoshta dhjetëra ose qindra aleatë (të krishterët e tjerë), të gjithë me përjetimet e tyre të kthimit në besim dhe me burimet e tyre, të cilët mund të formojnë marrëdhënie me miqtë dhe familjet tona. Shpesh Zotit i pëlqen të përdorë bashkanëtarët tanë për të përçuar fjalën kyçe ose për të treguar shembullin nxitës që e sjell dikë tjetër në shpëtim besues. Mos e lër kishën lokale jashtë përpjekjeve për të fituar të humburit!

Përmbyllje

Dikur mora pjesë në një konferencë ungjillëzimi të sponsorizuar nga një kishë lokale. Folësi kryesor i konferencës i pyeti të pranishmit se cila mendonin se ishte arsyeja numër një që të krishterët nuk e bëjnë punën e ungjilltarit. Të pranishmit dhanë një sërë përgjigjesh të mira, që shkonin nga frika dhe mungesa e njohurisë e deri te moskokëçarja. Folësi i çuditi të pranishmit kur u tha se, pa dyshim, që këto janë probleme, por se problemi numër një është se shumë

e shumë të krishterë nuk e besojnë Romakëve 1:16. Nuk besojnë se ungjilli është fuqia e Perëndisë për shpëtim. U mungon siguria në ungjillin.

Po ti? A je i sigurt se ungjilli është fuqia e Perëndisë për shpëtim? A e tregon këtë lloj sigurie puna jote si ungjilltar? Unë lutem që të gjithë t'u përgjigjemi me "po" këtyre pyetjeve.

Për përsiatje të mëtejshme

1. A i përfshin të gjitha idetë thelbësore të ungjillit mënyra se si ti u flet të tjerëve për Jezusin?
2. A tregon mënyra se si u flet të tjerëve për Jezusin se ke siguri në vetë mesazhin e ungjillit, pra, në faktin se ai është fuqia e Perëndisë për shpëtim?
3. Si do ta ndryshonte një kishë me anëtarë thellësisht të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit perceptimin e kishës në komunitet.

Për lexim të mëtejshëm

Carson, D. A., red. *Telling the Truth: Evangelizing Postmoderns*. Grand Rapids, MI: Zondervan, 2000.

Dever, Mark E. *The Gospel and Personal Evangelism*. Wheaton, IL: Crossway, 2007.

Metzger, Will. *Tell the Truth: The Whole Gospel to the Whole Person by Whole People*. Downers Grove, IL: InterVarsity, 2002.

Packer, J. I. *Evangelism and the Sovereignty of God*. Downers Grove, IL: InterVarsity, 1991.

Stiles, Mack. *Speaking of Jesus: How to Tell Your Friends the Best News They Will Ever Hear*. Downers Grove, IL: InterVarsity, 1995.

SHENJA 6

ANËTARI I SHËNDETSHËM ËSHTË ANËTAR I PËRKUSHTUAR

Kur ishte djalë i ri, qëndrimi i Joshua Harris-it për kishën pasqyrore atë të shumë njerëzve sot. Harrisi shkruan:

Kur dola nga grupi i të rinjve të shkollës së mesme të kishës sime, fillova të vizitoja kisha të ndryshme. E doja Perëndinë dhe kisha ëndrra të mëdha se si doja që t'i shërbeja, por s'shijja asnjë arsye pse të përfshihesha së tepërmi në një kishë të vetme. Në atë kohë, mendoja se dija gjithçka të mundshme për kishën dhe s'më linte përshtypje. Shumica e kishave më dukeshin të dala mode dhe jashtë kontaktit me njerëzit. Duhet të kishte mënyra më të mira dhe më të efektshme për të arritur gjëra madhështore për Perëndinë.¹

Ai e konsideronte kishën si dytësore, demode, të paefektshme dhe pengesë. Jo se ai s'e donte Perëndinë apo njerëzit e Perëndisë. Vetëm se nuk mendonte se ishte e rëndësishme t'i përkiste një kishë të caktuar, madje kjo mund të shndërrohej në pengesë.

¹ Joshua Harris, *Stop Dating the Church* (Sisters, OR: Multnomah, 2004), 13.

Joshua s'është i vetëm. Shumë njerëz mendojnë se kisha (sidomos anëtarësimi në kishë, pra, firmosja dhe bashkimi me atë kishë) është një relikte shpirtërore e destinuar të pengojë lirinë dhe frytshmërinë shpirtërore.

Arsyet për këtë pikëpamje të anëtarësimit në kishë janë të shumta. Disa të krishterë janë thjesht krejt *moskokëçarës* për anëtarësimin në kishë. S'ë kanë problem ta pranojnë apo ta refuzojnë; s'ndihen as të ngazëllyer, as negativë ndaj kishës. Ajo thjesht s'ka rëndësi për ta.

Disa të tjerë janë *të paditur*. Janë të painformuar. S'ë kanë marrë kurrë në konsideratë pikëpamjen e Biblës për kishën lokale.

Ka dhe të tjerë që janë *të pavendosur*. S'ë mbledhin dot mendjen që t'i bashkohen kishës. Ndoshta, janë ata lloj njerëzish që kurrë s'marrin dot vendime; vendimet thjesht u ndodhin rastësisht.

Pastaj, janë dhe tipat *e pavarur*. Ata janë "gjuetarët e vetmuar", që s'duan të ngarkohen me barrët e anëtarësimit të kishës. S'duan që njerëzit "t'i fusin hundët në punën e tyre". Duan të hyjnë në një kishë, të hanë ç'u nevojitet dhe të largohen të palidhur.

Së fundi, ka dhe nga ata që e marrin shtruar përkushtimin ndaj një kishe lokale, ngaqë ndjenjat i kanë *të anasjella*. Ata kanë lidhje të forta me një "kishë nënë" në qytetin ku ishin rritur e, megjithatë, me trup janë qindra kilometra larg. S'u bën zemra t'i bashkohen një kishe në vendin ku jetojnë, ngaqë s'janë ndarë kurrë emocionalisht nga kisha e së shkuarës.

Në themel, të gjitha këto pikëvështrime për kishën lokale rrjedhin nga i njëjti problem: mosarritja për të kuptuar ose marrë seriozisht synimin e Perëndisë që kisha lokale të ketë rol qendror në jetën e popullit të Tij. Njerëzit

nuk bëhen anëtarë të përkushtuar (dhe, si rrjedhojë, të krishterë të shëndetshëm), ngaqë nuk e kuptojnë se ky lloj përkushtimi është pikërisht synimi që ka Perëndia për popullin e Vet: që ata të jetojnë besimin dhe të përjetojnë dashurinë e krishterë.

A është ide biblike “anëtarësia e kishës”?

Kur njerëzit ndeshen për herë të parë me idenë se anëtarësimi në kishë është i nevojshëm dhe i rëndësishëm, shumë prej tyre duan të dinë: “A është e rëndësishme ideja e anëtarësimit në kishë? Ku mund ta gjej në Bibël?”

Ashtu si për shumë gjëra të tjera, s’mund të shkosh në Bibël të “Libri i anëtarësimit të kishës”, apo të ndonjë kapitull që botuesit e Biblës e kanë titulluar në mënyrë të volitshme “Si të bëhesh anëtar”. Të dhënat biblike s’janë kaq të dukshme; sidoqoftë, ideja e anëtarësimit është pothuajse gjithkund në Shkrim.

E ke menduar ndonjëherë se sa shumë praktika dhe porosi që iu dhanë kishës së Dhiatës së Re e humbasin gjithë kuptimin e tyre nëse anëtarësia, e identifikueshme në mënyrë të dukshme, nuk praktikohet dhe nuk është e rëndësishme? Ja disa gjëra thelbësore që porositen në Shkrim për kishën lokale, të cilat do ta humbnin kuptimin pa një koncept funksional të anëtarësimit.¹

UDHËHEQJA E KISHËS

Dy pasazhe klasike të Shkrimit përvijojnë për kishën cilësitë që duhet të kenë drejtuesit e saj (1 Tim. 3:1-13; Titi 1:5-9).

¹ Mark Dever dhe Paul Alexander, *The Deliberate Church: Building Your Ministry on the Gospel* (Wheaton, IL: Crossway, 2005), 60–61.

Përveç këtyre cilësive, ka dhe porosi të qarta për drejtuesit që të udhëheqin tufën dhe që të krishterët t'u binden drejtuesve (Heb. 13:17). Mirëpo, nëse s'ka anëtarësim të identifikueshëm, drejtuesit s'kanë se kë të drejtojnë. Nënshtrimi ndaj autoritetit, siç e kërkon Hebrenjve 13:17, bëhet i palogjikshëm nëse drejtuesit nuk janë përgjegjës për një grup dhe nëse ai grup nuk është i lidhur me ta në njëfarë mënyre.

DISIPLINA E KISHËS

Te 1 Korintasve 5, apostulli Pal i udhëzon besimtarët në Korint që “të nxjerrin nga bashkësia” një burrë të përfshirë në shturje seksuale. Zoti Jezus porositi një veprim të ngjashëm te Mateu 18:15-17. Një pjesë e arsyes pse Bibla porositi praktikën e disiplinës kishtare është që të ruhen dallime të qarta mes popullit të Perëndisë (kishës) dhe botës përreth (1 Kor. 5:9-13). Nëse s'ka asnjë mënyrë praktike dhe të dukshme për të përcaktuar se kush i përket kishës dhe kush i përket botës, ky dallim humbet dhe “nxjerrja nga bashkësia” bëhet një diçka e pamundur pasi s'ka asnjë mënyrë reale për të qenë në bashkësi.

MBAJTJA E LISTAVE DHE VOTIMI

Ka ca të dhëna se kisha e hershme mbante disa lista që shoqëroheshin me anëtarësinë. Për shembull, mbaheshin listat e vejushave (1 Tim. 5:9). Po kështu, të krishterët në kishën lokale votonin për disa veprime. Ishte “shumica” ajo që votoi që ta hiqnin atë burrin nga anëtarësia e kishës në Korint (2 Kor. 2:6).

Zgjedhja e drejtuesve, nënshtrimi ndaj tyre, rregullimi i anëtarësisë, mbajtja e listave dhe votimi bëhen veprime të

logjikshme vetëm nëse pranohet një grup i njohur, i identifikueshëm dhe i veçantë. Prandaj, ndonëse Bibla nuk na siguron një trajtesë biblike për anëtarësimin në vetvete, ka prova të mjaftueshme në të dhënat e frymëzuara për të sugjeruar se praktikohej njëfarë forme anëtarësimi, e cila ishte e nevojshme për funksionimin e kishës. Anëtarësimi i kishës sështë më pak i rëndësishëm në kohën tonë.

Thelbi i anëtarësimit: dashuria e përkushtuar

Zoti ynë, Jezusi, veçoi një shenjë përcaktuese të dishepujve të vet. Sigurisht, ka shumë shenja të dishepullit të vërtetë, por njëra veçohet, se i tregon botës që na vëzhgin se ne i përkasim Krishtit:

Një urdhërim të ri po ju jap, që të doni njëri-tjetrin; ashtu siç ju desha unë, kështu duhet ta doni dhe ju njëri-tjetrin. Nga kjo do ta dinë njerëzit se jeni dishepuj të mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin (Gjoni 13:34-35).

Shenja e dishepullizimit të krishterë është dashuria: ajo lloj dashurie që ushtroi Jezusi me ndjekësit e vet, një dashuri aq e dukshme, sa njerëzit do ta kuptojnë se u përket atyre njerëzve që ndjekin Jezusin.

Prandaj, sështë e habitshme që i krishteri i shëndetshëm është ai që i përkushtohet shprehjes së kësaj lloj dashurie ndaj të krishterëve të tjerë. Dhe vendi më i mirë që të krishterët të duan në këtë mënyrë është në asamblenë e popullit të Perëndisë, që quhet kisha lokale. Për këtë arsye, pse të na duket çudi që autori i Hebrenjve na udhëzon të mendojmë “se si të nxisni njëri-tjetrin në dashuri dhe vepra të mira” dhe, menjëherë më pas, thotë: “duke mos hequr dorë nga të

mbledhurit së bashku, siç e kanë zakon disa, por inkurajoni njëri-tjetrin, sidomos që e shihni se Dita po afrohet” (Heb. 10:24-25)? Shkuarja besnike në kishë shoqërohet ngushtë me nxitjen e njëri-tjetrit për dashuri dhe vepra të mira. Kisha lokale është vendi ku dashuria shfaqet më dukshëm dhe më bindshëm mes popullit të Perëndisë. Është vendi ku “trupi i Krishtit” përfaqësohet më dukshëm në botë.

Si duket anëtari i përkushtuar i kishës?

Në një kuptim të caktuar, pyetja “Si duket një anëtar i përkushtuar i kishës?” është dhe thelbi i këtij libri. Por, këtu, duam që këtë pyetje ta eksplorojmë në lidhje me porosinë dhe shenjën thelbësore të dashurisë. Më poshtë, keni disa mënyra se si e shpreh veten anëtarësia e përkushtuar.

FREKUENTON RREGULLISHT KISHËN

Kjo është shërbesa e parë dhe më e rëndësishme e çdo të krishteri në kishën lokale. Prania, njohja dhe aktivizimi janë mënyrat e vetme se si mund të bëhet e mundshme dashuria e krishterë (Heb. 10:24-25).

KËRKON PAQEN

Anëtari besnik shpreh përkushtimin për ruajtjen e paqes në bashkësi. “Le të ndjekim gjërat që nxisin paqen dhe ndërtimin reciprok” (Rom. 14:19). “Dhe fryti i drejtësisë mbillet në paqe për ata që e duan paqen” (Jakobi 3:18).

NDËRTON TË TJERËT

Synimi ose qëllimi i vetëm dhe i vazhdueshëm i takimit publik të kishës është ndërtimi i ndërsjellë, pra, ndërtimi i

njëri-tjetrit në besim (1 Kor. 12, 14; Efe. 4:11-16). Anëtari i shëndetshëm dhe i përkushtuar vjen për të shërbyer, jo për t'u shërbyer, njësoj si Jezusi (Marku 10:45); vjen për të kontribuar, jo thjesht për të konsumuar.

PARALAJMËRON DHE QORTON TË TJERËT

Kjo diskutohet me më tepër hollësi në kapitullin 6, “Kërkon disiplinën”. Anëtari besnik është i përkushtuar për t'u thënë të vërtetën me dashuri vëllezërve dhe motrave, për t'i ndihmuar që t'u shmangen grackave dhe për t'i inkurajuar në shenjtëri dhe gëzim të krishterë. Anëtari i përkushtuar nuk do të ndërhyjë keqas në jetën e të tjerëve (si ngatërrestar), por as nuk do të qëndrojë larg kur vjen puna te përkujdesja dhe këshillimi i të tjerëve.

NDJEK PAJTIMIN

Të krishterët janë njerëz që janë pajtuar me Perëndinë përmes Krishtit. Si rrjedhojë, na është dhënë “shërbesa e pajtimit” (2 Kor. 5:18-21). Prandaj, anëtari i përkushtuar përpigjet t'i riparojë çarjet sa më shpejt të jetë e mundur, madje përpara se të vazhdojë me adhurimin publik (Mat. 5:23-24).

DURON TË TJERËT

Shërbyesit e pajtimit duhet të jenë të duruar dhe zemërbutë. Duhet të karakterizohen nga një përulësi e tillë sa nuk e vlerësojnë veten më tepër nga ç'duhet (Mat. 5:5). Ata duhet të durojnë peshën e zhgënjimeve, acarimeve, humbjes, sulmeve, shpifjeve dhe fyerjeve (Mat. 18:21-22; Rom. 15:1). Duke mbartur barrët e njëri-tjetrit, përmbushim ligjin e Krishtit (Gal. 6:2).

PËRGATITET PËR SAKRAMENTET

Një privilegj i anëtarësimit në kishë është pjesëmarrja në sakramentet e Krishtit: pagëzimi dhe Darka e Zotit. Për më tepër, këto privilegje na sigurojnë një shpallje të dukshme të lajmit të mirë se Krishti vdiq për mëkatarët dhe u ringjall sërish për jetën e përjetshme. Prandaj, është tragjedi e madhe që shumë të krishterë i anashkalojnë sakramentet që na caktoi vetë Jezusi 2 000 vjet më parë. Anëtari i përkushtuar ngazëlleshet nga pagëzimi i besimtarëve të rinj dhe shqyrton zemrën e vet, që të jetë i përgatitur për t'iu bashkuar familjes së Perëndisë në Tryezën e Zotit. Ai i merr këto ushtrime shpirtërore si mjete hiri, mjete që japin dëshmi të dukshme për efektin e ungjillit në jetën e tij dhe në jetën e kishës së mbledhur.

MBËSHTET PUNËN E SHËRBESËS

Anëtari i përkushtuar jep burimet, kohën dhe talentin e vet për përparimin e ungjillit në kishën lokale. Ai praktikon në jetë thirrjen e Biblës për trupin e Krishtit. “Ne kemi dhunti të ndryshme, sipas hirit që na është dhënë. Nëse dikush ka dhunti profecinë, le ta përdorë sipas masës së besimit të vet. Nëse ka shërbimin, le të shërbejë; nëse ka mësimdhënien, le të jap mësim; nëse ka inkurajimin, le të inkurajojë; nëse ka shpërndarjen sipas nevojave të të tjerëve, le të japë bujarisht; nëse ka udhëheqjen, le të drejtojë me zell; nëse ka veprat e mëshirës, le ta bëjë me gëzim” (Rom. 12:6-8). Anëtari i shëndetshëm dhe i përkushtuar merr dhe zbaton hirin e Perëndisë, duke punuar për të mbështetur shërbesën e kishës lokale dhe spikat duke dhënë atë që ka marrë tashmë nga Perëndia në dobi të punës së ungjillit. Ai duhet të

ndjekë shembullin e maqedonasve, të cilët iu përkushtuan një strategjie dhënieje financiare që ishte sakrifikuese, bujare, gjithnjë e më e madhe dhe e ushqyer nga besimi në Perëndinë, pavarësisht situatave të tanishme (2 Kor. 8-9). Çfarë kemi që nuk e kemi marrë fillimisht nga Perëndia? Çfarë kemi që të mos jemi të gatshëm t'ia kthejmë Atij në adhurim?

Përmbyllje

Mospranimi që të shoqërohemi në mënyrë afatgjatë dhe të përkushtuar me Kreun e Kishës, duke iu bashkuar trupit të tij është, pa dyshim, shenjë mosmirënjohjeje, që vjen nga një zemër e painformuar ose e rënduar. Ne që kemi privilegjin të jetojmë në vende ku mund t'i bashkohemi lirisht një kishe lokale duhet të kemi parasysh këtë këshillë të Dietrich Bonhoeffer-it:

Është hir i Perëndisë që një bashkësi i lejohet të mblihdet haptazi në këtë botë për të ndarë Fjalën e Perëndisë dhe sakramentin. Jo të gjithë të krishterët e marrin këtë bekim. Të burgosurit, të sëmurët, të vetmuarit e shpërndarë, shpallësit e ungjillit në tokat pagane qëndrojnë të vetëm. E dinë se bashkësia e dukshme është bekim. Iu kujtohet, njësoj si psalmistit, se si shkonin “me turmën... në shtëpinë e Perëndisë, me zë gëzimi dhe lavdërimi, me një turmë në festë” (Psa. 42:4)...

Prandaj, ai që deri tani ka pasur privilegjin e të jetuarit një jetë të krishterë të përbashkët me të krishterë të tjerë le të përlëvdojë hirin e Perëndisë nga thellësia e zemrës. Le ta falënderojë Perëndinë në gjunjë dhe të

shpallë: është nga hiri, vetëm nga hiri, që na lejohet të jetojmë në bashkësi me vëllezër të krishterë.¹

Për përsiatje të mëtejshme

1. Nga nota 1 deri në 10, si do ta vlerësoje përkushtimin tënd ndaj anëtarësisë në kishën tënde lokale? Nëse vlerësimet nuk i jep notën 10, pse?
2. Në përgjithësi, a i jep kisha jote lokale vëmendjen e duhur anëtarësisë në kishë? A mund të citosh disa pasazhe të duhura biblike për ta mbështetur përgjigjen tënde?
3. Si do t'ia ndryshonte kishës perceptimin në komunitet nëse ajo do të kishte anëtarë thellësisht të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit?

Për lexim të mëtejshëm

Harris, Joshua. *Stop Dating the Church*. Sisters, OR: Multnomah, 2004.

Bonhoeffer, Dietrich. *Life Together*. New York: Harper and Row, 1954.

¹ Dietrich Bonhoeffer, *Life Together* (New York: Harper and Row, 1954).

ANËTARI I SHËNDETSHËM KËRKON DISIPLINËN

Jeta ka nevojë për sistemim. Kjo është një e vërtetë e thjeshtë që, shpesh harrohet ose anashkalohet. Me qëllim që të lulëzojë dhe të rritet, gjithë jeta ka nevojë për rregull.

Prandaj, kaosi është armiku i rritjes. Çorganizimi, pakujdesia dhe pavëmendja, në përgjithësi, shkaktojnë një lloj paqëndrueshmërie që, në vend që të forcojë, dobëson. Aty ku s'ka rregull, me shumë gjasa në atë vend do të ketë pak gjëra që nxisin mbarështimin dhe ushqyerjen. Jeta ka nevojë për rregull.

Çiftet e sapomartuara e zbulojnë këtë kur Perëndia u jep fëmijë. Jeta e tyre, deri në atë pikë, mund të jetë karakterizuar nga një qëndrim “ku rafsha, mos u vrafsha”, por, shumë shpejt, e kuptojnë se, për t'u përkujdesur për një fëmijë dhe për ta edukuar, do t'u duhet të mbajnë njëfarë rregulli të caktuar. Duhet të përcaktojnë një rutinë gjumi dhe ushqyerjeje. Duhet të heqin sendet e vogla dhe të rrezikshme. Duhet mbuluar prizat. Duhet siguruar, në kohën e duhur, ndërrimet e pelenave, banjat dhe veshjet e pastra. Që të ndodhë rritja, duhet të mbizotërojë rregulli. Ky është një fakt i jetës.

Por rregulli është i nevojshëm edhe në çështjet shpirtërore. Pa caktimin e duhur të rutinave, caqeve dhe modeleve lulëzimi shpirtëror ka shumë gjasa të mos ndodhë, ose, më së tepërmi, do të jetë i hallakatur. Një tjetër fjalë që përshkruan rregullin e nevojshëm për t'u rritur shpirtërisht është *disiplina*.

Çfarë është disiplina?

Sot, kur njerëzit dëgjojnë fjalën *disiplinë*, më së tepërmi u shkojnë në mendje forma negative ndëshkimi, si shuplakat në të ndenjurat e një fëmije të pabindur. Për shumë njerëz disiplina ka tingëllim të ashpër; është diçka që duhet shmangur ose diçka që e kryejnë vetëm njerëzit e këqij ose të pamëshirshëm. Disa të tjerëve ajo u tingëllon si diçka që pengon lirinë dhe gëzimin. Pa dyshim, disiplina nuk është gjithmonë përjetim i këndshëm. Këtë e vë në dukje shkruesi i Hebrenjve: “Aty për aty, çdo disiplinë duket e dhimbshme, jo e këndshme” (Heb. 12:11).

Por, realisht, fjala *disiplinë* ka një kuptim shumë më të gjerë dhe më pozitiv sesa “ndëshkim i pakëndshëm”. *Disiplina* dhe *dishepulli* ndajnë të njëjtën rrënjë latine dhe janë të lidhura ngushtë me idenë e edukimit dhe të rregullit. *Dishepulli* është nxënës, një njeri që merr pjesë në një disiplinë të caktuar, që mëson një profesion, ose që zotëron një grup mendimi. Ky person e rregullon jetën sipas rregullave të një profesioni të caktuar. Kështu, atletët profesionistë zbatojnë rregullat e sporteve të tyre. Profesorët e psikologjisë i përkushtohen kësaj ose asaj shkolle mendimi. Mjekët zbatojnë parimet e Shoqatës Amerikane të Mjekëve ose Betimit të Hipokratit. Të gjithë këta janë dishepuj të (ose disiplinohen sipas) parimeve të fushës së tyre.

E njëjta gjë vlen dhe për kishën. Kisha është një vend ku gjithçka në shërbesat e tubimeve të saj duhet “kryer siç ka hije dhe me rregull” (1 Kor. 14:40). Ai rregull është i domosdoshëm për ndërtim.

Dhe disiplina është e nevojshme edhe në jetën e besimtarëve si individë.¹ Jay Adams-i e përmbloodhi siç duhet lidhjen mes disiplinës së rregullt, nxënies dhe jetës së krishterë: “Kur pagëzohemi në kishë, në këtë mënyrë, regjistrohemi në shkollën e Krishtit. Pastaj, gjatë gjithë pjesës tjetër të jetës në tokë na mësohet (jo thjesht faktet, por bashkë me faktet) t’u bindemi urdhërimeve të Krishtit. Ky është edukim me fuqi, edukim i mbështetur nga disiplina e rregullit të mirë, gjë që është e nevojshme me qëllim që të kryhet nxënia”²

Kështu, disiplina lidhet me edukimin dhe nxënien, rëndin dhe rritjen. Pikërisht disiplina në jetën e bashkësisë dhe të anëtarit të shëndetshëm është ajo që siguron atmosferën për rritjen dhe zhvillimin. Ajo çon në xhevahirin e rrallë e të pastruar të ngjashmërisë me Krishtin.

Si duket disiplina në jetën e një anëtari të shëndetshëm të një kise?

Në jetën e bashkësive të shëndetshme dhe të anëtarëve të shëndetshëm ka dy forma disipline. Të dyja këto qasje ndaj disiplinës e kanë fillesën te Fjala e Perëndisë dhe, madje, janë dy mënyra se si ta kuptojmë synimin dhe efektin e Fjalës së Perëndisë në jetën e popullit të Tij.

¹ Shih, për shembull, 1 Thes. 4:22 dhe 2 Thes. 3:6, 11.

² Jay Adams, *Handbook on Church Discipline: A Right and Privilege of Every Church Member* (Grand Rapids, MI: Zondervan, 1974), 16.

Apostulli shkruan tek 2 Timoteut 3:16: “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe është i dobishëm për mësim, për qortim, për ndreqje dhe për edukim në drejtësi”. Me fjalë të tjera, Shkrimi, që është i “frymëzuar” nga Perëndia, ka dy synime të përgjithshme: *disiplinën formuese* dhe *disiplinën ndreqëse*. Kur Pali shkruan se Shkrimi është “i dobishëm për mësim” dhe për “edukim në drejtësi”, po përshkruan disiplinën pozitive ose formuese. Disiplina formuese ka të bëjë me mënyrën se si Shkrimi modelon dhe formëson të krishterët ndërsa ai ose ajo përvetëson mësimin e Shkrimit dhe edukohet për të jetuar për Perëndinë. Ashtu si mjekët drejtohen nga standardet ose betimet e profesionit të tyre, të krishterët formësohen dhe drejtohen nga Fjala e Perëndisë.

Në mënyrë të ngjashme, kur Pali i quan Shkrimet të dobishme “për qortim, për ndreqje”, po përshkruan mënyrën se si Fjala e Perëndisë na ballafaqon dhe na largon nga gabimi drejt drejtësisë. Kjo është disiplina ndreqëse.

Pjesa dërrmuese e disiplinës në çdo kishë ka për të qënë disiplina pozitive ose formuese, kur besimtarët rriten nga Fjala e predikuar, kur studiojnë Shkrimet gjatë devocioneve personale dhe kur formësohen nga bashkësia dhe inkurajimi prej vëllezërve në Krishtin. Por, hera-herës, ndonjë vëlla ose motër do të zhytet në mëkat dhe do të ketë nevojë për ndreqjen ose qortimin e dashur të anëtarëve të tjerë të kishës, të cilët janë të përkushtuar për mbarëvajtjen e shpirtit të tij ose të saj. Për më tepër, Shkrimet flasin për një sërë situatash që kërkojnë ndreqje. Zoti ynë Jezus përvijoi një proces për disiplinën ndreqëse në rastet kur një vëlla mëkaton kundër një tjetri (Mat. 18:15-17). Apostulli Pal e nxiti kishën korintase të ballafaqonte dhe të përjashtonte

nga anëtarësia një vëlla të kapur në një mëkat skandaloz seksual (1 Korintasve 5). Jo vetëm që ndreqja e kishës është e nevojshme për mëkate “vërtet të këqija”, si shturja seksuale, por edhe ato që, në dukje, janë më të rëndomta; pra, mëkatet të tilla të çrregullta, si përtacia dhe mësimi i rremë kërkojnë ndreqje (2 Thes. 3:6, 11; Titi 3:10).

Askush s’mund të jetojë një jetë të tërë pa nevojën e disiplinës, qoftë ajo pozitive, apo ndreqëse. Prandaj, anëtari i shëndetshëm i kishës e përqafton disiplinën si një mjet hiri në jetën e krishterë.

Si ta kërkojmë me gëzim disiplinën?

Ndoshta, temën e disiplinës së kishës po e ndesh për herë të parë. Ose, ndoshta, s’ke për herë të parë, por praktika e disiplinës mund të jetë diçka e re, ose s’ekziston fare në kishën tënde lokale. Disa njerëzve do t’u duhet, në të njëjtën kohë, që të rriten në njohurinë e kësaj teme të rëndësishme, të përballen me frikën ose përshtypjet e gabuara dhe të kontribuojnë për shëndetin e kishës së tyre. Më poshtë, ke ca sugjerime për të kultivuar një dëshirë për disiplinën pozitive dhe atë ndreqëse, në mënyrë që të mund të jemi anëtarë kishe të shëndetshëm.

PRANO FJALËN E PERËNDISË ME BUTËSI

Jakobi u bën thirrje të krishterëve: “hiqni çdo ndyrësi dhe mbeturinë ligësie, pranoni me butësi fjalën e mbjellë në ju, e cila mund të shpëtojë shpirtat tuaj” (Jakobi 1:21). Në udhëzimin e Jakobit nënkuptohet një dallim midis një jete të paperëndishme në ndyrësi dhe ligësi dhe e jetës së e Krishtit në përulësi, ose me butësi. Të krishterët duhet ta pra-

nojnë me butësi Fjalën e Perëndisë. Me fjalë të tjera, në predikimin e Fjalës së Perëndisë dhe në studimin e Biblës të krishterët duhet të mbeten të përlurur dhe të ndjeshëm përpara Shkrimit, duke e pranuar si burimin e shpëtimit dhe të udhëzimit për një jetë të perëndishme. Ndërsa vijnë te Shkrimi, ne duhet të vijnë si njerëz e njohim natyrën tonë mëkatore, varfërinë tonë shpirtërore para Perëndisë, si dhe nevojën për ndikimin formues të Perëndisë, i cili vjen normalisht nga Fjala e tij.

Si mund ta dimë se po e pranojmë me butësi Fjalën e Perëndisë? Ndoshta, pyetjet e mëposhtme do të na ndihmojnë:

- Kur lexojmë Biblën, e po e lexojmë thjesht për informacion, apo me besim se Perëndia na flet realisht nëpërmjet Fjalës së Vet?
- Kur dëgjojmë predikimin e Fjalës, a kërkojmë përgjithësisht që të na plotësohet ndonjë nevojë (për shembull, që të zbavitemi ose të marrim ndonjë këshillë praktike), apo, pikësepari, dëshirojmë të marrim kuptimin origjinal të tekstit dhe ta zbatojmë në jetë?
- Si është reagimi ynë fillestar ndaj Shkrimit: “Si më bën kjo që të ndihem?”, apo “A e pranoj si të vërtetë këtë?”. A lejojmë që ndjenjat të na përcaktojnë karakterin, apo lëmë Shkrimin të na përcaktojë ndjenjat?¹
- A është qëndrimi ynë gjatë predikimeve ose leximeve të Shkrimit mbrojtës ose luftarak, sikur po i

¹ C. J. Mahaney, *Living the Cross Centered Life: Keeping the Gospel the Main Thing* (Sisters, OR: Multnomah, 2006). Shih kap. 2.

kërkojmë dikujt që “të na e provojë atë që po thotë”?¹

- A priremi që t’i gjykojmë filozofitë dhe pikëpamjet e tjera në bazë të Shkrimit, apo përpiqemi ta pajtojmë ose gjykojmë Shkrimin në bazë të filozofive dhe pikëpamjeve të tjera?

Pranimi i Fjalës me butësi nënkupton pranimin e Biblës me besim, me zemër miqësore dhe të nënshtruar, dhe me dëshminë e Frymës së Perëndisë. Në mënyrë të veçantë, pranojmë faktin se Bibla është e vërtetë, se është i vetmi autoritet i mjaftueshëm që na modelon jetën dhe se ajo duhet të na drejtojë në mënyrën si ndihemi dhe mendojmë. Duke vepruar kështu, anëtari i shëndetshëm e përgatit veten për disiplinën formuese të kishës së Krishtit.

MËSO TA KUPTOSH NDREQJEN SI PROVË TË DASHURISË SË PERËNDISË

Nëse të shqetëson perceptimi se disiplina e kishës është e ashpër dhe mizore, ki parasysh faktin se Bibla na thotë se vetë Perëndia është një Atë i dashur, i cili i disiplinon fëmijët e vet: “Biri im, mos e merr lehtë disiplinën e Zotit, as mos të të lëshojë zemra kur ai të qorton. Sepse Zoti disiplinon atë që do, dhe fshikullon çdo bir që i pëlqen” (Heb. 12:5-6).

Marrja e disiplinës nga dora e Perëndisë është provë e dashurisë së Tij për ne. Sa herë që na qorton dhe na ndreq, të jemi të sigurt se po na trajton siç do të trajtonte babai

¹ Ky ishte qëndrimi i të paperëndishmëve të Romakëve 1:18, 21, të cilët “e shtypin të vërtetën” dhe “nuk e nderuan Atë si Perëndi, as e falënderuan si të tillë”.

të birin. Disiplina është akt dashurie, jo hakmarrjeje apo urrejtjeje. Shkruesi i Hebrenjve vazhdon duke pohuar: “Duhet ta duroni disiplinën. Perëndia po ju trajton si bij. Sepse cilin bir nuk e disiplinon i ati?” (Heb. 12:7).

Dhe cili është synimi i disiplinës së këtij Ati të dashur? Ai e bën që “t’i nënshtrohemi Atit të shpitrave dhe të jetojmë”, si dhe “të marrim pjesë në shenjtërinë e tij” (Heb. 12:9-10). Nga dashuria, Ati po na mbron jetën dhe po na përputh me shenjtërinë e Vet, duke na ndrequr dhe qortuar. Anëtari i shëndetshëm e kupton si dashuri këtë disiplinim dhe e pranon si një burim sigurie, pasi ata që nuk disiplinohen janë “kopilë, jo bij” (Heb. 12:8).

PRANO ME PËRULJE NDREQJEN NGA TË TJERËT

Anëtarët e shëndetshëm jo vetëm që e pranojnë ndreqjen e Zotit, por pranojnë me përulësi edhe ndreqjen nga të tjerët. Ata e pranojnë se, shpesh, ndreqja e Zotit vjen përmes anëtarëve të tjerë në kishë, shenjtorëve që duan t’ia dinë aq shumë sa, jo vetëm të inkurajojnë në kohë të mira, por edhe të qortojnë e të ndreqin kur del nevoja. Anëtarët e shëndetshëm e pranojnë se “më mirë një qortim i hapur, se një dashuri e fshehur. Besnike janë plagët e një miku” (Fja. 27:5-6).

Shumë kisha, që e marrin seriozisht anëtarësimin, u kërkojnë anëtarëve të rinj që të shqyrtojnë, mbështesin dhe, nganjëherë, firmosin besëlidhjen e kishës në fjalë. Besëlidhja e kishës është një dokument që përmbledh shkurtimisht zotimin që marrin anëtarët e kishës para Zotit dhe para njëri-tjetrit për ta jetuar besimin e krishterë siç na porositi Shkrimi.

Një nga rreshtat e mi të preferuar në një besëlidhje tipike kishtare e trajton këtë çështje të rëndësishme, pra, pranimin e dashurisë dhe të korrigjimit nga të tjerët:

Ne do të ecim së bashku me dashuri vëllazërore, siç u ka hije anëtarëve të një kishe të krishterë, do të ushtrojmë përkujdesje dhe vigjilencë plot dashuri për njëritjetrin dhe do të qortojmë e do t'i bëjmë thirrje njëritjetrit, siç do ta kërkojë rasti.¹

“Budallenjtë e përçmojnë urtësinë dhe mësimin” (Fja. 1:7), kurse është natyrë e perëndishmërisë, pjekurisë dhe shëndetit të vërtetë tek anëtarët e kishës kur pranojnë mësimin dhe qortimin plot dashuri të të tjerëve.

MERR SERIOZISHT PËRGJEGJËSINË PËR TË DISIPLINUAR TË TJERËT

Mënyra e katërt se si mund të kultivojmë një dëshirë të shëndetshme për disiplinë të perëndishme është të marrim seriozisht përgjegjësinë tonë për t'u kujdesur në këtë mënyrë për të tjerët. Ja një rresht tjetër nga një besëlidhje tipike kishtare, që e trajton këtë përgjegjësi: “Ne do të punojmë së bashku për vazhdimësinë e një shërbese besnike ungjillore në këtë kishë, duke ruajtur adhurimin, sakramentet, disiplinën dhe doktrinën e saj”. Është përgjegjësi dhe privilegj bazë i çdo anëtari kishe që të ndihmojë në ruajtjen e disiplinës së kishës lokale. Ja pse pasazhet klasike, si Mateu 18 dhe 1 Korintasve 5, që trajtojnë mëkatën e papenduar, përmbillen

¹ Shih Shtojcën për një model besëlidhjeje për kishën.

me një veprim përfundimtar dhe vendimtar nga bashkësia.¹ Por ndreqja i përket jo vetëm bashkësisë në tërësi; ajo fillon kur çdo individ tregohet proaktiv në dashuri dhe përpiqet të rimëkëmbë ata që kanë rënë në mëkat.²

MOS HARRO TË GËZOHESH!

Mund të jetë e lehtë ta mendosh disiplinën e kishës thjesht në aspektin e dhimbjes dhe të trishtimit që shoqërojnë mëkatin dhe humbjen e një vëllai ose motre. Edhe ky trishtim ka vendin e vet (Mat. 5:4; 1 Kor. 5:2). Por gjithë procesi i disiplinës, nga puna formuese e Fjalës e deri te puna ndreqëse e kishës, që nganjëherë përjashton një anëtar të papenduar, duhet marrë me shpresë dhe me synimin e pendimit që çon në gëzim dhe ngushëllim (2 Kor. 2:6). Ne po përpiqemi që t'i fitojmë vëllezërit dhe motrat për të vërtetën (Jakobi 5:19-20) dhe, kur ndodh kjo, duhet të gëzohemi bashkë me oborret e qiellit. Ndoshta, s'ka gjë më të ëmbël sesa kur sheh një njeri, i cili po mashtrohej dhe po shkatërrohej nga mëkati, që thyen prangat e pamëshirshme të mëkatit dhe zbulon rishtazi lirinë dhe faljen e Shpëtimtarit tonë të mëshirshëm. Si anëtarë të shëndetshëm kishe, në përpjekjen për të përforcuar kishat tona, mund të marrim pjesë në disiplinën e kishës me gëzim dhe besim, duke ditur se Ati ynë i dashur ndreq me hir dhe besnikëri ata që do. Lumturohemi kur shohim gjurmët e veprës së Perëndisë të shpalosur në rritjen, pendimin dhe rimëkëmbjen e atyre që marrin hirin e disiplinës.

¹ Shih Mateu 18:17 dhe 1 Kor. 5:4-5.

² Shih, për shembull, Mat. 18:15 dhe Gal. 6:1.

Përmbyllje

Është e pamundur që anëtarët e kishës të kujdesen në mënyrë të efektshme për njëri-tjetrin nëse vetëm pak njerëz e marrin përsipër përgjegjësinë e ndreqjes ose të udhëzimit të vëllezërve apo motrave që kanë nevojë për këtë. Nëse anëtarët nuk marrin përkushtimin që t'u shërbejnë të tjerëve duke u mësuar Fjalën në shkollën e së dielës ose duke drejtuar grupe të vogla, nëse anëtarët druhen që të njohin njëri-tjetrin dhe, kështu, s'mbetet asnjë kontekst për bashkësi reale, atëherë nuk ka për të ndodhur as disiplina pozitive, as ajo ndreqëse. Familja e Perëndisë do të sistemohet në mënyrë të mangët, fëmijët e Tij do të mësohen keqas dhe dëshmia e kishës do të njolloset nga mëkati i papenduar dhe i pandrequr.

Për përsiatje të mëtejshme

Me një grup miqsh dhe anëtarësh të krishterë shqyrtoni dhe diskutoni për pyetjet e renditura më sipër në këtë kapitull.

Për lexim të mëtejshëm

Adams, Jay. *Handbook on Church Discipline: A Right and Privilege of Every Church Member*. Grand Rapids, MI: Zondervan, 1974.

Lauterbach, Mark. *The Transforming Community: The Practice of the Gospel in Church Discipline*. Ross-shire, Christian Focus, 2003.

Për pastorët

Dagg, John L. *Manual of Church Order*. Harrisonburg, VA: Gano Books, 1990; botuar për herë të parë më 1858.

Dever, Mark E., red. *Polity: Biblical Arguments on How to Conduct Church Life*. Washington, DC: 9Marks Ministries, 2001.

Wills, Gregory. *Democratic Religion: Freedom, Authority, and Church Discipline in the Baptist South, 1785–1900*. Oxford University Press, 2003.

Wray, Daniel. *Biblical Church Discipline*. Edinburgh: Banner of Truth, 1978.

ANËTARI I SHËNDETSHËM ËSHTË DISHEPULL NË RITJE

Anëtari i shëndetshëm është anëtar në rritje.

Është e pamundur ta ndash shëndetin e kishës lokale nga shëndeti i anëtarëve. Po kështu, është e pamundur ta ndash mirëqenien e një anëtari kishe nga rritja dhe dishepullimi i tij shpirtëror.

Kur të krishterët nuk rriten

Ky është hamendësim nga ana ime, por ka mundësi që problemi më kronik me të cilin përballen kishat dhe të krishterët është mungesa e vazhdueshme e rritjes shpirtërore dhe përparimit në dishepullim. Të gjithë njohim të krishterë që kanë rrëfyer besimin dhe pendimin, por që, mjerisht, pranojnë se ka njëfarë kohe që nuk po rriten. Kjo situatë shfaqet në dy forma. Kemi monotoninë e përkohshme ose rutinën shpirtërore, që e përjeton çdo i krishterë dhe që duhet mposhtur herë pas here. Kjo është normale dhe s'duhet të shkaktojë alarm të panevojshëm. Ndoshta, rutinat duhen ndryshuar ose duhet ripërtërirë fokusi, por problemi s'është bërë ende kronik.

Por, pastaj, kemi dhe formën kronike. Këtu njerëzit mund të mos jenë në gjendje të perceptojnë rritje për një pe-

riudhë të zgjatur kohore. Kanë rënë në diçka më të thellë sesa thjesht një rutinë. Jo thjesht kanë “ngecur” e po përpiqen të çlirohen; jo, ata kanë rënë në një letargji shpirtërore. Nëse ka disa kohë që kanë rënë në këtë gjumë, ndoshta besojnë se kaq ishte mundësia e rritjes, ose se ndjekja e Krishtit është diçka e cekët dhe boshe. Ata mund të braktisin pritshmërinë e rritjes. Krenaria mund t’u thotë: “Kam mbërritur në destinacion nga ana shpirtërore dhe, realisht, s’ekziston më tepër rritje se kaq”.

Kur ndodh kjo, duhet të lëshohet një alarm i fortë! Në botët tona shpirtërore, që janë tejet individualiste dhe të privatizuara, ky lloj telashi mund të kalojë pa u vënë re, pa u përmendur dhe pa u korrigjuar për shumë kohë.

Përparimi në njohurinë dhe ngjashmërinë e Krishtit, pjekuria dhe përparimi shpirtëror drejt saj duhet të jenë normale për të krishterët. Prandaj Hebrenjve na nxit të lëmë “doktrinën themelore të Krishtit dhe të shkojmë drejt pjekurisë” (Heb. 6:1). Shkruesi e merr të mirëqenë se këta të krishterë duhet të kishin përparuar e “deri tani... duhet të ishit mësues”, pra, duhet të kishin kaluar nga “qumështi” për fëmijën e pamësuar të “ushqimi i fortë... për të pjekurit” (Heb. 5:11-13).

Duke folur për veten, apostulli Pal modeloi mënyrën se si ta ruajmë përrulësinë kur vjen puna të rritja shpirtërore:

Jo se unë tashmë e fitova çmimin ose jam bërë i përsosur, por po vazhdoj të rend për ta zënë, sepse edhe unë u zura nga Jezu Krishti. Vëllezër, sa për vete, nuk mendoj se e kam zënë, por bëj këtë: duke harruar ato që kam lënë pas dhe duke u prirur drejt atyre që kam përpara, po rend drejt synimit, drejt çmimit të thirrjes së lartme të Perëndisë në Krishtin Jezus. (Fil. 3:12-14)

Pastaj, u jep këtë nxitje lexuesve: “Të gjithë ne që jemi të pjekur, le të mendojmë në këtë mënyrë” (v. 15a).

Për të krishterët duhet të jetë normale të rriten, të punojnë për rritjen dhe të presin pjekuri gjithnjë e më të madhe shpirtërore. Ata që veprojnë kështu janë anëtarë të shëndetshëm kishë.

Probleme në mënyrën si e mendojmë rritjen

Por ideja se i krishteri duhet të presë, të përjetojë dhe të punojë për rritjen sështë fundi i kësaj çështjeje. Që i krishteri të rritet në mënyrë të shëndetshme, duhet të sqarojmë se çfarë është dhe çfarë nuk është rritja. Kultura jonë është sipërfaqësore; e vë theksin te gjërat e jashtme, por anashkalon realitetin e brendshëm. Jemi tepër të cenueshëm, pasi na pëlqen më tepër të na mendojnë si të matur, sesa të jemi vërtet të matur.

Mësimi i Jezusit në Lluca 18 na ndihmon të identifikojmë të paktën dy qëndrime që pengojnë rritjen dhe dishepullimin e qëndrueshëm biblik:

Ai... ua tha këtë shëmbëlltyrë disave që besonin në vetvete se ishin të drejtë dhe i trajtonin të tjerët me përçmim: “Dy burra u ngjitën në tempull të luten, njëri farise, ndërsa tjetri tagrambledhës. Fariseu, u ngrit në këmbë i vetëm, dhe u lut kështu: ‘Perëndi, të falënderoj që s’jam si njerëzit e tjerë, fajdexhinj, të padrejtë, kurorëshkelës, apo qoftë dhe si ky tagrambledhës. Unë agjëroj dy herë në javë; jap të dhjetat e gjithçkaje që marr’. Kurse tagrambledhësi, i cili qëndronte larg, nuk guxonte as të ngrinte sytë drejt qiellit, por rrihte gjoksin e thoshte: ‘O Perëndi, ji i mëshirshëm me

mua, mëkatarin!' Ja ku po jua them: ky njeri u kthye në shtëpinë e vet i shfajësuar, ndërsa i pari jo. Sepse kushdo që lartëson veten do të përulet, ndërsa ai që përul veten, do të lartësohet". (Luka 18:9-14)

Tri probleme në mendimin e vet ia ndaluan fariseut që të rritej në perëndishmëri.

1) *Kurthi i ecurisë*. Në të gjitha sportet kryesore për ecurinë e lojtarëve mbahen statistika: përqindja e goditjeve, përqindja e golave, numri i pikëve, numri i vrapimeve, *taçdaun*-et, asistet, e kështu me radhë. Shpesh, vlera e atletit përmbledhet nga këto statistika. Kështu, ata që ia dalin "ta mbushin fletën e statistikave" me shifra të mëdha kremtohen, brohoriten si "lojtarë të shkëlqyer" dhe u jepen çmime.

Ideja jonë për rritjen e krishterë mund të ndikohet nga mendësia e "mbushjes së fletës së statistikave". Vini re se si fariseu foli me Perëndinë për veten dhe për gjithë arritjet e veta. E mati rritjen me synime dhe objektiva të vrojtueshëm: agjërimit dy herë në javë dhe e dhjeta e gjithçkaje që merrte. Edhe ne mund ta bëjmë këtë. Theksojmë numrin e herëve që kemi kryer "kohët e qeta" këtë javë, numrin e herëve që u kemi dhënë literaturë të krishterë të tjerëve, ose sa shpesh kemi ndarë ungjillin. Mund të biem në kurthin e ecurisë, duke menduar se rritja shpirtërore dhe dishepullimi barazohen me ecurinë e mirë dhe suksesin. Kur ndodh kështu, koncepti që kemi për rritjen dhe vlerën lidhet gabimisht me "statistikat".

2) *Gjykimi me standardet e gabuara*. Shpesh, një gjë tjetër që i çon të krishterët në mendim të gabuar kur vjen puna te rritja është prirja për ta gjykuar mbarëvajtjen duke

e krahasuar veten me të tjerët. Shumë të krishterë tregohen relativistë në këtë mënyrë. Fariseu ishte krenar para Perëndisë, sepse nuk ishte “si njerëzit e tjerë, fajdexhinj, të padrejtë, kurorëshkelës, apo qoftë dhe si ky tagrambledhës”. Përfytyrojeni pak! Ndonëse i gjunjësuar në lutje para Perëndisë, në të njëjtën kohë po gjykonte dhe po dënonte njeriun që po lutej mu përbri tij! Vendimi i tetë i Jonathan Edwards-it na jep një qasje më të mirë. Edwards-i shkroi:

Vendosa: të veproj, në çdo aspekt, si në të folur ashtu dhe në veprime sikur të mos ketë njeri më të ndyrë se unë dhe sikur të kisha kryer të njëjtat mëkate, ose të kisha patur të njëjtat dobësi ose të meta si të tjerët, dhe të mos lejoj që njohuria e të metave të tyre të nxisë gjë tjetër veçse turp për veten time dhe të më sigurojë vetëm shkas që të rrëfej mëkatet dhe gjendjen time të mjerë para Perëndisë.¹

Nëse po fokusohemi te të tjerët në përpjekjen për të shfajësuar veten para Perëndisë ose për të “lartësuar veten” si “viganë besimi”, jo vetëm që *nuk* do të rritemi siç duhet, por edhe do të mashtrojmë veten, duke menduar se jemi më të mirë nga ç’jemi vërtet. Dhe, të jemi të bindur se Perëndia do të na përulë. Kështu që është më mirë të përulim veten dhe të besojmë në hirin e Perëndisë sesa të na kundërvihet Perëndia për shkak të krenarisë (Jakobi 4:6; 1 Pjet. 5:5).

3) *Mbështetja te forca ose përpjekjet personale në rritjen shpirtërore.* Ky është një tjetër gabim i fariseut. Sipas

¹ *The Works of Jonathan Edwards*, vëll. 1 (Peabody, MA: Hendrickson, 1998), lxii.

mendjes së tij, gjithçka që duhet ta rekomandonte para Perëndisë ishte rezultat i përpjekjeve dhe aftësisë së tij. Por vetëpërpjekja nuk është burimi i rritjes së vërtetë shpirtërore. Pasi shkruesi i Hebrenjve i nxit lexuesit që të lënë “doktrinat fillestare të Krishtit dhe të ecni drejt pjekurisë”, shton: “edhe këtë do ta bëjmë, nëse na lejon Perëndia” (Heb. 6:1, 3). Shkrimi i Shenjtë na thotë se përparimi ynë në dishepullim dhe pjekuri shpirtërore varet nga hiri dhe vullneti i Perëndisë, jo nga vetëpërpjekjet dhe forca jonë. Ja pse apostulli Pal përlëvdon Perëndinë për rritjen e të krishterëve (2 Thes. 1:3) dhe i lutet Perëndisë për rritje të mëtejshme (1 Thes. 3:11-13; Kol. 1:10). Ne porositemi të rritemi dhe të kultivojmë pjekurinë dhe perëndishmërinë (për shembull, tek 2 Pjet. 1:5-8, 3:18), por të gjitha përpjekjet i ushtrojmë në varësi nga Perëndia dhe me besim tek Ai për rritjen që kërkojmë.

Kështu, rritja biblike nuk duhet ngatërruar me ecurinë e jashtme, as nuk matet duke i përdorur të tjerët si standard. Dhe, në fund fare, ajo nuk varet nga përpjekjet apo arritjet tona. Po atëherë, çfarë është rritja dhe si e ndjek anëtari i shëndetshëm?

Rritja që duam të shohim

Anëtari i shëndetshëm ka preokupim të jashtëzakonshëm për rritjen personale dhe për rritjen e anëtarëve të tjerë të kishës. Siç vëren me të drejtë Mark Deveri: “Puna për nxitjen e dishepullimit dhe rritjes së krishterë është punë për t’i sjellë lavdi Perëndisë, jo vetes”.¹ Meqë preokupimin

¹ Mark Dever, *Nine Marks of a Healthy Church* (Wheaton, IL: Crossway Books, 2004), 214.

për lavdinë e Perëndisë duhet ta kemi parësor në jetën tonë si besimtarë, duhet të kemi preokupim të jashtëzakonshëm për rritjen.

Një sërë pasazhesh në Bibël na përvijojnë atë lloj rritjeje që duhet të shpresojnë të shohin te vetja dhe te të tjerët anëtarët e shëndetshëm. Për shembull, Galatasve 5:22-25 na rendit frytin e Frymës, provat e virtytit dhe të karakterit të formuar nga Fryma, që karakterizojnë ata që nuk jetojnë sipas forcës së tyre dhe natyrës mëkatore, por sipas Frymës. Ne duhet “të rritemi në hirin dhe njohurinë e Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jezu Krisht” (2 Pjet. 3:18).

Efesianëve 4:11-13 na kujton se Zoti i jep kishës burra me dhunti me qëllim rritjen e saj: “për ndërtimin e trupit të Krishtit, derisa të gjithë të arrijmë në unitetin e besimit dhe të njohurisë së Birit të Perëndisë, si njeri i pjekur, në masën e shtatit të plotësisë së Krishtit”.

Të gjitha këto përshkrime dhe nxitje mund t'i përmbledhim me termin “perëndishmëri” ose “shenjtëri”. Rritja që dëshirojmë të shohim, rritja që, në fund fare, sështë e jashtme dhe e cekët, është rritja në perëndishmëri ose shenjtëri, rritja në “shtatin e plotësisë së Krishtit”. Anëtari që rritet është ai që i ngjan gjithnjë e më tepër Jezusit në qëndrimin e zemrës, mendimeve, fjalëve dhe veprimeve. Kështu dëshirojmë me zjarr që të bëhemi ne dhe kishat tona.

Si të rritemi për t'u bërë si Jezusi

Si e kultivojmë anëtarët e shëndetshëm këtë lloj rritjeje? Më poshtë, keni disa sugjerime si të vazhdojmë të zhvillojmë perëndishmërinë ose shenjtërinë në jetë.

QËNDRO NË KRISHTIN

Jezusi tha:

“Unë jam hardhia, ju jeni shermendet; kush qëndron në mua dhe unë në të, jep shumë fryt, sepse pa mua nuk mund të bëni asgjë. Në qoftë se ndokush nuk qëndron në mua, hidhet jashtë si shermendi dhe thahet; pastaj i mbledhin, i hedhin në zjarr dhe digjen. Në qoftë se qëndroni në mua dhe fjalët e mia qëndrojnë në ju, kërkoni çfarë të doni dhe do t’ju bëhet. Në këtë është përlëvduar Ati im, që të jepni shumë fryt, dhe kështu do të jeni dishepujt e mi” (Gjoni 15:5-8).

Çelësi për t’u rritur në perëndishmëri është të qëndrosh në Hardhinë e Vërtetë, që është Krishti Jezus. Këtu qëndrimi në Krishtin dhe prodhimi i fryteve sëshëtë “asgjë më pak sesa rezultat i varësisë këmbëngulëse te hardhia, e nxitur nga besimi që përqafton gjithë jetën e besimtarit dhe produktin e dëshmisë së tij”.¹ Dhe kjo frytshmëri vjen ndërsa Fjala e Zotit banon te dishepulli. “Këto fjalë duhet t’i nguliten kaq shumë në mendje dhe në zemër dishepullit, saqë përputhja me Krishtin, bindja ndaj Krishtit, t’i bëhet gjëja më e natyrshme (e mbinatyrshme?) në botë”.² Qëndrimi në Krishtin, qëndrimi në Fjalën e Tij, është diçka thelbësore për dishepullimin dhe rritjen e vërtetë si i krishterë.

¹ Don Carson, *The Gospel of John: An Introduction and Commentary*, Pillar New Testament Commentary Series (Grand Rapids, MI: Eerdmans, 1991), 517.

² Po aty.

PËRDOR MJETET E ZAKONSHME TË HIRIT

Shumë të krishterë duket se besojnë që përparimi në pjekurinë shpirtërore duhet të vijë përmes ndonjë përjetimi të jashtëzakonshëm ose “të papritur”. Për ta, ajo që e prodhon rritjen është fantastikja. Por, siç sapo e pamë te Gjoni 15, ai që prodhon zakonisht rritjen dhe pjekurinë është mjeti i zakonshëm i hirit. Madje, ndërsa e jashtëzakonshmja dhe spektakolarja mund t’i çojnë njerëzit në udhë të gabuar (dhe, shpesh, e bëjnë vërtet), Fjala (e mësuar siç duhet dhe e kuptuar siç duhet) së bën kurrë këtë. “Mjetet e zakonshme të hirit” përfshijnë studimin e Fjalës së Perëndisë, pjesëmarrjen në sakramentet e pagëzimit dhe të Darkës së Zotit bashkë me kishën e mbledhur, si dhe lutjen. Këto janë mënyrat e zakonshme se si shpallet, shpaloset dhe përvetësohet hiri i Perëndisë në jetën e krishterë. Me anë të Fjalës së Perëndisë, dëgjojmë Krishtin e zbuluar dhe të përlëvduar, dhe aty “nxëmë Krishtin” në mënyrën më të qartë të mundshme. Por në urdhërimet e pagëzimit dhe të Darkës shohim Krishtin dhe ungjillin ndërsa përfytyrojmë vdekjen, varrimin dhe ringjalljen e Tij për ne dhe për shpëtimin tonë.

I krishteri i shëndetshëm nuk i anashkalon këto urdhërimet dhe mjete hiri, por gëzohet në to, përgatitet për to dhe kujton lavditë e Krishtit, Shpëtimtarit tonë. Besimtarit, ose besimtares, i kujtohet se hiri “na mëson [ose stërvit] për të mohuar paperëndishmërinë dhe pasionet e botës, si dhe për të bërë një jetë me vetëkontroll, të drejtë dhe të perëndishme në këtë epokë” (Titi 2:11-12). I krishteri i shëndetshëm mbështetet gjithnjë e më tepër në hirin e Perëndisë, që i komunikohet përmes Fjalës dhe sakramenteve.

MERR PJESË NË KISHËN LOKALE

Hebrenjve 10:25 na udhëzon të mos lëmë pas dore asamblenë e shenjtoreve. Përkundrazi, duhet të mblidhemi e të inkurajojmë gjithnjë e më tepër njëri-tjetrin ndërsa presim kthimin e Jezusit. Asambleja publike synon ndërtimin, forcimin dhe rritjen e të krishterit. Lënia pas dore i pjesëmarrjes në jetën kolektive të kishës ose mungesa e shërbimit aktiv, si ndaj të tjerëve, ashtu dhe ndaj nesh, me siguri që do të na e kufizojë rritjen. Efesianëve 4:11-16 na ofron një argument shumë të fuqishëm se pjesëmarrja në trupin e Krishtit është mënyra kryesore se si na forcon dhe na pjek Krishti. Kur u shërbejmë të tjerëve në kishë, kur durojmë njëri-tjetrin, kur duam njëri-tjetrin, ndreqim njëri-tjetrin dhe inkurajojmë njëri-tjetrin, marrim pjesë në një lloj “bashkëpunimi për pjekurinë shpirtërore”, ku rezervat dhe furnizimet na shumëfishohen. Rezultati përfundimtar i kësaj është rritja dhe dishepullimi.

SHIKO DREJT ARDHJES SË JEZUSIT

Së fundi, rritemi në shenjtëri duke pritur me mall ardhjen e Jezusit dhe duke medituuar për Të. Pjesa më e madhe e referencave të Dhiatës së Re për kthimin e Jezusit lidhen me nxitje të ndryshme për shenjtëri dhe pastërti. Për shembull, te Mateu 25, kur Jezusi përfundon së mësuari dishepujt për ardhjen e tij të dytë, e përmbyll me nxitjen e thjeshtë që “të jenë gati”, të shohin drejt ardhjes së Tij dhe, në kohën e ndërmjetme, të jetojnë si duhet. Mateu 26 vijon me tri shëmbëlltyra, ku të gjitha e nxisin lexuesit të vigjilojnë dhe të jenë besnikë derisa Ai të kthehet. Zoti na mësoi se ardhja e dytë e Tij është diçka për të cilën duhet të meditojmë vazh-

dimisht dhe se ky meditim duhet të na bëjë që ta ruajmë jetën e krishterë dhe të rritemi.

Titi 2:13-14 përmend “shpresën e lume, shfaqjen e lavdisë së Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë të madh, Jezu Krishtit”, me këtë shpjegim të misionit të Jezusit: “[Ai] e dha veten për ne, për të na shpenguar nga çdo paligjshmëri dhe për të pastruar për vete një popull për zotërimin e vet, i cili të jetë i zellshëm për vepra të mira”. Me fjalë të tjera, ne vështrojmë drejt kryqit dhe drejt ardhjes së dytë të Krishtit dhe kujtojmë se Krishti ka bërë gjithçka për shpengimin, pastërtinë dhe zellin tonë: pra, shenjtërinë tonë. Apostulli Gjon përfshin një pohim shumë të ngjashëm në një prej letrave të veta.

Shumë të dashur, ju tani jeni fëmijë të Perëndisë dhe se çfarë do të jemi ende s’na është shfaqur; por dimë se, kur ai të shfaqet, do të jemi si ai, sepse do ta shohim ashtu siç është. Dhe kushdo që shpreson në këtë mënyrë në të, e pastron veten, ashtu siç është i pastër ai (1 Gjoni 3:2-3).

Përmallimi ynë për të qenë *me* Jezusin dhe për *ta parë* Jezusin ka si synim që të na bëjë më tepër *si* Jezusi në shenjtëri. Pritja me mall e Krishtit ka për të prodhuar rritje tek anëtarët e shëndetshëm.

Përmbyllje

Anëtari i shëndetshëm është një anëtar në rritje. Në mënyrë të veçantë, ai ose ajo është një anëtar kishe që rritet në ngjashmërinë me Krishtin, në shenjtëri dhe në pjekuri. Kjo pjekuri dhe shenjtëri zhvillohet në varësi ndaj Krishtit, Fjalës së Tij dhe të tjerëve në kishën lokale. Dhe, çështë më e mre-

kullueshmja, nuk kemi për të ndalur së rrituri, derisa të arrijmë në plotësinë e Krishtit!

Për përsiatje të mëtejshme

1. Ka ndonjë mënyrë të gabuar se si mund ta kesh matur ose menduar rritjen? Nëse po, cila është? Sipas teje, çfarë duhet ndryshuar në mënyrën si mendon? Ç’këshilla të japin anëtarët e grupit për këtë çështje?
2. Me një grup miqsh të krishterë dhe anëtarë të kishës diskutoni për mënyrat se si jeni rritur të gjithë kohët e fundit. Në çfarë mënyrash po kultivoni dëshira dhe zakone të shenjta me anë të hirit të Perëndisë?
3. Cilat strategji për rritjen shpirtërore janë më të nevojshme në jetën tënde në këtë çast? Si do t’i vësh në veprim?

Për lexim të mëtejshëm

- Bridges, Jerry. *The Pursuit of Holiness*. Colorado Springs, CO: Nav-Press, 1978.
- Ferguson, Sinclair B. *The Christian Life: A Doctrinal Introduction*. Edinburgh: Banner of Truth, 1981.
- Piper, John. *Don’t Waste Your Life*. Wheaton, IL: Crossway Books, 2003.
- Sproul, R. C. *Knowing Scripture*. Downers Grove, IL: InterVarsity, 1977.
- Tripp, Paul David. *Instruments in the Redeemer’s Hands: People in Need of Change Helping People in Need of Change*. Phillipsburg, NJ: P&R, 2002.

ANËTARI I SHËNDETSHËM ËSHTË NDJEKËS I PËRULUR

Shëndeti i kishës lokale mund të varet plotësisht nga reagi-
mi i anëtarëve ndaj udhëheqjes së kishës. Mënyra se si bash-
kësia pranon ose refuzon drejtuesit e vet ka ndikim të drejt-
përdrejtë të mundësitë e shërbesës besnike dhe shëndetit
të kishës. Si e vlerëson dhe e pranon bashkësia predikimin
e shëndoshë? A kanë besim anëtarët të drejtuesi dhe a e
ndjekin atë në situata të vështira dhe të paqarta? A rreshto-
hen pas grupit drejtues, apo e “shqyejnë” atë kur idetë dhe
planet dështojnë?

Në fund fare, anëtarët e kishës janë njerëzit që, përgji-
thësisht, forcojnë ose shkatërrojnë kishën lokale. Dhe forci-
mi ose shkatërrimi i kishës ka të bëjë së tepërmi me qëndri-
met dhe veprimet e anëtarëve ndaj drejtuesve të tyre.

Prandaj, asnjë përpjekje serioze për të përcaktuar anë-
tarin e shëndetshëm të kishës nuk mund të neglizhojë refle-
ktimin për ndërveprimin mes anëtarëve të kishës dhe drejt-
tuesve të saj. Prandaj, sështë habi që Fjala e frymëzuar e Pe-
rëndisë na siguron udhëzime të bollshme në lidhje me *qëndri-
met* dhe *veprimet* e anëtarëve të kishës, që dëshirojnë të
kontribuojnë për shëndetin e bashkësive të tyre lokale duke
ndjekur udhëheqjen e kishës.

Qëndrimi i anëtarit të kishës ndaj udhëheqjes

Anëtari i shëndetshëm i kishës karakterizohet nga të paktën tri qëndrime kur vjen puna te ndjekja e drejtuesve të kishës lokale.

1) *Nderon pleqtë*. Një sërë pasazhesh të Shkrimit i udhëzojnë anëtarët e kishës që të nderojnë pleqtë dhe drejtuesit e bashkësisë. Për shembull, 1 Timoteut 5:17 na thotë: “Pleqtë që drejtojnë mirë punët e kishës janë të denjë për nderim të dyfishtë, sidomos ata që mundohen me predikimin dhe mësimin”. Çfarë përfshin ky nderim i dyfishtë? Apostulli Pal na sjell në mendje dy gjëra në vargjet vijuese. Në vargun 18, nderimi i pleqve përfshin përkujdesjen për nevojat e tyre financiare dhe fizike. Bashkësia dhe anëtari që nderon ekipin drejtues u siguron rrogë të mjaftueshme dhe të përshtatshme drejtuesve të vet, sidomos atyre që kanë si punë me kohë të plotë shërbesën ndaj trupit të besimtarëve.

Në vargun 19, apostulli vë në dukje se nderimi i drejtuesve përfshin dhe mbrojtjen e reputacionit të tyre. Nuk duhet “të pranojmë asnjë akuzë kundër një plaku përveçse në bazë të dy ose tre dëshmitarëve”. Apostulli e kupton më mirë se kushdo tjetër se shërbesa është e hapur ndaj akuzave, kritikave e ankesave nga jashtë dhe nga brenda kishës. Anëtari i shëndetshëm e ndihmon bariun të mbrohet nga “hobetë” dhe “shigjetat” e pavërteta. Thashethemet dhe goditjet mbas shpine vdesin në veshët e një anëtari të shëndetshëm, pasi ai refuzon që të marrë parasysh përrallat e pabaza, që nuk e rrisin besimtarin.

Anëtari i shëndetshëm e nderon ofiqin e plakut. Ai ose ajo e vlerëson së tepërmi, është mirënjohës për të dhe respekton ata që i shërbejnë popullit të Zotit si pleq. Ne i

nderojmë pastorët tanë ngaqë, në ditën e Zotit, me ata do të mburremi (2 Kor. 1:14).

2) *Tregon dashuri zemërhapur për drejtuesit.* Nderimi dhe respekti që anëtari i kishës i jep një plaku nuk është si nderimi i largët dhe zyrtar që ushtari i jep komandantit. Bashkë me nderimin, bariut duhet t'i japim edhe një dashuri me zemër të hapur. Në mënyrë të përsëritur, Pali i bëri thirrje kishës korintase që t'ia hapte zemrën atij si personit që përkujdesej për ta nga ana shpirtërore:

Goja jonë u hap për ju, o korintas, dhe zemra jonë u bë e gjerë për ju. Ju nuk jeni ngushtë në ne, por jeni ngushtë në zemrat tuaja. Por, në shkëmbim, po ju flas si fëmijëve, bëhuni të gjerë dhe ju. (2 Kor. 6:11-13)

Mes pastorit dhe bashkësisë duhet të ekzistojë një shkëmbim i ëmbël dashurie. Ndërsa jetojnë, rriten dhe punojnë së bashku, atyre u hapet gjithnjë e më tepër zemra ndaj njëri-tjetrit. Anëtari i shëndetshëm nuk ia “fshih” dashurinë pastorit të vet; përkundrazi, ia jep lirisht dhe bujarisht.

Anëtari i shëndetshëm nuk dëshiron ta dëgjojë pastorin e vet besnik që të përgjërohet siç iu përgjërua apostulli korintasve: “Bëhuni të gjerë në zemër për ne. S'i kemi rënë askujt në qafë, s'kemi shprishur askënd, s'kemi përfituar prej kurrkujt. Nuk e them këtë që t'ju dënoj, sepse, siç ju thashë më parë, ju kemi në zemër që të vdesim së bashku dhe të jetojmë së bashku” (2 Kor. 7:2-3).

Së pari, anëtari i shëndetshëm ia dorëzon veten Zotit dhe, pastaj, shërbyesit të Zotit, duke e ditur se ky është vullneti i Perëndisë (2 Kor. 8:5). Ky lloj anëtari e shikon se si pastori besnik stërmundohet me dashuri për trupin e Kri-

shtit. Dhe atij do t'i vinte turp po ta dëgjonte pastorin të pyeste: "Nëse ju dua më tepër, a do të më doni më pak?" (2 Kor. 12:15). Dashuria e pakthyer është e denjë për tragjeditë shekspiriane, por jo për kishën lokale. Gëzimi ynë për pastorët dhe dashuria jonë për ta duhet "të na ripërtërijë zemrën në Zotin" (Filem. 20).

3) Është i mësueshëm. Anëtari i shëndetshëm duhet të ketë edhe frymë që është gati gjithnjë të mësojë. Fryma e mësueshme dëshmon për përlulësinë e zemrës dhe për dëshirën që të rritemi në Krishtin. Pa të, njerëzit bëhen qafëfortë dhe të pandreqshëm.

Detyra e drejtuesit mund të reduktohet në një të vetme: mësimdhënia. Nëse një anëtar ose një pjesë e konsiderueshme e anëtarëve dalin se janë të pamësueshëm, detyra i bëhet barrë bariut, madje dhe nuk e bën dot, pasi besimtarët po i kundërvihen në këtë pikë, që është tejet thelbësore. Kur i shkruan Timoteut, Pali siguron disa mësim të mrekullueshme për pastorët, që përmbajnë udhëzime të mira edhe për anëtarët. Duke folur për rolin e plaku, Pali shkruan:

Shërbëtori i Zotit nuk duhet të zihet, por të jetë i butë me të gjithë, i aftë për të mësuar njerëzit dhe i durueshëm, duke i mësuar me butësi kundërshtarët, me shpresë se Perëndia ua jep atyre të pendohen, që arrijnë të njohin të vërtetën, dhe të vijnë në vete, duke shpëtuar nga laku i djallit, që i ka zënë robër të vullnetit të tij. (2 Tim. 2:24-26)

Në këtë pasazh ka një sërë gjërash të dobishme, që duhet të vërejnë anëtarët e kishës. Së pari, mënyra si jep mësim pastori duhet të jetë e butë, e dashur dhe për të mirën tonë.

Nuk duhet të përfitojmë në mënyrë të mëkatshme nga kjo detyrë e caktuar nga Perëndia. Përkundrazi, atë mësim të njerëzishëm duhet ta pranojmë si qortim dhe si thirrje për pendim. Anëtari i shëndetshëm nuk ia merr pastorit mirëdashjen e perëndishme për dobësi, por e përdor atë rast për të shqyrtuar zemrën e vet për ndonjë aspekt ku nevojitet pendesë. Së dyti, duhet të kuptojmë sa e lehtë është “t’i kundërvihemi” pastorit kur ai po na mëson. Si pjesë të rregullt të jetës shpirtërore duhet të pyesim veten: “A po i kundërvihem në ndonjë lloj mënyre mësimi të pastorit?”. Së treti, duhet të lutemi për njohurinë e së vërtetës, mendjekthjelltësi dhe mbrojtje nga kurthet e djallit sa herë që zbulojmë qoftë dhe një grimcë kundërshtie ndaj udhëzimit pastoral. Pastorët vigjilojnë mbi shpirtin tonë si njerëz që duhet t’i japin llogari Perëndisë; prandaj, duhet t’u besojmë dhe t’ua pranojmë me gëzim udhëheqjen si dhuratë nga Perëndia për dobinë tonë të përzetshme. Ji i mësueshëm.

Veprimet e anëtarit të shëndetshëm ndaj udhëheqjes

Përveç këtyre qëndrimeve ose predispozitave bazë, ka dhe disa veprime të veçanta që kryen anëtari i shëndetshëm, me qëllim që të ndjekë në mënyrë të efektshme udhëheqjen e kishës lokale.

MERR PJESË ME DURIM NË PËRZGJEDHJEN E DREJTUESVE

Ndoshta, vendimi më i rëndësishëm që merr bashkësia (në rastin e qeverisjes së saj) është përzgjedhja e drejtuesve të vet. Duke zgjedhur drejtuesit, bashkësia i përcakton tonin dhe drejtimin shpirtëror kishës, nganjëherë për breza të të-

rë. Ndoshta kjo është arsyeja pse apostujt e udhëzuan kishën e hershme që të kërkonte cilësi dhe pjekuri shpirtërore te drejtuesit e vet (Veprat 6:1-6; 1 Timoteut 3). Përzgjedhja e drejtuesit duhet bërë me durim dhe me kuvendime plot lutje. “Mos vendosni duart me nxitim mbi një njeri” është udhëzimi që apostulli i dha Timoteut (1 Tim. 5:22a). Dhjakët e parë duhet të ishin “të mbushur me Frymë dhe me urtësi” (Veprat 6:3). Dallimi i këtyre cilësive kërkon lutje, vëzhgim dhe durim. Dhe, që kisha e Zotit të jetë e shëndetshme, anëtarët e kishës duhet të thërrasin dhe të shugurojnë drejtues që kanë mendësi shpirtërore dhe që janë të pjekur në Krishtin.

Anëtarët e shëndetshëm nuk e anashkalojnë rëndësinë e kësaj detyre thelbësore. Ata mund ta ftojnë drejtuesin e ardhshëm, bashkë me familjen, për drekë apo për darkë, me qëllim që ta njohin më mirë. Ata duan që të dëgjojnë më tepër për dëshminë e tij, për dëshirën që ka për të shërbyer në një kapacitet drejtues dhe për shërbesën e mëparshme në kishat e tjera. Disa kisha lejojnë një periudhë dymujore nga emërimi i një personi për udhëheqje e deri te votimi real, me qëllim që anëtarët të marrin pjesë pikërisht në këtë mënyrë.

U BINDET DHE U NËNSHTROHET DREJTUESVE

Ja një arsye e fortë pse duhet të marrim pjesë me lutje dhe durim në njohjen e drejtuesve të kishës: anëtari i shëndetshëm duhet t’u bindet dhe t’u nënshtrohet drejtuesve të vet. *Bindja* dhe *nënshtrimi* nuk janë vetëm “fjalë të këqija” në dasma, por janë të këqija edhe për shumë anëtarë kisha. Mirëpo Bibla është e qartë sa s’ka ku të shkojë më: “Bindjuni drejtuesve tuaj dhe nënshtrojuni” (Heb. 13:17). Bindja jonë

ua bën punën gëzim, jo barrë. Dhe bindja na kthehet në dobinë tonë, pasi s'do të kishte asnjë dobi për ne nëse do të thërrisnim disa burra për të qenë drejtues dhe, pastaj, të mos u bindeshim. Anëtari i shëndetshëm e rendit veten nën drejtuesit e bashkësisë ashtu si ushtari vihet në rreshtim poshtë gjeneralit ushtarak. Ne duhet t'u nënshtrohemi me gëzim, me zell dhe kryekëput drejtuesve tanë për të mirën tonë, për të mirën e tyre dhe për të mirën e gjithë trupit.

NDJEK SHEMBULLIN E DREJTUESVE

Një arsye pse Zoti cakton burra për drejtimin e kishës është që t'i sigurojë bashkësisë një shembull të gjallë të jetës besnike e të perëndishme. Drejtuesit janë "mishërimi" i ndjekjes së Jezusit. Atyre u bëhet thirrje të jenë shembull në gjithçka (1 Tim. 4:12; 1 Pjet. 5:3). Ja pse apostulli Pal thotë: "Vëllezër, bëhuni imitues të mi dhe le t'i mbajmë sytë te ata që ecin sipas shembullit që kemi në ne" (Fil. 3:17). Anëtari i shëndetshëm e modelon jetën e vet sipas stilit të perëndishëm të jetesës së pleqve të kishës. Ne duhet ta ndjekim shembulli e drejtuesve me shpresën që të bëhemi si Krishti.

Për shumë njerëz në kohën tonë, ideja e imitimit tingëllon si diçka kultike. Ekziston një numër tepër i madh kultesh personaliteti, ku njerëzit imitojnë si papagaj gjithçka që thotë dhe bën pastori i shquar. Kemi të drejtë të shqetësohemi nga ky lloj koncepti jobiblik i modelit shembullor dhe këshillimit. Mirëpo përshkrimi që i bën Bibla ndjekjes së shembullit të pastorit flet për perëndishmërinë e vërtetë "në fjalë, në sjellje, në dashuri, në besim dhe në dëlirësi" (1 Tim. 4:12), duke bërë atë që është e mirë (Titi 2:7). Pastorëve u bëhet thirrje që të jenë modele të tilla, ndërsa anëtarët e

shëndetshëm ndjekin me urtësi modelin e shenjtërisë së tyre.

LUTET PËR DREJTUESIT

Duke pasur parasysh gjithçka që duhet të bëjnë drejtuesit e kishës, si dhe gjithçka me të cilën iu duhet të luftojnë, a nuk mendon se gjëja më e rëndësishme për të bërë është që të lutesh për ta? Edhe apostulli Pal e kuptonte nevojën që kishte për lutjet besnike të shenjtorëve:

Ngulmoni në të lutur, duke ndenjur zgjuar në të me falënderim. Dhe duke u lutur në të njëjtën kohë edhe për ne, që Perëndia të hapë edhe për ne derën e fjalës, për të shpallur misterin e Krishtit, për shkakun e të cilit jam edhe i burgosur, në mënyrë që ta bëj të njohur, duke e folur siç duhet. (Kolosianëve 4:2-4; shih dhe Efe. 6:19-20)

Duhet të lutemi për guximin, qartësinë dhe besnikërinë e drejtuesve në lidhje me mesazhin e ungjillit, si dhe për mundësi që ata të shpallin Krishtin. Anëtarët e shëndetshëm i përkushtohen lutjes për drejtuesit e tyre. Ata ia vënë veshin nxitjes së Jezusit që të lutemi e të mos dorëzohemi (Luka 18:1) dhe e bëjnë këtë për hir të barinjve të tyre.

Në kishën tonë lokale, një grup besnik anëtarësh mbli-dhet çdo të martë në darkë me qëllim që të lutet për drejtuesit. Javë për javë ata kërkojnë kërkesa lutjeje dhe përditësimë për kërkesa të mëparshme. Kur mbli-dhen, bëjnë gjithfarëlloj lutjesh për jetën personale, publike dhe shërbyese të pleqve. Perëndia na ka dhënë fryt të jashtëzakonshëm në bashkësinë tonë përmes lutjeve të tyre.

**MBËSHËTET SHËRBESAT E JASHTME DHE
NDËRVEPRIMIN E DREJTUESVE**

Ky është, ndoshta, veprimi më pak i dukshëm që kryen anëtari i shëndetshëm kur u bindet drejtuesve. Ndër anëtarët e kishës ekziston një prirje e fortë që të jenë tejet posedues në lidhje me pastorët e tyre: “ai është pastori *ynë*”. Kjo lloj mbrojtjeje ka dhe aspekte pozitive. Për shembull, ajo tregon një lidhje zemërhapur me barinjtë.

Megjithatë, ajo mund të shndërrohet edhe në egoizëm nëse bashkësia s’pranon të mbështesë përfshirjen e pastorit në shërbesa jashtë bashkësisë lokale. Njeriu që lëndohet më shpesh nga ky lloj egoizmi është vetë pastori, i cili, pa nxitjen dhe ripërtëritjen e jashtme të pastorëve dhe drejtuesve të tjerë, priret të thahet dhe të tkurret “në hardhi”. Anëtari i shëndetshëm kontribuon për shëndetin dhe forcën e vazhdueshme të drejtuesit në shërbesë, duke nxitur pjesëmarrjen e tij në konferenca, mundësi predikimi dhe bashkësi të jashtme me drejtues të tjerë kishash.

Bibla na jep ilustrime të qarta të mbështetjes së një bashkësie nga një bashkësi tjetër. Te 2 Korintasve 9:13 përgëzohet bujaria që një kishë lokale kishte treguar ndaj kishave të tjera. Dhe, kjo lloj bujarie, kur merr formën e “huazimit” të një bariu në shërbim të të tjerëve, me shpresë do t’i zgjerojë zonat ku po shpallet ungjilli (2 Kor. 10:15-16). Anëtari i shëndetshëm dëshiron ta shohë ungjillin të përhapet dhe dëshiron të kontribuojë për shëndetin e bashkësive të tjera nëse mundet. Mbështetja e shërbesës së jashtme të një drejtuesi përbën një mënyrë për ta përmbushur këtë dëshirë.

Përmbyllje

Udhëheqja e kishës lokale është caktuar nga Perëndia për bekimin e popullit të Tij. Megjithatë, që udhëheqja të jetë e efektshme, duhet inkurajuar dhe mbështetur nga anëtarët e kishës. Shumë burrave besnikë iu është mbytur anija në brigjet shkëmbore të anëtarëve të pandreqshëm dhe kundërshtues. Nuk duhet të ndodhë kështu në popullin e Perëndisë. Përkundrazi, anëtarët e shëndetshëm të kishës lokale duhet të mundohen dhe të inkurajojnë të tjerët që të përpiqen të ndjekin drejtuesit e tyre me zemër të hapur plotësisht, me bindje të zellshme dhe me nënshtrim plot gëzim.

Për përsiatje të mëtejshme

1. Shqyrto udhëzimin që u jepet anëtarëve të kishës në Hebrejve 13. Në ç'mënyrë të ka sjellë avantazhe ose bekime nënshtrimi yt ndaj drejtuesve të kishës?
2. Në ç'mënyra specifike mund të lutesh për drejtuesit?
3. Si mund t'i inkurajosh anëtarët e tjerë të kishës që të kenë besim më të madh te drejtuesit e kishës ndërsa këta të fundit ndjekin Krishtin dhe na mësojnë Fjalën?

Për lexim të mëtejshëm

- Mahaney, C. J. *Humility: True Greatness*. Wheaton, IL: Crossway, 2005.
- Sande, Ken. *The Peacemaker: A Biblical Guide to Resolving Conflict*. Grand Rapids, MI: Baker Books, 2003.

ANËTARI I SHËNDETSHËM ËSHTË LUFTËTAR LUTJEJE

Kur isha i vogël, ditëlindjet e shokëve i festonim duke iu gjuajtur me pëllëmbë nga pas, nga një goditje për çdo vit të jetës. Pastaj, e përmbyllim me një goditje shtesë, dhe u thoshim: “... kurse këtë e ke për t’u rritur”. Në përputhje me këtë traditë, nëntë kapitujt e parë të këtij libri përputhen me nëntë shenjat e vëllimeve të tij shoqëruese, “*Nëntë shenjat e kishës së shëndetshme*” dhe “Çfarë është kisha e shëndetshme”, ndërsa ky kapitull i dhjetë jepet “që të rriteni”.

S’më kujtohet të kem takuar qoftë dhe një të krishterë të vetëm që të mos besojë se lutja është e rëndësishme, madje, jo vetëm e rëndësishme, por dhe pjesë jetike e jetës së krishterë. Madje, do të ishte i çuditshëm ai i krishterë që përpiqet ta jetojë jetën e krishterë pa lutje.

Por, pavarësisht statusit të saj të pranuar botërisht, për shumë të krishterë lutja mbetet një detyrë e vështirë, një angari pa gëzim dhe, nganjëherë, në dukje, pa efekt. Të krishterët mund të luhaten mes poleve të neglizhencës dhe acarimit kur vjen puna te lutja.

Pse ndodh kështu? Pse të krishterët dhe anëtarët e kishave që, në aspekte të tjera janë të shëndetshëm, e konsiderojnë lutjen një ushtrim kaq të vështirë?

Një shtëpi lutjeje për gjithë njerëzit

Vështirësia në lutje bëhet edhe më shqetësuese kur kuptojmë se kisha duhet të jetë një vend lutjeje. Profeti Isaia foli për një kohë kur eunukët dhe të huajt do të gjenin një shtëpi mikpritëse mes popullit të Perëndisë. Ata që u përkisnin kombeve jashtë Izraelit do të respektonin besëlidhjen e Perëndisë, dhe Zoti u premtoi këtyre të huajve:

Këta do t'i sjell në malin tim të shenjtë,
dhe do t'i bëj të gëzohen në shtëpinë time të lutjes;
ofertat e tyre të djegura dhe flijimet e tyre
do të vendosen mbi altarin tim;
sepse shtëpia ime do të quhet shtëpi lutjeje
për gjithë popujt. (Isa. 56:7)

Zoti Jezus e citoi këtë premtim kur “hyri në tempull dhe dëboi gjithë ata që shisnin e blinin në tempull”, duke rithekshuar se shtëpia e Perëndisë s’ishte vend për kusarë, por për njerëz të lutjes (Mat. 21:13; Marku 11:17).

Kur shqyrtojmë aktivitetet e kishës së hershme, që janë regjistruar për ne në Shkrim, zbulojmë se një nga gjërat qendrore së cilës iu përkushtuan anëtarët e kishave të hershme ishte lutja. Teksa prisnin premtimin e Frymës së Shenjtë, u mblodhën në dhomën e sipërme dhe “me një mendje të vetme i ishin përkushtuar lutjes” (Veprat 1:14). Pas Rrëshajave, kur Perëndia i shtoi numrit të tyre ata që po shpëtoheshin, anëtarët e parë të kishës së hershme “iu përkushtuan” katër gjërave: “mësimi të apostujve dhe bashkësisë, thyerjes së bukës dhe lutjeve” (Veprat 2:42). Përfshirja e të krishterëve të parë në lutje ishte kaq e fuqishme, sa që mund të quhet vetëm “përkushtim”.

Si disiplinë shpirtërore, lutja është kaq e rëndësishme, saqë është i vetmi përkushtim që jepet si arsye pse mund të ndërpritet përkushtimi i zakonshëm martesor mes burrit dhe gruas (1 Kor. 7:5). E përfytyroni dot ripërtëritjen që do të shpërthente në jetën shpirtërore nëse, në dhomat e gjumit të të krishterëve, bashkëshortet do të thoshin “jo tani, zemër, le t’i përkushtohemi lutjes”, në vend që të thoshin “jo tani, zemër, kam dhimbje koke”? Nga shtëpia deri te kisha, lutja ka vlerë thelbësore.

Çfarë është lutja?

Por nuk bëhemi luftëtarë lutjeje thjesht nëse vëmë në dukje rëndësinë dhe vlerën qendrore të lutjes në kishat e hershme. Jo vetëm kaq, por, shpesh, edhe mund të jemi të përshtjelluar se çfarë është realisht lutja. Idetë e gabuara gëlojnë. Për shembull:

- Nëse nuk lutemi, Perëndia s’mund të veprojë dot në botë.
- Perëndia ka caktuar tashmë gjithçka; ai është sovran, kështu që pse të lutemi?
- Perëndia është tepër i zënë që t’u vërë veshin lutjeve të mia.

Në rrënjë, shumica e keqkuptimeve për lutjen rrjedhin nga keqkuptimi i natyrës së Perëndisë dhe i marrëdhënies sonë me Të. Është e lehtë ta kthesh lutjen në një spektakël skenik të përqendruar te vetja, ku qendrën e skenës e marrin pretendimet dhe nevojat tona, ndërsa Perëndia është thjesht një punonjës skene, që na ndryshon skenat sipas kërkesës. Mirëpo, është e lehtë të rrëzohesh edhe nga ana tjetër e

vagonit dhe ta shndërrosh Perëndinë në një lojtar kozmik shahu që, në mënyrë deterministe, lëviz të gjithë gurët, pa ua varur fare veprimeve të popullit të tij.

Ajo që na nevojitet është një botëkuptim për lutjen që ka si qendër ungjillin. Teologu Graeme Goldsworthy na ofron këtë këndvështrim:

Pikësëpari, ungjilli ka të bëjë me punën e Birit. Mënyra si e njohim Birin do të përcaktojë mënyrën se si e shohim marrëdhënien tonë me Atin, i cili na flet përmes fjalës së Vet. Nga ana e vet, mënyra si e shohim atë marrëdhënie do të përcaktojë mënyrën se si vijmë te Perëndia në lutje dhe me çfarë sigurie vijmë. Kështu, lutja s'ka për të qenë më kurrë një ekskursion sentimental apo një shtypje instinktive e butonit të panikut. S'ka për të qenë as hamendësimi i një të drejte të lindur që t'i kërkosh vëmendje Perëndisë. Përkundrazi, ajo do të jetë shprehja e hyrjes sonë në shenjtëroren qiellore të Perëndisë, të cilën na e ka blerë Kryeprifti ynë i Madh.¹

Besimi në ungjillin na e ndryshon statusin, nga të jashtëm në anëtarë të familjes së Perëndisë, në bij të birësuar të Perëndisë përmes besimit në Krishtin. Mbi këtë bazë (pra, mbi birërinë përmes besimit në Krishtin) mund të flasim me Perëndinë si fëmijë të shpenguar të Tij. “Lutja është përgjigjja jonë ndaj Perëndisë kur ai na flet”,² së pari, nëpërmjet ungjillit të Krishtit dhe, më tej, nëpërmjet Fjalës së Vet.

¹ Graeme Goldsworthy, *Prayer and the Knowledge of God: What the Whole Bible Teaches* (Downers Grove, IL: InterVarsity 2003), 51.

² Po aty, 16.

Lutja nuk është “parashtrimi i një çështjeje para një Perëndie të papredispozuar”,¹ as nuk do të thotë të veprosh si zëvendësues i një perëndie që është tepër i pafuqishëm për të kryer diçka pa ne. Në lutje, si fëmijë të bashkuar me Krishtin, avokatin dhe kryepriftin tonë, trashëgimtarin e të gjitha gjërave, qëndrojmë para Perëndisë dhe marrim një audiencë të plotë. Për shkak se para Perëndisë po qëndrojmë në Krishtin, nuk ka tavan që të na i bllokojë lutjet, ndonëse, shpesh, përfytyrojmë se ekziston një tavan i tillë. Përkundrazi, “ne përfshihemi në punën që Perëndia ka me botën” duke u lutur “për përmbushjen e synimeve të zbuluara të Perëndisë për gjithë universin” përmes “ungjillit dhe rrjedhojës së tij, që ia ka caktuar Perëndia”. Lutja është “të mendosh me mendimet e Perëndisë”², mendime që gjithmonë do të dëgjohen dhe do të marrin përgjigje prej Tij.

Po atëherë, si të lutemi?

Shumë libra janë shkruar për temën e lutjes. Disa rekomandojnë disa metoda të caktuara lutjeje. Të tjerë shqyrtojnë jetën e lutjes së njerëzve të Biblës ose shenjtorëve të mëdhenj nga historia e kishës. Me kaq shumë libra për lutjen dhe duke ditur sa shumë përparim kam nevojë unë vetë të bëj në jetën time të lutjes, jam ngurrues që t’u jap të tjerëve sugjerime për t’i pasur parasysh. Por, në mëshirën dhe dashamirësinë e Vet, Perëndia na ka treguar se si dhe kur të lutemi.

¹ Po aty, 35.

² Po aty, 60-61.

Si-ja dhe kur-i i lutjes “distilohen” në dy mësimet biblike: lutu pa pushim dhe lutu në Frymën.

PA PUSHIM

Shpesh, apostulli Pal i inkurajonte kishat të cilave u shkruante që të luteshin pa pushim. Ai i nxiti selanikasit të luteshin “pa pushim” (1 Thes. 5:17). Pali u shkroi të krishterëve në Romë që të ishin “vazhdimisht në lutje” (Rom. 12:12). Ndërsa kolosianëve u shkroi: “Vazhdoni të patundur në lutje, duke ndenjur zgjuar në të me falënderim” (Kol. 4:2). Kjo përbënte një nga mënyrat se si besimtarët e kishës kolosiane mund ta përqendronin mendjen “dhe të kërkonin gjërat që janë lart, ku Krishti është ulur në të djathtë të Perëndisë” (Kol. 3:1-2). Si shembull, Pali ngriti lart Epafrain, i cili “lufton gjithmonë në lutje për hirin tuaj” (Kol. 4:12). Duke patur parasysh tundimet, rreziqet dhe nevojat e jetës së krishterë, anëtari i shëndetshëm i kishës i vë veshin urdhrit të Perëndisë që të tregojë vazhdueshmëri në lutje.

NË FRYMË

Anëtari i shëndetshëm është jo vetëm pa pushim në lutje, por edhe lutet në Frymë. “Lutja në Frymë” kuptohet ndryshe nga grupimet e ndryshme të krishtera dhe ekziston shumë pësjellim për këtë pikë. Por, sërish, Letra e Palit drejtuar Romakëve na vjen në ndihmë, sepse aty ai shkruan: “Fryma na ndihmon në dobësitë tona. Sepse ne nuk dimë se si të lutemi si duhet, por vetë Fryma ndërmjetëson për ne me rënkime tepër të thella për fjalë. Dhe ai që heton zemrat e di se cila është mendja e Frymës, sepse Fryma ndërmjetëson për shenjtorët sipas vullnetit të Perëndisë” (Rom. 8:26-27).

Rezultati fatkeq i kaq shumë hamendësimeve për një pasazh si Romakët 8:26-27 është se anashkalohet theksi kaq i qartë dhe kaq inkurajues i tij. Dhe, këtu, kemi një mësim madhështor që na inkurajon në lutjet tona. Vini re se Fryma “na ndihmon në dobësitë tona”. Kemi vërejtur tashmë se lutja është një aspekt ku të krishterët e pranojnë aty për aty dobësinë e tyre. Sa dashamirësi tregon Perëndia Frymë kur na ndihmon pikërisht në këtë aspekt! Të është dukur ndonjëherë sikur nuk di se për çfarë të lutesh? Vetë Fryma ndërmjetëson për ne. Ke dashur ndonjëherë të dish me saktësi se cili është vullneti i Perëndisë, në mënyrë që të lutesh për të? Fryma ndërmjetëson për ne pikërisht “sipas vullnetit të Perëndisë”.

Gjithë kjo përbën një tregues kyç se çdo të thotë të lutesh në Frymën. Lutja në Frymën është lutje *e kontrolluar* nga Fryma. Dhe lutja e kontrolluar nga Fryma është lutje sipas vullnetit të Perëndisë. Ne lutemi në Frymën kur lutemi në përputhje me vullnetin e Perëndisë, i cili na është zbuluar në Fjalën e Tij. Kjo lloj lutjeje është e drejta që nga lindja e çdokujt që ka lindur nga Fryma dhe është birësuar si fëmijë i Perëndisë (Rom. 8:14-17). Pikërisht përmes një lutjeje të tillë e kryejmë luftën tonë si të krishterë (Efe. 6:18).

Për çfarë dhe për kë të lutemi?

Siç pamë në Romakëve 8:26-27, një nga mënyrat se si Fryma e Perëndisë na ndihmon në dobësinë tonë në lutje është duke ndërmjetësuar për ne kur nuk dimë se për çfarë të lutemi. Megjithatë, edhe Zoti na ka thënë disa gjëra për të cilat duhet të lutemi.

LUTU PËR PUNËTORËT DHE BARINJTË

Ungjilli i Mateut na regjistron një shembull kur Jezusi u mbush me dhembshuri për popullin e keqtrajtuar dhe të pashpresë të Izraelit, që dukej “si delet pa bari”. Jezusi i udhëzoi menjëherë dishepujt: “lutjuni me zell Zotit të të korrave, që të dërgojë punëtorë në të korrat e veta” (Mat. 9:36-38). Ndoshta, vetëm të krishterët që kanë qenë në kisha që kanë vuajtur për periudha të tejkzgjatura mungesën e një pastori e njohin natyrën urgjente të kësaj lutjeje. Populli i Zotit ka nevojë për barinj dhe anëtarët e shëndetshëm i përgjërohen Atij që t’u dërgojë barinj në kishat e tyre dhe në kishat e tjera që kanë nevojë për pastorë. Dhe ata jo vetëm që luten që t’u dërgohen barinj dhe punëtorë, por luten edhe që Zoti t’i ndihmojë dhe forcojë ata që mundohen për Fjalën gjatë periudhave me fatkeqësi, vuajtje dhe dobësi (Fil. 1:19-20); t’u japë guxim pastorëve në shpalljen e ungjillit (Efe. 6:19-20) dhe t’u sigurojë mundësi për përhapjen e shërbesës dhe ungjillit (Kol. 4:3-4).

LUTU PËR SHENJTORËT

Lutja për të krishterët e tjerë është shprehje e prekshme dashurie dhe përkujdesjeje (shih Efe. 6:18). Krishterimi s’është sport individual dhe lutja s’është si të shkosh me makinë të blesh një sandviç në Burger King, ku i flasim një receptorit të pajetë, presim disa çaste dhe, pastaj, marrim një qeskë me ushqimet që kemi porositur, për “t’i marrë sipas shijes”. Jeta e krishterë është jetë familjare dhe lutjet tona duhet të fokusohen te gjithë familja, te vlerësimi i të tjerëve më tepër se veten tonë. Një mënyrë si ta bëjmë këtë është të lutemi rregullisht, duke marrë me radhë listën emërore të

anëtarësisë së kishës lokale, nëse kisha boton një të tillë. Lutu çdo ditë për emrat e një faqeje ose të një shkronje të alfabetit. Një mënyrë tjetër si të lutesh për gjithë shenjtorët është të lutesh për kishat e tjera në zonë dhe për kishat ku janë anëtarë familjarë ose miq të tu. Kur takohemi me Zotin për të studiuar fjalën e Tij çdo ditë, mund të duam që të krishterët e tjerë të lutën që e vërteta e Fjalës së Perëndisë të mbizotërojë në jetën e tyre çdo ditë. Mund të lutemi për shenjtërimin e tyre (1 Thes. 4:3); mund të lutemi kundër tundimit dhe që të kenë vigjilencë (Mat. 26:41); mund të lutemi që ata të mbushen me Frymën (Gal. 5:16-25) dhe për pothuajse gjithçka tjetër që Bibla u bën thirrje të krishterëve.

LUTU PËR ATA QË JANË NË AUTORITET

Pastori i ri, Timoteu, mori këto fjalë nga këshilltari i tij, apostulli Pal: “Pra, pikësëpari, të nxis që të bëhen përgjërime, lutje, ndërmjetësime dhe falënderime për gjithë njerëzit, për mbretërit dhe për gjithë ata që janë në pozicione të larta, që të mund të bëjmë një jetë plot paqe e të qetë, me perëndishmëri dhe dinjitet në çdo mënyrë” (1 Tim. 2:1-3). Duke pasur parasysh se është Perëndia ai që cakton çdo autoritet në jetë, që nga drejtuesit qeveritarë (Rom. 13:1-2) e deri te prindërit (Efe. 6:1-3) dhe duke pasur parasysh bekimet që u jep Perëndia atyre që ndjekin autoritetet që ka caktuar Ai, është e logjikshme që të krishterët duhet të lutën për ata që janë në autoritet. Anëtarët e shëndetshëm kujtojnë rregullisht në lutjet e tyre autoritetet e zgjedhura, punonjësit qeveritarë, mësuesit e shkollave, punëdhënësit e tyre, prindërit dhe të tjerë njerëz me autoritet. Është e dobishme të mbash një listë me njerëz të tillë në Biblën tënde

ose në ditarin e lutjes, si formë e organizuar kujtese, që të lutesh për ata që janë në autoritet.

LUTU PËR ATA QË TË KEQTRAJTOJNË DHE TË PËRNDJEKIN

Kjo është porosia e Zotit: “Bekoni ata që ju mallkojnë, lutuni për ata që ju keqtrajtojnë” (Luka 6:28). Është e natyrshme të lutemi për njerëzit që duam. Edhe jobesimtarët arrijnë t’i bëjnë këto lloj “lutjesh”. Por dashuria e Krishtit na shtrëngon të lutemi edhe për ata që na keqtrajtojnë, na fyejnë dhe na dëmtojnë (Mat. 5:46-47). Në mënyrë të mahnitshme, këto lloj lutjesh japin prova se jemi bij të Perëndisë (Mat. 5:45), ashtu si përndjekja për drejtësi përbën shkak gëzimi për shkak të shpërblimit që ka premtuar Krishti në mbretërinë e Vet (Mat. 5:10-12). Nuk duhet të jemi si ai shërbëtori i pamëshirshëm, i cili, ndonëse iu fal borxhi, i keqtrajtoi të tjerët që i kishin borxh (Mat. 18:21-35). Duhet ta luftojmë shtysën mishore që na nxit të mos duam përndjekësit dhe t’i anashkalojmë në lutje, dhe, në vend të kësaj, duhet të zgjedhim gëzimin më të lartë dhe drejtësinë e bijve të Perëndisë, që luten edhe për keqtrajtuesit e tyre.

Përmbyllje

A mund të ketë privilegj më të mahnitshëm sesa ai që u është dhënë të krishterëve përmes Krishtit: që të qëndrojmë përpara Perëndisë, Atit tonë, dhe t’i përgjigjemi në lutje, me anë të Frymës së tij, Fjalës së tij që na flitet? Nëse duam të jemi teologë biblikë, që janë dëgjues ekspozues dhe të nginjur me ungjillin, duhet të lutemi me njohurinë e sigurt të asaj që Perëndia po bën në botë përmes Krishtit, Birit të Tij, dhe duhet të lutemi për përparimin mbarëbotëror të ungjillit dhe vullnetit të Tij.

Për përsiatje të mëtejshme

1. A ke plan specifik për lutjen? Shqyrto planin e tanishëm ose shkruaj një plan të ri për lutjen që të përfshijë:
 - a) kohë vetjake dhe në grup/publik të lutjes;
 - b) kohë dhe vende për lutje;
 - c) individë dhe grupe të veçanta njerëzish për të cilët të lutesh;
 - d) preokupime për ungjillin dhe kishën;
 - e) pasazhe Shkrimi që të duken inkurajuese dhe të dobishme në lutje.

Për lexim të mëtejshëm

- Goldsworthy, Graeme. *Prayer and the Knowledge of God: What the Whole Bible Teaches*. Downers Grove, IL: InterVarsity, 2003.
- Mack, Wayne A. *Reaching the Ear of God: Praying More... and More Like Jesus*. Phillipsburg, NJ: P&R, 2004.
- Packer, J. I., dhe Carolyn Nystrom. *Praying: Finding Our Way Through Duty to Delight*. Downers Grove, IL: InterVarsity, 2006.
- Ryken, Philip Graham. *When You Pray: Making the Lord's Prayer Your Own*. Phillipsburg, NJ: P&R, 2000.
- Carson, D. A. *A Call to Spiritual Reformation: Priorities from Paul and His Prayers*. Downers Grove, IL: InterVarsity; Grand Rapids, MI: Baker Books, 1992.

NJË FJALË E FUNDIT

Shkrimi i këtij libri ishte edhe bekim, edhe privilegj. U jam shumë borxhli ekipeve të 9Marks dhe Crossway që më dhanë mundësinë të shkruaja, dhe veçanërisht Jonathan Leeman-it dhe Lydia Brownback-ut, që më siguruan ndihmë dhe udhëzime të cilave nuk mund t'u jepet dot vlerë monetare. Po kështu, duhet të falënderoj bashkëpunëtorët e mi në ungjillin në Kishën e Parë Baptiste në Grand Cayman; gjithë bashkësia, personeli dhe drejtuesit ofrojnë nxitje për perëndishmëri dhe shërbejnë si model i shumëçkaje të shkruar këtu. Dhe, pa Kristie-n, një ndihmëse shumë e vyer për mua dhe një bekim shumë më i pasur nga ç'është meritot, mundimi im do të ishte shumë më pak i frytshëm, i gëzueshëm dhe aventuror. I jam thëllësisht mirënjohës Perëndisë për hirin dhe udhëheqjen e Tij në shkrimin e këtyre kapitujve. Gjithçka e vlefshme në këtë libër vjen si rezultat i punës së Tij, jo simes, dhe çdo byk në këtë libër vjen nga dobësia dhe paaftësia ime.

Kur reflektoj për dobësitë e mia si i krishterë, si pastor dhe si anëtar kisha, kjo më kujton se edhe ti mund të kesh disa dobësi, që ndikojnë në leximin që do t'i bësh këtij libri. Në veçanti, më vijnë ndërmend dy gjëra.

Së pari, është plotësisht e mundur që ta lexosh këtë libër e t'i bësh një vlerësim vetes, por ndërkohë, të humbasësh nga sytë Jezu Krishtin dhe kryqin. Pra, mund ta lexosh këtë

libër dhe të largohesh duke menduar “punë, punë, punë!”, në vend që të mendosh “hir, hir, hir!” ose “besim, besim, besim!”. Secili nga kapitujt mund të të bëhet si udhërrëfyes për përmirësimin e vetes, për përpjekje, për detyra dhe, ndoshta, angari.

Këshillat e këtij libri nuk jepen si recetë që duhet zbatuar në mënyrë të pavarur nga hiri i Perëndisë në ungjillin e Jezu Krishtit. As dënimi, as gjykimi, as ateizmi praktik nuk janë rezultatet që shpresoj të ketë ky libër. Jo, unë lutem që të jesh në gjendje që librin “Çfarë është anëtari i shëndetshëm?” ta lexosh me zemër përgjëruese, duke dëshiruar që Zoti i kishës të zgjojë në mënyrë të mbinatyrshe secilin prej shenjtorëve të vet që të shërbejë në mënyra të jashtëzakonshme. Lutem që në zemrat tona të rritet një varësi e thellë ndaj Hardhisë (pa të cilin s’mund të bëjmë asgjë) teksa dëshirojmë gjithnjë e më tepër atë që po na bën Krishti. Sido që të të nxisë Zoti që të vësh në praktikë sugjerimet e këtij libri, lutem që këtë ta bësh duke kuptuar dhe duke u mbështetur gjithnjë e më tepër në jetën e Krishtit, që tani vepron te ti, dhe në Frymën e Shenjtë, i cili vulos dhe fuqizon të krishterin për çdo vepër të mirë.

Së dyti, është tërësisht e mundur që ta lexosh këtë libër me frymën e individualizmit. Mund ta përfundosh këtë libër dhe të thuash me vete: “Duhet të filloj të punoj me veten”. Dhe, me siguri, të gjithë ne kemi shumë rritje për të bërë dhe, me hirin e Perëndisë, kemi për ta bërë derisa të kthehet Krishti. Por ky libër është për kishën, për gjithë trupin e Krishtit në një vend të caktuar. Këtu thuhet shumë gjëra për rolin tënd dhe timin në këtë trup, por unë dhe ti jemi bërë për gjithë të tjerët që mblidhen si populli i Perëndisë, dhe atyre u përkasim (Rom. 12:5). Prandaj, mënyra më e

mirë si ta vësh në praktikë këtë libër është që ta bësh me partneritetin, mbështetjen dhe dashurinë e të krishterëve të tjerë në kishën lokale. Mos u bëj “i krishterë vetmitar”, që shqetësohet me dritëshkurtësi vetëm për veten. Lidhi krahët me të tjerët që duan Zotin dhe dua je kishën e Tij, pastaj, së bashku rrituni në hirin dhe njohurinë e Zotit tonë Jezu Krisht.

Autori Jerry Bridges kujton mënyrën si e kuptonte ai kishën lokale gjatë viteve të para si i krishterë. Jerry shkruan:

Për shumë vjet, kisha një qasje individualiste për jetën e krishterë. Preokupohesha për rritjen *time* si i krishterë, përparimin *tim* në shenjtëri, përvetësimin e aftësive të *mia* në shërbesë. Lutesha që Perëndia të më aftësonte të isha më i shenjtë në jetën personale dhe më i efektshëm në ungjillëzim. I kërkoja Perëndisë bekimin e tij për kishën *time* dhe për organizatën e krishterë ku punoja *unë*. Por, kur fillova të mësoja më tepër për bashkësinë e vërtetë, fillova të lutesha që *ne*, si Trupi i Krishtit, të rriteshim në shenjtëri, që *ne* të ishim dëshmitarë më të efektshëm të hirit shpëtues të Krishtit. Ai që ka nevojë të rritet është gjithë Trupi, jo vetëm unë.¹

Shpresa ime është që kalimi nga “unë” te “ne”, që përshkruan Jerry Bridges, të jetë gjithnjë e më e vërtetë për popullin e Perëndisë. Lutem që ky kontribut i vogël të luajë njëfarë roli në forcimin e dashurisë sonë për trupin e Shpëtimtarit dhe,

¹ Jerry Bridges, *The Crisis of Caring: Recovering the Meaning of True Fellowship* (Phillipsburg, NJ, P&R, 1985), 71–72 (kursivet, të origjinalit).

në këtë mënyrë, kjo ta çojë kishën drejt një force, gjallërie dhe shëndeti më të madh.

SHTOJCË: BESËLIDHJE TIPIKE E NJË KISHE TË SHËNDETSHME

Përderisa, siç besojmë, Hiri Hyjnor na ka bërë që të pendohe-
mi, të besojmë në Zotin Jezu Krisht e t'ia dorëzojmë veten
Atij dhe pasi jemi pagëzuar sipas rrëfimit tonë të besimit,
në emër të Atit, të Birit e të Frymës së Shenjtë, tani, duke
u mbështetur në ndihmën e Tij të hirshme, ne përtërijmë
solemnisht dhe me gëzim besëlidhjen tonë me njëri-tjetrin.

Ne do të punojmë e do të lutemi për unitetin e Frymës
në lidhjen e paqes.

Ne do të ecim së bashku me dashuri vëllazërore, siç u
ka hije anëtarëve të një kishe të krishterë, do të ushtrojmë
përkujdesje dhe vigjilencë plot dashuri për njëri-tjetrin dhe
do të qortojmë e do t'i bëjmë thirrje njëri-tjetrit, siç do ta
kërkojë rasti.

Ne nuk do të harrojmë të mbledhurit së bashku, as nuk
do të neglizhojmë lutjen për veten dhe për të tjerët.

Ne do të përpiqemi që të rrisim me edukimin dhe
qortimin e Zotit ata që, në çdo kohë, mund të na jepen për
përkujdesje dhe, me një shembull të pastër e plot dashuri,
do të kërkojmë shpëtimin e familjes dhe miqve tanë.

Ne do të gëzohemi me lumturinë e njëri-tjetrit dhe do
të përpiqemi me butësi dhe dhembshuri të mbajmë barrët
dhe trishtimet e njëri-tjetrit.

Nëpërmjet ndihmës hyjnore, do të përpiqemi të jetojmë
me maturi në botë, duke mohuar paperëndishmërinë dhe

epshet e botës dhe duke pasur parasysh se, ashtu siç jemi varrosur me dëshirë nëpërmjet pagëzimit dhe jemi ringjallur nga varri simbolik, kështu kemi dhe detyrimin e veçantë që, tani, të bëjmë një jetë të re dhe të shenjtë.

Ne do të punojmë së bashku për vazhdimësinë e një shërbese ungjillore besnike në këtë kishë, duke ruajtur adhurimin, sakramentet, disiplinën dhe doktrinat e saj. Do të kontribuojmë me gëzim dhe rregullisht për mbështetjen e shërbesës, shpenzimet e kishës, ndihmën e të varfërve dhe përhapjen e Ungjillit në gjithë kombet.

Kur të transferohemi diku tjetër, ne do të bashkohemi, sa më shpejt të jetë e mundur, me një kishë tjetër, ku të mund të zbatojmë frymën e kësaj besëlidhjeje dhe parimet e Fjalës së Perëndisë.

Hiri i Zotit Jezu Krisht, dashuria e Perëndisë dhe bashkësia e Frymës së Shenjtë qofshin me ju të gjithë.

Amen.

TREGUESI I SHKRIMEVE

DHIATA E VJETËR

Zanafilla

17:15–19	29
21:1–2	29
29:31	29
3:15	29
30:22	29

Psalmet

119:103–104	20
42:4	71

Fjalët e Urta

1:7	87
20:3	38
27:5–6	86

Isaia

45:22–24	30
55:11	63
56:7	114
6:9–10	24
7:14	29

DHIATA E RE

Mateu

1:20–23	29
3:1–2	63

4:17	63
5:3–12	53
5:4	88
5:5	75
5:10–12	122
5:23–24	75
5:45	122
5:46–47	122
9:36–38	120
18	87
18:15	88 n. 2
18:15–17	72, 82
18:17	88 n. 1
18:21–22	75
18:21–35	122
21:13	114
25	100
26	100
26:41	121
28:19–20	31
<i>Marku</i>	
10:45	75
11:17	114

Luka

6:28	122
18	93

18:1	110	14:10–12	30
18:9–14	94	14:19	74
24:27	32	15:1	75
24:44–45	32		
		<i>1 Korintasve</i>	
<i>Gjoni</i>		1:10	22
10:27	21	3:7	63
13:34–35	66, 73	3:9	63
14:6	63	4:1–2	63
15	99	5	72, 83, 87
15:5–8	98	5:2	88
17:20–21	66	5:4–5	88 n. 1
17:21	22	5:9–13	72
		7:5	115
<i>Veprat e Apostujve</i>		8:1	26
1:14	114	10:11	31
2:38	63	12	75
2:42	114	14	75
4:12	63	14:40	81
6:1–6	108		
6:3	108	<i>2 Korintasve</i>	
		1:14	105
<i>Romakëve</i>		2:6	72, 88
1:16	16, 67	5:18–21	75
1:17	62	5:20	63
8:5–8	51	6:1	63
8:14–17	119	6:11–13	105
8:15	56	7:2–3	105
8:15–16	58	8–9	77
8:16	56	8:5	105
8:26–27	118, 119	9:13	111
10:17	26	10:15–16	111
12:5	126	12:15	106
12:6–8	76	13:5	53
12:12	118	13:11	22
12:16	22		
13:1–2	121		

Galatasve

1:8-9	46
4:6	56, 58
5:16-25	121
5:22-24	53
5:22-25	97
6:1	88 n. 2
6:2	75

Efesianëve

1:13-14	56
2:1-3	51
4:11-13	97
4:11-16	75, 100
6:1-3	121
6:18	119, 120
6:19-20	110, 120

Filipianëve

1:19-20	120
1:27	37
2:9-11	30
2:12	53
3:12-14	92
3:15a	93
3:17	109

Kolosianëve

1:10	96
2:18	26
3:1-2	118
4:2	118
4:2-4	110
4:3-4	120
4:12	118

1 Thesalonikasve

3:11-13	96
4:3	121
5:17	118

2 Thesalonikasve

1:3	96
3:6	81
3:11	81

1 Timoteut

2:1-3	121
3	108
3:1-13	71
4:12	109
5:9	72
5:17	104
5:18	104
5:19	104
5:22a	108

2 Timoteut

2:14-17a	37
2:24-26	106
3:16	82
4:3-4	21

Titi

1:5-9	71
2:11-12	99
2:13-14	101
2:7	109
3:10	83

Filemoni

20	106
----	-----

<i>Hebrenjve</i>		<i>2 Pjetrit</i>	
1:1	30	1:5–8	96
5:11–13	92	1:5–11	53
5:11–14	24	2:2	46
6:1	92, 96	3:18	96, 97
6:3	96		
10:24–25	74	<i>1 Gjonit</i>	
10:25	100	Libri,	53
12:5–6	85	1:6–7	54, 58
12:7	86	1:8–10	54
12:8	86	2:15	55, 58
12:9–10	86	2:22–23	55
12:11	80	3:2–3	101
13	112	3:5	54
13:17	72, 108	3:14–15	58
		3:14b–15	55
		3:18–19	55, 58
<i>Jakobi</i>		3:24b	56, 58
1:21	83	4:13–14	56
1:22–25	24	5:1	55, 58
3:18	74	5:4–5	56, 58
4:6	95		
5:19–20	88	<i>2 Gjonit</i>	
		10–11	46
<i>1 Pjetrit</i>			
1:3–5	56	<i>Juda</i>	
3:8	22	3	37, 46
5:3	109		
5:5	95		
5:6	26		

**Sa më tepër që ta dëgjojë, aq më tepër do t'i ngjajë
Kisha Atij.**

Ja pse 9Marks

- boton libra dhe artikuj
- interviston drejtues kishash
- organizon konferenca fundjavash në Uashington DC
- drejton seminare rajonale
- siguron konsultime për kisha lokale dhe pastorë
- shkruan recensione librash dhe artikuj
- ndihmon të krishterët që të gjejnë kisha të përshtatshme
- për të gjitha këto, mund të mësoni më tepër në www.9marks.org.



“Në një epokë kur të krishterët, në përgjithësi, duken të pështjelluar se ç’lloj komuniteti duhet të jetë kisha, këtu kemi një doracak të dobishëm që përvijon përparësitë e vërteta biblike të kishës, sidomos në aspektin e anëtarëve të kishës si individë”.

John MacArthur, *president, Grace to You*

“Duke pasur parasysh gjendjen e kaq shumë prej kishave tona sot, ky libër mbërrin në çastin e duhur”.

R. Albert Mohler, Jr., *president,*
The Southern Baptist Theological Seminary

“Ky libër paraqet një fokus të shkëlqyer dhe tejet të nevojshëm tek anëtari i kishës si individ. Të gjithë mund të përfitojmë nga ky libër i mprehtë”.

R. C. Sproul, *kryetar dhe president,*
Ligonier Ministri; pastor kryesor i predikimit dhe
mësimbënies, Saint Andrews Chapel, Sanford, Florida

THABITI M. ANYABWILE është pastori kryesor i Kishës së Parë Baptiste në ishujt e Grand Cayman-it. Ai është diplomuar me gradat BA dhe MS në psikologji në Universitetin Shtetëror të Karolinës së Veriut dhe, më parë, ka punuar si ndihmëspastor në Kishën Baptiste në Kapitol Hill të Uashington DC. Ai dhe e shoqja, Kristie, kanë tre fëmijë.

